



## REPUBLIKA E SHQIPËRISË

### KUVENDI

#### *Komisioni i Posaçëm për Reformën në Sistemin e Drejtësisë*

*Dokument parlamentar*

### PROCESVERBAL

Datë 30.07.2015, ora 10:00

**Drejton mbledhjen:**

**Fatmir Xhafaj – kryetar i Komisionit**

#### **Rendi i ditës:**

1. Prezantimi i procesit të reformës në drejtësi, Nëntor 2014 – Korrik 2015
2. Miratimi i Analizës së Sistemit të Drejtësisë në Shqipëri
3. Miratimi i Strategjisë së Reformës së Sistemit të Drejtësisë në Shqipëri
4. Miratimi i Planit të Veprimit të Reformës së Sistemit të Drejtësisë në Shqipëri

#### **Marrin pjesë:**

Fatmir Xhafaj, Eduard Halimi, Vasilika Hysi, Pandeli Majko, Ulsi Manja, Oerd Bylykbashi, Arben Ristani, Gent Strazimiri, Fatmir Mediu, Vexhi Muçmata, Silva Caka.

#### **Mungojnë:**

Spartak Braho, Jorida Tabaku.

**Të ftuar:**

Znj.Albana Shtylla – Drejtuese e Sekretariatit Teknik, pranë Komisionit të Posaçëm

Z.Rainer Deville – Shef i Misionit Euralius, Ekspert i Nivelit të Lartë pranë Komisionit të Posaçëm

Z.Jon Smibert – Këshilltar Ligjor Rezident, OPDAT, Ambasada e ShBA-së, Ekspert i Nivelit të Lartë pranë Komisionit të Posaçëm

Znj.Aurela Anastasi – Eksperte e Nivelit të Lartë pranë Komisionit të Posaçëm

Z.Sokol Sadushi - Ekspert i Nivelit të Lartë pranë Komisionit të Posaçëm

Artan Hoxha - Ekspert i Nivelit të Lartë pranë Komisionit të Posaçëm

Illir Panda - Ekspert i Nivelit të Lartë pranë Komisionit të Posaçëm

Maksim Haxhia - Ekspert i Nivelit të Lartë pranë Komisionit të Posaçëm

Arthur Graham – Prezenca e OSBE-së, Ekspert i Nivelit të Lartë pranë Komisionit të Posaçëm

Korjalka Bumci – Misioni Euralius, Eksperte e Nivelit të Lartë pranë Komisionit të Posaçëm

## HAPET MBLEDHJA:

**Fatmir Xhafaj** – Mirëdita!

Mund të fillojmë mbledhjen e Komisionit të Posaçëm Parlamentar, në të cilën, pa dyshim, një gjë e veçantë është se për herë të parë marrin pjesë edhe kolegët e opozitës në përbërje të këtij komisioni dhe, e veçanta e dytë e rëndësishme, është se kemi shqyrtimin e një sërë dokumentesh të rëndësishme, produkt i punës së grupit të ekspertëve vendas dhe ndërkombëtar të ngritur në bazë të vendimit të Kuvendit të Republikës së Shqipërisë të vendimmarrjes përkatëse të këtij komisioni, dhe mbi bazën e përfaqësimit të institucioneve, që janë brenda sistemit dhe të lidhura me sistemin, si dhe ekspertëve ndërkombëtarë të misioneve, që asistojnë dhe monitorojnë sistemin e drejtësisë në Shqipëri.

Rendi i ditës është i qartë. Fillojmë me pikën e parë të rendit të ditës. Paraqitja e një raporti për informimin e anëtarëve të Komisionit të Posaçëm Parlamentar, lidhur me ecurinë e deritanishme të procesit për reformën në drejtësi. Dokumenti në dijeninë time u është shpërndarë dje me e-mail të gjithë kolegëve deputetë.

Gjithashtu, e keni përpara edhe në tavolinë dhe besoj se zonja Shtylla, e cila është drejtuese e sekretariatit teknik, do të bëjë një paraqitje të përmbledhur të projektit dhe pastaj do të kalojmë te pyetjet dhe diskutimet, nëse do të ketë.

Përpara se të vazhdojë zonja Shtylla dëshiroj të bëj me dije faktin që sot, së bashku me ne, janë të ftuar dhe ekspertët vendas dhe ndërkombëtar, janë bashkëdrejtuesit e shtatë grupeve të punës që i korrespondojnë 7 shtyllave kyçe të reformës në drejtësi.

Disa prej tyre, për fat të keq, nuk janë të pranishëm, sepse nuk gjenden në Shqipëri, por, gjithsesi, besoj se kolegët për pyetje të mundshme do të përgjigjen, do të mbulojnë edhe mungesën e kolegëve të tyre që nuk janë të pranishëm.

Ju falënderoj që jeni këtu midis nesh! Ju falënderoj edhe për kontributin dhe punën e jashtëzakonshme që keni bërë në këta 8 muaj! Shpresoj që edhe sot të na ndihmoni me komentet dhe me sugjerimet që mund të keni.

Zonja Shtylla, urdhëroni!

**Albana Shtylla** – Faleminderit, zoti kryetar!

Të nderuar deputetë, siç edhe kryetari i komisionit të posaçëm u shpreh pak më parë, materiali informues i detajuar lidhur me procesin që është zhvilluar deri në muajin korrik të vitit

2015, për sa i përket reformës në sistemin e drejtësisë, u është shpërndarë paraprakisht në e-maile.

Në këtë prezantim do të përpiqem të fokusohem në vendimet që ka marrë komisioni i posaçëm në zbatimin e tyre, por, njëkohësisht, edhe me parimet në të cilat është mbështetur ky proces.

Në fakt, fillimi i këtij procesi daton prej muajit tetor të vitit 2014, ku një tryezë e organizuar nga Presidenti i Republikës dhe nga ministri i Drejtësisë u organizua me qëllim diskutimin për çështjet e problematikave që ka sistemi gjyqësor në veçanti, por edhe sistemi i drejtësisë në përgjithësi. Ajo çfarë u konstatua në përfundim të kësaj tryeze është se të gjithë aktorët dhe pjesëmarrësit e kësaj tryeze, qofshin këta politikë apo edhe të pjesës së institucioneve të sistemit të drejtësisë dhe aktorëve të sistemit të drejtësisë, u shprehën të gatshëm dhe njëkohësisht shprehën një vëmendje maksimale për kryerjen e një reforme të thellë, për sa i përket sistemit gjyqësor, por edhe sistemit të drejtësisë në tërësi.

Në vijim, Kuvendi, duke pasur në konsideratë që është edhe institucioni më gjithëpërfshirës, për sa i përket përfaqësimit politik, u mendua të ishte institucioni pranë të cilit do të zhvillohej kjo reformë, kuptohet duke u bazuar në një ekspertizë të mirëfilltë teknike vendase dhe ndërkombëtare.

Në vijim, Kuvendi, ashtu siç jeni të informuar, ka marrë një vendim për ngritjen e një Komisioni të Posaçëm për Reformën në Drejtësi, i cili në zbatim të këtij vendimi ka organizuar rreth 4 mbledhje ku ka pasur edhe një vendimmarrje të caktuar për mënyrën sesi do të ecte procesi dhe cilat do të ishin strukturat në të cilat do të mbështetej ky proces.

Nuk do të doja të numërtoja vendimet që janë marrë pikërisht nga Komisioni i Posaçëm, pasi tashmë ato ju i keni në informacionin e dërguar dhe paraprakisht, por do të desha të theksoj se gjatë këtyre muajve Komisioni i Posaçëm, grupi i ekspertëve të nivelit të lartë vendas dhe ndërkombëtarë, kanë kryer një punë teje intensive, profesionale, me një frymë bashkëpunimi dhe të harmonizuar ndërmjet tyre si për sa u përket eksperiencave që secili prej tyre përcillte në këtë grup të ekspertëve të nivelit të lartë, ashtu edhe për sa u përket standardeve ndërkombëtare dhe eksperiencave të tjera më të mira në rajon, për të cilat do të ishin në diskutim në kuadër të reformës në drejtësi.

Për sa u përket strukturave që do të funksionojnë në mbështetje të Komisionit të Posaçëm, Komisioni i Posaçëm ka marrë një vendim ku i është drejtuar me një shkresë zyrtare të gjitha

institucioneve të drejtësisë, të cilat presupozohen që janë aktorë në proces dhe këtu do të përfshija, në mënyrë të posaçme, një shkresë të dërguar Presidentit të Republikës, Gjykatës së Lartë, Gjykatës Kushtetuese, Këshillit të Lartë të Drejtësisë, Ministrisë së Drejtësisë, por njëkohësisht edhe institucioneve akademike, siç janë universitetet, të cilat ushtrojnë, le të themi, fushën e tyre të studimit në drejtësi apo Shkollës së Magjistraturës, si dhe komisioneve të posaçme të reformave të ngritura pranë Ministrisë së Arsimit në rastin e reformës së arsimit të lartë dhe këshillit për reformën ligjore pranë Ministrisë së Drejtësisë.

Në vijim të shkresës zyrtare të nisur nga Komisioni i Posaçëm këto institucione janë përgjigjur me dërgimin e ekspertëve të nivelit të lartë, të cilët përfaqësojnë në vetvete pikërisht këto institucione të sistemit të drejtësisë dhe këta aktorë të procesit.

Komisioni i Posaçëm mendoj të zhvillonte më tej frymën e ekspertizës dhe të eksperiencës, që do të sillej pranë tij në kuadër të prodhimit të dokumenteve, të cilat do të përpunoheshin për këtë reformë, duke ideuar dhe duke kërkuar në mënyrë të shprehur, nëpërmjet një njoftimi publik në faqen e Kuvendit, edhe pjesëmarrjen apo shprehjen e interesit nga ekspertë, juristë të rinj, juristë të cilët kanë një eksperiencë të caktuar në fusha të ndryshme të sistemit të drejtësisë, juristë që kanë studiuar jashtë dhe kanë një eksperiencë të tillë jashtë Shqipërisë, por, gjithashtu, edhe pedagogë të universiteteve të njohura në vendet e ndryshme të Europës dhe më tej.

Përveç ekspertizës vendase Komisioni i Posaçëm i kushtoi një vëmendje të veçantë edhe eksperiencës ndërkombëtare, duke ideuar që të kishim një eksperiencë ndërkombëtare bashkërisht me eksperiencën vendase. Nisur nga organizatat, misionet ndërkombëtare, të cilat janë në Shqipëri, iu drejtua me një shkresë zyrtare për të pasur përfaqësimin e tyre pikërisht në këtë grup ekspertëve të nivelit të lartë, duke filluar me Komisionin e Venecias të Këshillit të Europës, me misionin Euralius 4 i delegacionit të BE-së, misioni OPDAT dhe USAID të Shteteve të Bashkuara të Amerikës, zyrës OSBE-së në Shqipëri, WFD Foundation i ambasadës britanike dhe njëkohësisht fondacioni SOROS, i cili ka qenë edhe mbështetës në këtë proces të ndjekur nga grupi i ekspertëve të nivelit të lartë.

Do të desha të theksoj që ky grup ekspertësh të nivelit të lartë është mbështetur, në të gjithë procesin e tij, nga një grup i sekretariatit teknik, i cili përbëhet nga përfaqësues të institucioneve, të cilët kanë dërguar juristë, këshilltarë që punojnë pranë tyre dhe që kanë një eksperiencë të gjatë pranë këtyre institucioneve dhe do të veçoja këtu juristë, këshilltarë të Kuvendit të Republikës së Shqipërisë, juristë, këshilltarë të Gjykatës Kushtetuese dhe të Gjykatës së Lartë,

njëkohësisht, edhe përfaqësues të zyrës së Presidentit të Republikës, përfaqësues të Ministrisë së Drejtësisë etj., me radhë. Pra, le të themi, i gjithë procesi në tërësinë e tij, me strukturat, që janë ngritur pranë Komisionit të Posaçëm, është ideuar si një proces me personel dhe ekspertë teknik të nivelit të lartë, por edhe me ekspertë teknikë të nivelit të sekretariatit.

Për sa i përket çështjes, le të themi, mënyrës se si do të fokusohet dhe ndërtohet i gjithë procesi, Komisioni i Posaçëm ka ndërmarrë një vendim lidhur me shtyllat bazë, në të cilat do të bazoheshin reformat. Bazuar në këtë vendim është strukturuar edhe ndarja në grupe të ekspertëve të nivelit të lartë dhe 7 shtyllat kryesore që janë të përmendura në dokument janë: ajo e ndryshimeve kushtetuese, çështjeve të sistemit gjyqësor, të drejtësisë penale, që ka të bëjë me shërbimet ligjore, të edukimit juridik, antikorrupsionin dhe financimin.

Të gjithë ekspertët e nivelit të lartë qofshin këta vendas apo ndërkombëtarë kanë qenë të strukturuar pranë këtyre komisioneve, por ajo çfarë është më e rëndësishmja këto grupe kanë qenë të bashkëdrejtuara nga ekspertët vendas, të cilët ishin përfaqësues të institucioneve që unë përmenda pak më parë, por njëkohësisht edhe nga ekspertët ndërkombëtarë, përfaqësues së misioneve të organizatave ndërkombëtare të atashuara në Shqipëri.

Lidhur me ata që do të konsiderohen si parime të procesit, duke mos u ndalur te pjesa që ka të bëjë me vendimet e tjera të komisionit, do të theksoja që 4 kanë qenë parimet kryesore: gjithëpërfshirja, parimi i parë; profesionalizmi, standardet ndërkombëtare, transparenca dhe konsultimi publik.

Për sa i përket gjithëpërfshirjes besoj se atë çfarë thashë pak më parë, nënkupton që në këtë proces nëpërmjet përfaqësuesve të tyre kanë qenë të thirrur drejtpërdrejtë për të shprehur mendimet dhe qëndrimet e tyre institucionet e përfaqësuara me ekspertët vendas. Njëkohësisht atë çfarë thashë pak më parë, duke qenë se kemi përfaqësues sekretariatit teknik edhe institucionet e tjera të sistemit të drejtësisë dhe aktorët e tjerë të sistemit të drejtësisë, duke i kërkuar ndjesë edhe Dhomës Kombëtare të Avokatisë dhe Shkollës së Magjistraturës, kanë pasur mundësinë të shprehin qëndrimet dhe vlerësimet e tyre. Po kështu, do të desha të theksoj se rrjeti i konsultimit publik i ngritur me profesionistë, siç thashë pak më parë, juristë të rinj që kanë studiuar jashtë; njëkohësisht, të gjithë gjyqtarët e të tria shkallëve të gjyqimit, prokurorët e të gjitha shkallëve; njëkohësisht, të gjithë avokatët dhe subjektet e tjera të profesioneve të lira, pra, noteria, dhoma e ndërmjetësimit kanë qenë pjesë e këtij rrjeti të konsultimit publik. Për më

tepër pjesë e rrjetit të konsultimit publik kanë qenë edhe organizatat e shoqërisë civile, të cilat ushtrojnë dhe kanë në fushën e tyre të veprimtarisë çështje të drejtësisë.

Pra, do të thosha që kjo gjithëpërfshirje ka shkuar edhe përtej institucioneve, ka shkuar drejtpërdrejt edhe tek ata persona, të cilët zbatojnë drejtpërdrejt të gjithë bazën ligjore në fushën e drejtësisë, por jo vetëm, edhe aktorët e tjerë të shoqërisë civile, të cilët mbikëqyrin apo monitorojnë sesi zbatohet pikërisht ky legjislacion nga organet e drejtësisë.

Po kështu, do të theksoja se për sa i përket gjithëpërfshirjes përveç këtij rrjeti të konsultimit publik, që e përmenda pak më parë, ne kemi pasur nderin të kemi edhe pedagogë të universiteteve ndërkombëtare, duke filluar me Universitetin e “La Sapienza”, universitetet e Austrisë, të cilat kanë dhënë kontributin e drejtpërdrejtë me mendimet dhe opinionet e tyre për sa u përket dokumenteve të prodhuara nga grupi i ekspertëve të nivelit të lartë të ngritur nga Komisioni i Posaçëm.

Profesionalizmi. Ju në informacionin dhe në raportin e dërguar keni të gjithë *background-in* profesional të ekspertëve vendas, por edhe të ekspertëve ndërkombëtarë. Unë do të theksoja që përvoja e tyre profesionale, *background-i* i tyre kanë qenë shtylla e fortë e mbështetjes për të pasur një vlerësim dhe një produkt të këtij grupi të nivelit të lartë tejet profesional dhe teknik të mbështetur dhe të harmonizuar me dy eksperiencat, siç thashë pak më parë, vendase dhe ndërkombëtare.

Për sa u përket standardeve ndërkombëtare do të desha të theksoja se dokumenti i parë, analiza e sistemit të drejtësisë, por jo vetëm, është një analizë e prodhuar duke u bazuar në standarde të tilla të rëndësishme si: standardet ndërkombëtare të *acquis communautaire*, pra, të BE-së; njëkohësisht vendimet e Gjykatës Europiane të të Drejtave të Njeriut; opinionet dhe rekomandimet e Komisionit të Venecias dhe më tej akoma, standardet e tjera ndërkombëtare të pranuar dhe të ratifikuara nga Republika e Shqipërisë. Këto standarde kanë qenë pjesë e vlerësimit dhe njëkohësisht të diskutimit të grupeve të ekspertëve të nivelit të lartë. Madje, kanë qenë udhërrëfyese në atë çfarë ata kanë analizuar, por edhe prodhuar.

Për sa i përket transparencës dhe pjesëmarrjes së publikut ne kemi përmendur në brendësi të informacionit dhe të raportit një sërë shifrash dhe këtu do të filloja: E para, me vetë atë çfarë mund të konsiderohet konsultimi i këtij dokumenti. Janë organizuar 7 tryeza në përfundim të fazës së parë, pra, të analizës së sistemit të drejtësisë; ka pasur një ndërmarrje për çdo tryezë nga 80 deri në 100 pjesëmarrës, ku pjesëmarrës kanë qenë jo thjesht aktorë të sistemit të drejtësisë,

pra, gjyqtarë, prokurorë, avokatë, noterë, por, njëkohësisht, edhe përfaqësues të organizatave të shoqërisë civile.

Një tjetër e dhënë e rëndësishme janë pikërisht edhe forumet e organizuara në 9 universitete të Shqipërisë, duke filluar me Universitetin e Shkodrës, të Vlorës, të Korçës, të Gjirokastrës, të Elbasanit, të Tiranës dhe të Durrësit. Pra, ka pasur një shtirje të diskutimit edhe në këto forume akademike duke besuar në akademizmin e tyre, në profesionalizmin e tyre për të pasur prurje dhe gjetje e vlerësime tejet akademike dhe profesionale.

Një tjetër element i rëndësishëm për sa i përket transparencës, do të desha të theksoj se është pikërisht *portali online* i kësaj reforme. Nëse do të aksesoni në të, do të vini re që është një portal, i cili jo vetëm përcjellë në kohë reale punën e kryer nga çdo nëngrup dhe nuk ka qenë e pakët kjo punë. Vetë nëngrupet kanë arritur në shifrat deri në 120 mbledhje gjatë këtyre muajve, por, njëkohësisht, edhe dokumentet e prodhuara prej tyre. Njëkohësisht, portali është i hapur për pyetjet e bëra nga publiku për ekspertët.

Nga ana tjetër, portali është i hapur për të mbledhur opinionet dhe mendimet nga publiku, lidhur me dokumentet e prodhuara pikërisht nga grupi i ekspertëve të nivelit të lartë.

Pra, do të theksoja që për sa i përket transparencës dhe pjesëmarrjes së publikut, grupi i ekspertëve të nivelit të lartë ka qenë tejet i kujdesshëm për të mbledhur sa më shumë informacion dhe njëkohësisht edhe opinione dhe mendime.

Për sa u përket elementeve të tjera, që kanë të bëjnë me fakte dhe të dhëna, unë nuk do të desha të ndalem. Nëse anëtarët e Komisionit të Posaçëm do të kishin pyetje të caktuara, jam e hapur për t'iu përgjigjur.

Në përfundim do të desha të theksoj se kjo është një punë që është bërë në grup. Një punë, e cila ka pasur një harmoni ndërmjet ekspertëve vendas dhe ndërkombëtar. Është një punë që është mbështetur në profesionalizmin, në akademizmin e këtij grupi dhe me thënë të drejtën ne si sekretariat teknik jemi ndier tejet të nderuar që kemi mundur t'i mbështesim, le të themi, si sekretariat teknik për të prodhuar këto dokumente të rëndësishme, siç është analiza, strategjia dhe plani i veprimit.

Për sa i përket stadi në të cilin jemi, dhe këtu do ta mbyllja. Ju, tashmë, e keni edhe në format elektronik, por edhe në variantin e printuar, një pjesë prej jush; keni dokumente që janë prodhuar deri tani nga grupi i ekspertëve të nivelit të lartë. Pra, kemi një analizë të sistemit të drejtësisë, e cila për sa i përket thellësisë së saj, dua të theksoj që është ndoshta një nga të rrallat,



që mund të jetë kryer në këta 20 vjet në Shqipëri. Kuptohet, në brendinë e saj janë përmbledhur edhe dokumente apo analiza të prodhuara në vite në Shqipëri, por njëkohësisht ka produkt të drejtpërdrejtë të bazuar mbi informacione të marra edhe nga vetë institucionet e sistemit të drejtësisë dhe nga grupi i ekspertëve të nivelit të lartë.

Së dyti, keni një dokument, që është draft-strategjia për reformën në sistemin e drejtësisë. Për mënyrën sesi ajo është konceptuar është menduar që në këtë të përmbledhen ato çfarë janë objektiva, vizioni i reformës në drejtësi, por edhe më tej, duke përcaktuar masat të cilat janë të nevojshme, masat kushtetuese apo ligjore apo edhe institucionale, për zbatimin e këtyre objektivave të strategjisë së reformës në drejtësi.

Së treti, keni përsëri një dokument të prodhuar, që është draft- plani i veprimit, ku do të theksoja që në këtë draft-planveprimi nuk ka, as më shumë, as më pak, por masat e receptuara dhe të ideuara nga grupi i ekspertëve të lartë janë hedhur në këtë planveprimi duke përcaktuar pikërisht institucionet përgjegjëse dhe kohën apo afatet e realizimit të tyre.

Nëse ka ndonjë pyetje, jam e gatshme t'u përgjigjem.

Faleminderit!

**Fatmir Xhafaj** – Faleminderit, zonja Shtylla!

Ndërkohë, dua t'u bëj me dije medieve që të mos shqetësohen se të gjitha dokumentet që janë sot në këtë tavolinë do t'ua vë në dispozicion sapo të mbaroj mbledhja e Komisionit të Posaçëm Parlamentar.

Jam i bindur që gazetarët do t'i lexojnë me vëmendje si zakonisht dhe do të jenë pjesë e një debati të gjatë mediatik. Po jua them këtë fakt që të mos bëni atë zakonshmen duke thënë: ku e kam atë kopjen time, kush ta kapë më përpara. Do ta merrni të gjithë.

Ka pyetje? Zoti Halimi, urdhëroni!

**Eduard Halimi** – Faleminderit!

Lidhur me raportin e paraqitur nga zonja Shtylla unë kisha dy- tri pyetje për një çështje, që ka të bëjë me vendimin e fundit të komisionit, sepse kjo është në fakt mbledhja e dytë e komisionit. Një mbledhje e mëparshme u bë në sallën e Kuvendit me mirëkuptimin e palëve. Për sa i përket vendimit të asaj mbledhjeje ne jemi dakordësuar me kryetarin që ka një gabim teknik. Pra, që 7 ekspertët e propozuar nga Partia Demokratike do të jenë pranë grupeve të punës së ekspertëve të nivelit të lartë dhe pranë sekretariatit teknik. Pra, përfaqësuesit tanë do të jenë 7 ekspertë në 7 grupe. Kështu që besoj se kjo është një çështje që nuk dua të marr as kohë dhe as

përgjigje, sepse është dakordësuar përpara se të fillonim mbledhjen. Por kam disa pyetje në lidhje me dokumentet të cilat ju i prezantuat. Lidhur me planin e veprimit nuk kam ndonjë pyetje..

**Fatmir Xhafaj** – Më fal, flisni për materialin që paraqiti zonja Shtylla apo për tri dokumentet në pikën 2 dhe 3?

**Eduard Halimi** – Raporti flet që janë miratuar këto...

**Fatmir Xhafaj** – Dakord.

**Eduard Halimi** – Pra, vetë raporti thotë që kanë përfunduar këto faza. Po them, për pjesën e planit të veprimit nuk kam ndonjë pyetje apo shqetësim. Ai është ritmi i maxhorancës dhe ne do ta ndjekim sipas planit të veprimit, ditën apo natën kurdo që ta ketë, kur të jemi bashkë për të vepruar procesin.

Lidhur me dokumentin analitik unë kam disa pyetje. Në këtë dokument raporti që ju sillni (lidhur me organizmin e tryezave, që janë bërë që, për hir të së vërtetës, ne i kemi parë dhe ndjekur nga mediet ato tryeza, që janë zhvilluar), në këtë raport jepen vetëm pjesë nga fjalimet, nga fjalët përshëndetëse që kanë mbajtur personalitetet që kanë qenë atje dhe nuk jepet në raport, impakti që ka dalë nga këta. Pra çfarë sugjerimesh kanë dalë dhe sa janë implementuar? Sepse nga një krahasim që i bëj draftit të parë të zbatuar, pra, paraprakisht në faqe, si i vetmi dokument që është parë në portal, në draftin final, nuk e shikoj pjesën e implementimit.

Pra, pyetja ime është: në këtë raport nuk janë pasqyruar, por a gjenden diku këto? Po them në tryezën që është organizuar në Durrës u propozuan 5 gjëra. U implementuan këto 5 çështje? Apo u morën 5, apo u morën 3 dhe 2 nuk u morën parasysh? Nuk i gjej në raport. Kjo është pyetja e parë.

Pyetja e dytë ka të bëjë me dokumentin tjetër, që është dokumenti i strategjisë. Në portalin e komisionit ky dokument nuk gjendet dhe ne kemi marrë, po themi, përpara 4-5 ditësh, por a është konsultuar ky dokument, pra, ky draft me grupet e interesit? Strategjia flas. Unë i kam parë ato publikimet që ju keni bërë për tryezat në Shkodër, në Pogradec. E kam parë edhe përmbajtjen. Tani po ju pyes, ky draft, (analiza thashë është diskutuar, se e shikoj), pra, drafti i strategjisë është diskutuar me aktorët e interesit? Nëse po, cilat janë impaktet që kanë keni marrë nga ata? Këto pyetje kisha.

**Fatmir Xhafaj**- Atëherë po filloj nga pika e parë, lidhur me ekspertët. Dëshiroj ta bëj të qartë që në këta 8 muaj ka një qasje, që është e padiskutueshme dhe e panegociueshme, është

fryma e vendimit të Kuvendit dhe relacionit që shoqëron vendimin e Kuvendit. Procesi i reformës në drejtësi bazohet në një shtyllë bazë të rëndësishme, që është asistenca, konsulenca dhe produktet e punës së grupit të ekspertëve vendas dhe ndërkombëtarë, ku janë përfshirë të gjithë aktorët ndërkombëtarë, që asistojnë, monitorojnë sistemin e drejtësisë në Shqipëri, por edhe aktorë të rëndësishëm, që certifikojnë reformat në të gjitha vendet europiane, siç është rasti i Këshillit të Europës së Venecias, e kështu me radhë.

Nga kjo pikëpamje, grupi i ekspertëve të nivelit të lartë nuk është një grup partiak dhe i ndërtuar mbi preferencat partiake, as të grupeve politike të përfaqësuara në parlament. Ekspertët që kërkoi grupi parlamentar i Partisë Demokratike dhe i Partisë Republikane janë pjesë, janë atashuar si ekspertë të këtyre dy grupeve politike parlamentare pranë 7 grupeve të punës për të asistuar dhe për të mbështetur punën e kolegëve deputetë të opozitës në këtë komision. Ndryshimi teknik, për të cilin kemi folur me zotin Halimi do të bëhet në funksion të kësaj qasjeje.

Për sa i përket çështjes së dokumentit analitik kam përshtypjen që ishte i qartë. Është në material, por është i përfshirë. Por duhet të kemi një gjë të qartë. Dokumenti analitik është bërë publik dhe është pasqyruar në faqen *online* në datën 8 qershor. 7 tryezat që kishin të bënin me 7 shtyllat e reformës janë bërë përpara datës 8 qershor dhe grupet, megjithëse e kishin mbaruar, kanë paraqitur në këto 7 tryeza dokumentin analitik paraprak, kanë diskutuar 7 pjesët e dokumentit analitik në secilën tryezë të organizuar posaçërisht për konsultimin e këtyre 7 pjesëve, që janë 7 shtyllat kyçe të reformës dhe ato janë reflektuar. Kjo është e qartë edhe në materialin e paraqitur, në përmbajtje dhe janë të pasqyruara në dokumentin përfundimtar të datës 8 qershor.

Natyrisht, të shtata këto tryeza janë të regjistruara audio dhe procesverbalet janë të zbardhura. Kush dëshiron të lexojë më shumë, është i lutur të hapë portalin *online*, ku janë të pasqyruara, ose nëse janë në proces zbardhjeje Kuvendi mund t'i vendosë në dispozicion.

Së dyti, strategjia:

*(Ndërhyrje pa mikrofon.)*

Edhe meqenëse ma kërkove që në fillim që të prisja të të dëgjoja ty, tani më dëgjo edhe ti mua. Ki durim! Më lër të vazhdoj, unë nuk të ndërpreva!

Strategjia, është e vërtetë që nuk gjendet në portalin *online*, sepse do të dalë sot në portal, sapo të mbarojë kjo mbledhje komisioni, ku të reflektohen sugjerimet apo komentet që mund t'i

bëhen atij dokumenti. Strategjia është konsultuar me grupet e interesit gjatë forumeve që janë zhvilluar në qendrat universitare, 9 forume në mos gaboj, kjo është thënë edhe në dokument, ku drejtuesit, bashkëdrejtuesit e grupeve që janë këtu, të cilët kanë drejtuar edhe këto forume, kanë kërkuar vazhdimin e komenteve, nëse ka pasur të tilla, për analizën, kryesisht çështje që mund të ngrihen në nivelin e një dokumenti strategjik. Opinione që janë dhënë janë të tilla dhe janë reflektuar në këtë dokument që kemi sot në tavolinë.

Për sa u përket atyre çështjeve që nuk kanë kuptim t'u jap përgjigje: pse këtu janë marrë referencat e ambasadorëve, partnerëve ndërkombëtarë, besoj se është e mjaftueshme, nuk ka ndonjë gjë.

**Eduard Halimi** – Unë thashë se aty janë fjalët përshëndetëse dhe shumë mirë për këtë gjë, sepse ato janë mesazhe, por mungon kjo tjetra. Unë nuk kam problem fare me atë pjesë.

**Albana Shtylla** – Zoti kryetar, ne e kemi përmendur tek informacioni, dhe dua ta sjell në vëmendje të zotit Halimi, në faqen 11, në faqen 12 dhe më tej, ku është thënë se në tryezat e zhvilluara gjatë muajit maj janë hedhur mendimet dhe opinione e të gjithë pjesëmarrësve në këto kryezeza. Gjithashtu është thënë se këto mendime dhe opinione i janë përcjellë grupit përkatës të ekspertëve të nivelit të lartë. Pra, nëse është bërë tryezë për mendimet kushtetuese, ka pasur mendime dhe opinione të shprehura në të, i janë përcjellë grupit të ekspertëve të nivelit të lartë dhe më tej është thënë përsëri, pas vlerësimit të tyre, ato janë bërë pjesë e dokumentit analitik të prodhuar së fundi. Pra, ne në raportin dhe në informacionin që i kemi përcjellë komisionit të posaçëm e kemi thënë këtë gjë. Pra, ekspertët të nivelit të lartë, sipas grupeve përkatëse, kanë integruar. Nëse kërkojnë pikërisht atë që thatë edhe ju, se çfarë është thënë konkretisht, këto tryeza janë të regjistruara dhe presupozohet që mund të jenë disponibël për anëtarët e komisionit të posaçëm për t'i parë dhe për t'i vlerësuar.

Faleminderit!

**Fatmir Xhafaj** – Faleminderit, zonja Shtylla!

Ka pyetje të tjera?

Po, zoti Bylykbashi.

**Oerd Bylykbashi** – Zoti kryetar, në vijim të kësaj që u diskutua deri tani, unë besoj se çështja e transparencës është themelore.

**Fatmir Xhafaj** – Pyetje?

**Oerd Bylykbashi** – Po, po.

Nuk besoj se aq sa u diskutua deri tani e ezauroi këtë debat. Sapo dëgjova edhe zonjën Shtylla, e cila tha se këto çështje të ngritura janë marrë dhe janë bërë objekti i punës së një grupi të ekspertëve. Po ashtu ju dëgjova edhe juve kur thanë se janë të konsultueshme. Me sa shoh unë këto janë referenca të përgjithshme: kush foli, çfarë tha, citime, dhe konkluzionet nuk janë në faqe. Kështu që unë dhe të gjithë kolegët, besoj, do të kishim shumë interes që këto materiale pune, nëse është e mundur, të na vihen në dispozicion. Konkretisht këto lloj konkluzionesh, qoftë edhe minutat, por edhe raporte dhe konkluzionet e këtyre takimeve, për të parë se çfarë elementesh të vlefshme kanë propozuar dhe për të matur ne, përpara se të japim një gjykim tonin, nëse këto janë bërë pjesë e analizës së sistemit të drejtësisë në Shqipëri. Pra, pyetja është: a mund të na vihen dhe kur mund të na vihen në dispozicion gjithë këto informacione? Ne jemi anëtarë të komisionit dhe sigurisht mund ta konsultojmë nga *website*, por do të ishte mirë që ne t'i kishim në dispozicion, që më pas të kemi mundësi të bëjmë një gjykim.

Pra, një debat i thjeshtë për të thënë që aty i keni, ose u thanë dhe ne i reflektuam nuk mjafton, sepse shpeshherë gjendemi përpara tryezave që bëhen, por kurrë konkluzionet e tyre nuk reflektohen. Kështu që, zonja Shtylla, do të doja të dija nga kur mund t'i kemi në dispozicion këto materiale?

**Albana Shtylla** – Siç e thashë pak më parë, materialet janë të regjistruara në variantin audio dhe të zbardhura. Ne mund t'ua vëmë në dispozicion të dyja variantet, edhe atë audio, edhe atë zbardhur. Ka pasur një zbardhje të tyre nga Shërbimi i Informacionit dhe Dokumentacionit të Kuvendit dhe në momentin më të parë do t'i keni në dispozicion.

**Fatmir Xhafaj** – Zoti Mediu, keni fjalën.

**Fatmir Mediu** – Vështirë që të kuptohemi. Ajo që po kërkojnë kolegët nuk është marrja e materialeve bruto, audio apo të shkruara. Sekretariati teknik ka një funksion: të mbledhë të gjitha qëndrimet, opinionet dhe debatet që bëhen, që më pas t'ia referojë komisionit të posaçëm.

**Fatmir Xhafaj** – Cila është pyetja juaj, zoti Mediu.

**Fatmir Mediu** – Pra, ajo që kërkojmë ne është që ju të na referoni për qëndrimet që ka sekretariati teknik apo ekspertët e nivelit të lartë në bazë të debateve dhe diskutimeve që janë bërë.

**Fatmir Xhafaj** – Dakord.

Zoti Ristani, keni fjalën.

**Arben Ristani** – Synimi i strategjisë është shprehur në dokumentin dhe nisët nga premisa të tilla, si: cilësia shumë e dobët e legjislacionit në këto 25 vjet, si pasojë e...

**Fatmir Xhafaj** – Do ta diskutojmë më pas atë strategji. Për dokumentin që ka paraqitur zonja Shtylla keni ndonjë pyetje? Nuk keni.

A ka pyetje të tjera? Nuk ka.

Diskutime.

Po, zoti Halimi.

**Eduard Halimi** – Në lidhje me punën e paraqitur për raportin, dua të jap edhe konsideratat tona, si përfaqësues të pozitës.

Për herë të parë çështja e reformës në drejtësi është diskutuar në tryezën e nivelit të lartë, në takimin e nivelit të lartë, midis opozitës, Kryeministrit dhe qeverisë me komisionarin Fyle ditën që do t'i jepej Shqipërisë statusi i vendit kandidat. Takimi është pa praninë e medieve, siç është bërë edhe më parë. Por më duhet të tregoj një hollësi të rëndësishme të procesit. Në atë takim u dakordësua me ndërmjetësimin e ish-komisionerit që reforma në drejtësi të kryhej sipas kërkesës që ne si opozitë i bëjmë Kryeministrit, që kishte të bënte me një komision, i cili duhet të ngrihej dhe të udhëhiqej nga ekspertiza ndërkombëtare. Minutat e takimit janë aty, mediet janë këtu, nëse kjo që po them nuk është e vërtetë, le ta krahasojnë. Kryeministri ka refuzuar dhe është zhvilluar një debat rreth 45 minuta në lidhje me këtë çështje, pra me çështjen që ekspertiza ndërkombëtare do të ishte ajo që do të udhëhiqte reformën. Sigurisht, komisioneri mori kohë për ta vijuar procesin. Ajo që ndodhi pas marrjes së statusit të gjithë e mbajmë mend. Pra, maxhoranca refuzoi që ta ngrinte këtë komision, dy javë më vonë miratoi tri ligje pa ekspertizë ndërkombëtare, pa konsulencë, në kundërshtim me kërkesat e BE-së, në kundërshtim me thirrjet e ambasadorëve dhe partnerëve strategjikë në Shqipëri, (besoj se i mbani mend netët dhe ditët e fundit të muajit korrik të vitit të kaluar), me synim miratimin me urgjencë, sipas Kryeministrit, të tri ligjeve. Kjo është e vërteta. Tri ligje, të cilat synonin ndryshimin e karrigeve në disa institucione, pra kapjen. Ndryshuan tri anëtarë të KLD-së; bënë ligjin “Për Gjykatën e Lartë”, ku futën ministrin që të propozonte anëtarët e Gjykatës së Lartë; ndryshuan drejtorin e Shkollës së Magjistraturës. Pra, tri ligjet që ishin me emergjencë kishin këtë synim. Më pas, për shkak edhe të rrethanave që të gjithë ju i mbani mend, opozita nuk mori pjesë në parlament me kërkesën e saj për dekriminalizimin dhe ishte jashtë parlamentit deri në datën 24 dhjetor, ditë kur arriti marrëveshjen, përsëri me ndërhyrjen e partnerëve ndërkombëtarë, për realizimin e

dekriminalizimit të parlamentit, proces i cili vazhdon punën e tij. Kjo për sa i përket ditës deri kur opozita u bë pjesë me kërkesën e saj, ku kishte dy çështje: bashkëkryesimin dhe paritetin.

Sigurisht, këtë diskutim ne e kemi bërë, edhe falë ndërhyrjeve dhe diskutimeve me partnerët ndërkombëtarë u arrit që ne të jemi pjesë e procesit, siç jemi sot dhe do të vazhdojmë të jemi, me një qëllim dhe qëndrim të qartë, për ta nxjerrë sistemin e drejtësisë nga status quo-ja në të cilën ndodhet, për të dhënë impakt konkret në të gjithë punën e Komisionit të Reformës për Drejtësi.

Në lidhje me çështjen e ekspertizës, kjo është një çështje thelbësore. Ka qenë kusht para ditës së çeljes së negociatave nga opozita, që reforma në drejtësi duhet të bëhet me ekspertizë ndërkombëtare për të vetmen arsye: sepse kur bëhet pa ekspertizë ndërkombëtare, e kemi parë se çfarë ndodh, pra ndodh kapja jashtë standardeve. Kemi besim tek ekspertiza ndërkombëtare dhe rruga europiane në të cilën ekspertët ndërkombëtarë do ta udhëheqin procesin.

Për sa i përket gjithë punës së ekspertëve, PD-ja ka propozuar ekspertët që të jenë pranë grupeve të punës, grupe të cilat do të gatujnë pjesën e dokumenteve bazë, me të cilat reforma do të miratohet në komision. Reforma në fund është ligj dhe ligji do të miratohet në Komisionin e Reformës. Por opozita ka kërkuar që zëri opozitar të ishte që në momentin e formulimit të tezave, në mënyrë që edhe partnerët ndërkombëtarë, edhe ekspertët ndërkombëtarë të shohin se cili është zëri opozitar në këtë proces, që në atë moment, dhe të zvogëlojmë sa më shumë debatet politike që ne, sigurisht, nuk mund t'i shmangim dot në maksimum, edhe pse jemi një komision që përbëhet nga ekspertë juristë. Ndaj, në këtë proces ne kërkuam që të jenë ekspertët, të cilët do të jenë, do të diskutojnë, gjithçka aty nuk do të merret me vendim, sepse vendimet do të merren në këtë komision.

Në lidhje me pjesën e raportit që flet për përmbylljen e dy fazave të para, më duhet të theksoj se të dyja dokumentet, qoftë dokumenti i analizës, qoftë dokumenti i strategjisë, duhet të jenë dokumente të përbashkëta, pra duhet të jenë si një e tërë, sepse analiza nga njëra anë diagnostikon se cila është gjithë problematika e gjithë sistemit, ndërsa strategjia jep ilaçin sesi do të shërohet sistemi. Kjo metodologji është krejt korrekte. Ne jemi dakord që në këtë metodologji duhet të ecet, në mënyrë të padiskutueshme. Por analiza duhet të jetë gjithëpërfshirëse, duhet të jetë një pasqyrim i saktë i realitetit, gjë të cilën ne do ta diskutojmë edhe në pikat e tjera. Ne kemi qëndrimet tona që nuk e paraqet në mënyrë të saktë gjithë realitetin e sistemit të drejtësisë, një pasqyrë e sistemit të drejtësisë së këtyre 16 vjeteve që ka marrë në këtë proces. Ndaj, edhe ne, opozita, kërkojmë që brenda këtyre javëve në vijim të paraqesim pjesët përkatëse të

dokumentit, pra të pasqyrës së sistemit të drejtësisë në këto 16 vjet. Sikurse, ajo që është më e rëndësishme, procesi i dhënies së zgjidhjeve duhet të jetë një proces gjithëpërfshirës dhe transparent. Ne këtu të gjithë ramë dakord që ky proces nuk është kryer për sa i përket strategjisë.

Mjafton të shohësh (po e rishihja përsëri, meqenëse më thatë se duhet të shohësh në faqe) në *website*-n e reformës në drejtësi. Aty shoh se konsultimi i fundit që është kryer, sipas faqes, është konsultimi publik në Shkodër dhe tema ka qenë: “Në vijim të konsultimeve publike për komponentët kryesorë të dokumentit analitik të sistemit të drejtësisë në Shqipëri. Në këtë takim u prezantuan aspektet kryesore të këtij komponenti dhe u analizua kuadri kushtetues në të cilin ushtrojnë veprimtaritë e tyre institucionet e sistemit të drejtësisë”. Ky është lajmi i fundit. Lajmi i parafundit është ai në Pogradec, i cili është i vetmi ku thuhet që u tërhoqën edhe mendime për strategjinë.

Pra, është e qartë që strategjia nuk është konsultuar; është e qartë që strategjia nuk ka marrë impakt, për mendimin tim; është e qartë që në dokument nuk jepet mpakti që ka ardhur nga diskutimet edhe për analizën, pra imputi kanë dhënë këto tryeza, si është pasqyruar ky imput. Pra, është e qartë që nuk janë dhënë.

Ndaj, për sa i përket raportit, unë do të isha dakord që ky raport, nuk besoj se ka nevojë për miratim, të kalojë, por me rezervën e këtyre dy dokumenteve. Pra, pjesa e këtyre dy fazave që thuhet se kanë përfunduar, por, në fakt, këto dy faza nuk kanë përfunduar, nuk ka përfunduar as pjesa e transparencës, pra e konsultimit publik, as pjesa e marrjes së imputit të konsultimit publik. Se sa i marrim parasysh, kjo është çështje ekspertëve, po aq sa çështje e kësaj tryeze, po aq sa çështja e dokumentit strategjik, i cili nuk jep zgjidhje konkrete të çështjeve, pra i jep evazive. Nuk mund ta quajmë të përfunduar një fazë as sot, as pas një muaji në rast ne si komision nuk miratojmë zgjidhje konkrete. Diagnostikojmë si problem, po përmend KLD-në, dhe nuk japim një zgjidhje konkrete, jo draft, ai është më vonë, një zgjidhje konkrete, por japim tre. Këtu jemi evazivë. Ne nuk mund ta miratojmë dhe ta quajmë të përmbyllur një fazë që është evazive.

Këto çështje duhet të diskutohen nga një tryezë publike, nuk ka problem, kur ta çmoni, ju në çdo kohë, ku ne si opozitë do të japim impaktet tona për të dyja dokumente. Por në çdo kohë duhet të organizohet një tryezë publike, të dëgjohet se cili është mendimi i grupeve të interesit,



aktorëve të sistemit, nëse i marrim apo jo parasysh, kjo është çështja jonë, por e kemi për detyrë t'i dëgjojmë. Më pas ne të dalim me një zgjidhje konkrete.

Vetëm kur ne të dalim me një zgjidhje konkrete për secilin nga probleme që kemi, vetëm në atë rast mund të themi se këtë fazë e kemi të përfunduar. Më pas ekspertëve, të nivelit të lartë, të nivelit të ulët e të tjerë me radhë, siç janë ndarë nëpër grupet e punës, u japim detyrën për të draftuar atë që ne kemi rënë dakord. Kjo është një metodologji, e cila duhet të bazohet tek ato standarde që ne kemi theksuar, jo vetëm ne, por edhe partnerët ndërkombëtarë, pra te gjithëpërfshirja, konsulenca dhe zgjidhja. Mund të arrijmë në një zgjidhje, për të cilën ekspertët ndërkombëtarë apo Komisioni i Venecias mund të na thotë se nuk është kjo zgjidhja. Mund të kemi një model që duhet të ndërtojmë modelin tonë dhe që mund të jetë eficient, por që mund të mos jetë brenda standardeve. Mund të huazojmë ndonjë model apo skenar tjetër, për të cilin secili mund të jetë skeptik, skenarin ukrainas, një model që vjen nga ekspertët, por mund të ndërtojmë edhe një model tjetër.

Në përfundim, dua të them se ky raport duhet të pasqyrojë edhe impaktin që ka ardhur nga tryezat konsultative për të gjitha dokumentet. Pra, janë zhvilluar shtatë tryeza, të cilat kanë sjellë 20 propozime, nga këto propozime ne kemi implementuar dhjetë. Këtë gjë duhet ta thotë raporti.

E dyta, raporti duhet të përfshijë jo përmbylljen e dy fazave, por lënien e një afati, të cilin mund ta diskutojmë dhe të biem dakord, që dokumentet, para se ne t'i miratojmë, duhet të bëhen me një diskutim publik dhe të dyja dokumentet duhet të jenë bashkë. Prandaj edhe ramë dakord që diskutimi më pas të jetë bashkë, sepse diagnostikimi dhe zgjidhja duhet të jenë bashkë të dyja, nuk duhet të kenë ndryshim. Po them: propozojmë në dokumentin e analizës që të forcojmë Konferencën Gjyqësore, po ju jap një shembull, dhe në strategji vërejmë që si sugjerim është shkrirja e Konferencës Gjyqësore, këto janë nonsense. Japim në analizë dhe përmendim progresraportin, i cili thotë se nuk duhet të kemi gjyqtarë nga jashtë sistemit në Gjykatën e Lartë, sepse kështu Gjykata e Lartë është më profesionale, dhe vijmë më pas te strategjia, ku propozojmë që si e si të marrim gjyqtarë nga jashtë sistemit. Prandaj këto të dyja duhet të jenë bashkë dhe ky proces duhet të jetë bashkë, në mënyrë që edhe gjetja, domethënë fakti që është aty, edhe zgjidhja, duhet të jenë bashkë. Prandaj them që ky raport duhet t'i ketë këto dy çështje të evidentuara.

Faleminderit!

**Fatmir Xhafaj** – Faleminderit!

Ka diskutime të tjera? Po, zoti Ristani!

**Arben Ristani** – Unë do të doja ta përforcoja edhe pak mendimin e kolegut, sepse në dokument flitet për një moment historik, për një reformë historike, që sigurisht i takon “Rilindjes”, dhe janë bërë shtatë konsultime, që sigurisht janë pjesë e kësaj historie; kanë qenë 80-100 pjesëmarrës të fushës: gjyqtarë, prokurorë në këto 7-8 konsultime. Këta njerëz, sigurisht, janë pjesë e kësaj historie dhe këtij momenti historik. Neve me të drejtë na duhen mendimet që ata kanë dhënë, çfarë ata menduar se duhet ndryshuar apo duhet përmirësuar në sistem, në mënyrë që edhe ne t’i konsultojmë mendimet e tyre dhe me të drejtë të jemi pjesë e kësaj historie. Vetëm kështu dokumenti do të jetë real, nuk do të jetë mashtrues, por një dokument, i cili...

**Fatmir Xhafaj** – Zoti Ristani, unë besoj se duhet ta kontrolloni gjuhën. Nuk është serioze për ju.

**Arben Ristani** – Unë jam shumë serioz në këtë që po them.

**Fatmir Xhafaj** – Nuk ka ndonjë problem për mua, sepse është një qasje që e kam parë, por problemi është se...

**Arben Ristani** – Keni konsultuar shtatë tavolina me shtatë...

**Fatmir Xhafaj** – Historia nuk fillon kur ulenu ju këtu në këtë tavolinë...

**Arben Ristani** – A ka mundësi të mos ndërhyni? Unë po i referohem dokumentit. Dokumenti thotë: “Moment historik, reformë historike”.

Tani po duam të bëhemi pjesë e kësaj historie të re që po fillon me ju. Janë konsultuar 7 tavolina me 700 specialistë të fushës, 700 gjyqtarë dhe prokurorë që kanë dhënë mendime për këtë, sipas këtij dokumenti. Besoj se, me të drejtë, të gjithë kolegët duam që mendimet e vjera të këtyre 700 burrave dhe grave: ekspertë, gjyqtarë, prokurorë, që kanë dhënë mendime ne të dimë se çfarë ka dalë nga kjo konsulencë, cilat janë mendimet e tyre, që janë implementuar, si e mendojnë ata se duhet zhvilluar sistemi. Besoj se vetëm në këtë formë do të jemi përballë një rezultati të mirë dhe të vërtetë, pra jo një rezultati të rremë, jo mbi baza të pakonsultuara, jo mbi baza që nuk pasqyrojnë të vërtetën.

**Fatmir Xhafaj** – Kam përshtypjen që, në vlerësimin tim, siç është vlerësimi juaj, që u nxitua paksa. Këtu nuk flitet për dokumente mashtruese.

*(Ndërrhyrje pa mikrofon.)*

Pra, vutë në diskutim legjitimitetin e dokumentit dhe për rrjedhojë legjitimitetin e atyre që kanë prodhuar këtë dokument. Mendoj që keni gabuar!

**Eduard Halimi** – Të mos e çojmë në një tension të panevojshëm.

**Fatmir Xhafaj** – Ju lutem, mos më ndërprisni! Në qoftë se nuk e kontrolloni dot, bëni gabim.

**Eduard Halimi** – Ne i kontrollojmë të gjitha.

*(Diskutime pa mikrofon.)*

Mbledhjen e drejtoj unë, nuk e drejton ti! Nuk është me bashkëkryetar mbledhja, por me kryetar!

**Eduard Halimi** – E di, je superkryetar, por të mos krijojmë tensione. Këtë po të them.

**Fatmir Xhafaj** – Fjalën e ka zoti Majko.

**Pandeli Majko** – Edhe unë gjykoj se nuk është nevoja të krijohen tensione. Ne, parlamenti na ka zgjedhur që të gjejmë gjuhën e konsensusit dhe me këtë gjuhë konsensusi të shkojmë në Kuvend dhe të bëjmë një reformë, të cilën ne mund ta quajmë me shumë mënyra nga historike, deri tek e veçantë, apo e përshtatshme, përballë një sistemi drejtësie, i cili e thënë jo nga të tjerët, por edhe nga ne, deri te qytetari më i thjeshtë, që nuk funksionon.

Kështu që mendoj se, në radhë të parë, na takon të vlerësojmë punën e ekspertëve. Në eksperiencën time parlamentare, sinjerisht unë do të nënvizoja disa fakte:

Së pari, është hera e parë që ne kemi një pamje të plotë të të gjithë situatës në sistemin e drejtësisë dhe nuk jemi duke diskutuar për të pasur një datë të veçantë. Problematika është parë si një e tërë dhe nëse mund të flitet për reformë, reforma fillon pikërisht kështu.

Nuk dua të bëj debat me kolegët e opozitës, të cilët besoj se kanë një arsyetim, që vjen nga mungesa e këtyre 8 muajve, por dua të nënvizoj faktin se më shumë sesa duhet të merremi se çfarë ka dalë në faqen e internetit, duhet të mirëkuptojmë këtë arsyetim. Nuk kemi të bëjmë me një reformë apo me disa dokumente të prodhuara duke filluar nga ajo e raportimit specifik, për të vazhduar me analizën e sistemit të drejtësisë dhe pastaj me strategjinë, nuk kemi të bëjmë me një dokument që është bërë nga një anonim, nga një grup anonimësh. Gjithçka është bërë brenda rregullave transparente dhe gjithçka është e zbardhur. Dihet se kush ka thënë çfarë! Sigurisht, dokumentet kryesore që na kanë ardhur sot këtu për t'i miratuar janë pjesë e këtyre diskutimeve 8-mujore.

Me të drejtë unë e mirëkuptoj çdo shqetësim tuajin, çdo kërkesë për më shumë transparencë, për të kuptuar se si është bërë ky dokument. Por dëshiroj të nënvizoj disa elemente që besoj se kolegët do të më mirëkuptojnë. Nuk bëhet fjalë për dokumente politike. Kam përshtypjen se këtu do të ndahemi, dhe po e nis nga fjala e zotit Halimi, i cili tha se ekspertët duhet të funksionojnë pasi të merremi vesh ne politikanët.

Me gjithë mirëkuptimin, besoj që ne kemi ecur gjatë këtyre 8 muajve dhe duhet të vazhdojmë të ecim kështu me mënyrën e kundërt. Pra, të mos marrim përsipër si politikanë e të themi që ne jemi ekspertët më të mirë, që i kuptojmë të gjitha gjërat. Por mundësisht përballë një reforme kaq të rëndësishme të lëmë pak mënjane interesat politike të ditës dhe të dëgjojmë më shumë nga ekspertiza, e cila duhet nënvizuar që nga kapaku i analizës së sistemit të drejtësisë. Nuk besoj se OSBE-ja, apo zyra e BE-së apo OPDAT-i do të vendosin stemat e tyre këtu për të na thënë se ky është një dokument politik apo që ka shmangur me një arsyetim të caktuar politik këtë apo atë opinion.

Miqtë e mi, këto dokumente nuk janë të shkruara në gur. Janë dokumente të shkruara në letra dhe që në thelb mbeten dokumente parimore, të cilat janë një *road map* e përgjithshme për reformën në sistemin e drejtësisë. Ne, hap pas hapi, do të diskutojmë edhe elementet teknike të këtyre problemeve që ngrenë këto dokumente. Por besoj se duhet të kemi mirëkuptimin tuaj, së pari, të paktën në dy gjëra: nuk mund të jemi ne që t'u themi ekspertëve se çfarë është më e mira. Të biem dakord që tani.

Jam dakord me ju që nuk mund të ketë kompromis pa ekspertizë ndërkombëtare. Unë po ju them që do të votoj dhe jam i bindur që këtë opinion kanë edhe kolegët e mi, nuk do të votojmë asnjë dokument, i cili nuk do të ketë edhe ok-ejn e Komisionit të Venecias dhe të ekspertizës ndërkombëtare. Pra, nuk kemi ndër mend të vijmë këtu me vendimmarrje që t'ju imponojmë ju për arsyetimet tona politike.

Unë mendoj se metodologjia duhet të vazhdojë pikërisht kështu; do të na thonë ekspertët se çfarë do të bëjmë dhe ne do të shikojmë detajet e këtyre këshillave se si ne do të ecim. Mendoj se është në rastet e rralla që kemi pasur një kohezion, dhe unë në këtë pikë do të them fjalë të mira, dhe si të tillë e shoh edhe pjesën e shtuar, shtesë të ekspertizës propozuar nga Partia Demokratike, por mendoj se me qetësi ne duhet të ecim me qetësi sipas një procedure, e cila

tanimë ka filluar. Aktualisht kemi miell të mjaftueshëm për të filluar gatimin bukës, nëse mund të flasim kështu. Nuk mund të diskutojmë tani edhe një herë, si do e mbjellim grurin dhe si do e mbledhim atë. Kështu që në këtë këndvështrim mendoj se këto dokumente duhet të shikohen si dokumente, të cilat në vazhdim mund të zgjerohen, mund të rishikohen pika të caktuara, mund të shihet ndonjë detaj teknik, por ne nuk mund të rikthehemi dhe t'i fillojmë gjërat edhe njëherë nga e para.

Prandaj, do të kërkoja mirëkuptimin e kolegëve duke nënvizuar një fakt, nëse, ashtu siç thanë kolegët këtu, kanë nevojë për kohë, dëshirojnë që të diskutojnë gjatë javëve në vazhdim, unë propozoj që, pa dashur të bëj deklaratë pejorative, “se ja shikoni se ç’po bëjmë e të tjera”, ne mund t’i anulojmë dhe të punojmë gjatë të gjithë muajit gusht sikur jemi në funksionim normal në komisionin reformës. Ta bëjmë këtë punë, sepse kjo është një punë, e cila nuk ka brenda ndonjë interes specifik politik, as për të hequr një sindikatë, e cila ekziston aktualisht në drejtësi dhe që është baza, fondamenti i korrupsionit në drejtësi, por për ta zëvendësuar atë me një sindikatë tjetër, që do të vazhdojë të njëjtën medoli, por me ca vegla të tjera. Prandaj mendoj se në këtë pikë duhet të jemi bashkëpunues, të hapur dhe, mbi të gjitha, të sinqertë.

Faleminderit!

**Eduard Halimi** – Një minutë.

**Fatmir Xhafaj** – Një sekondë apo një minutë, apo 30 sekonda, ju lutem merrni leje.

**Eduard Halimi** –Pra, zoti Majko dua që të mos keqinterpretohen ose, nëse janë keqkuptuar nga ana juaj, po jua shpjegoj unë. Majko tha se unë paskam thënë që ne jemi shumë të mençur dhe nuk paskemi nevojë për mendtë e ekspertëve, atyre do t’u japim ne nga mendtë tona. Tani kjo është përtallë. Ajo që thashë në metodologji është që ekspertët na kanë sjellë tri variante për një zgjidhje dhe metodologjia është kjo: ata sjellin tri, ne qytetarëve nuk mund t’u japim tri, edhe Gjykatë të Lartë Karriere, edhe gjykatë nën KLD-në, edhe gjyqtarë nga sistemi. Këto janë tri zgjidhje të ndryshme. Nga këto tri që na sjellin ata, thashë unë, ne, si politikanë që jemi këtu dhe si vendimmarrës, duhet të zgjedhim një. Nuk ju thashë që ne jemi më të mençur se ata. Ti mund të jesh se ke qenë kryeministër. Unë nuk jam. Dhe ne duhet të japim një zgjidhje. Mundet, që kjo zgjidhje, të mos jetë brenda një modeli që ata mendojnë, mund të japin një model tjetër, por pastaj ne u japim qytetarëve dhe u themi që ekspertët na sollën tri zgjidhje, ne si politikanë me kompromis vendosim një. Kjo është zgjidhje. Në këtë mënyrë ne do të luftojmë korrupsionin në drejtësi, në këtë mënyrë ne do forcojmë sistemin. Kjo është metodologjia.

**Fatmir Xhafaj**- Dakord. Zoti Mediu.

**Fatmir Mediu** – Zoti kryetar, unë mendoj se të gjithë ne këtu jemi me disponibilitetin për atë që është më e mira për reformën në drejtësi, për të arritur konsensusin maksimal. Tek të gjitha qëndrimet që kemi shprehur deri tani unë nuk shikoj që kemi ndonjë dallim, përveçse, ndonjëherë, përpiqemi të kapemi me fjalë dhe krijojmë tensione, të cilat janë të panevojshme. Jemi këtu, po ashtu edhe në respekt të ekspertëve të nivelit të lartë, të gjithë specialistëve ndërkombëtarë që asistojnë këtë reformë, edhe të grupit teknik.

Ajo që po kërkojmë është që, mundësisht sipas metodologjisë që duhet, sekretariati teknik, i cili është niveli i ekspertëve që bënë përmbledhjen e materialeve e të tjera për t'ia përcjellë ekspertëve të nivelit të lartë apo anasjelltas, të përgatisin një material më thelbësor për diskutimet që janë bërë me specialistët e fushës, në mënyrë që ne të kemi një dije më të qartë për qëndrimet, që janë përfshirë në strategji apo në plan-veprim. Kjo do të na bënte edhe ne që të ishim pjesë aktive dhe nuk mendoj se komisioni i posaçëm duhet të jetë në pozicione krejt inaktive, të presë produktin dhe, pastaj të votojë produktin. Ne duhet të jemi në pozicione aktive të debateve të diskutimeve me njëri- tjetrin për të arritur atë që është më racionale.

Pra, edhe një herë, ajo që dua të them është ne të kemi kohën e mjaftueshme për të analizuar të gjitha këto dokumente që ju keni përcjellë këtu përpara, ashtu si edhe ju, duhet të keni durimin e mjaftueshëm, nëse ka sugjerime, të cilat vijnë nga gjykimi i drejtë i yni për të qenë pjesëmarrës dhe kontribuues në këtë reformë, të konsiderohen dhe të arrijmë në një material sa më të plotë për ta votuar në mënyrë sa më konsensuale me njëri- tjetrën. Nuk mendoj se është vlefshme që të themi se tani janë bërë, këto janë, të miratohen kështu siç janë.

E tha edhe zoti Majko, edhe unë pajtohem, që pa dyshim në vlerësimin të ekspertëve të Komisionit të Venecias apo të atyre që na asistojnë çdo gjë duhet kaluar me një mirëkuptim që të ketë atë mbështetje ekspertizë të nevojshme për të arritur në standardin që duam në reformën në drejtësi. Por është mirë, e them edhe një herë, që secili të ketë kohën e mjaftueshme për të gjykuar mbi këto dokumente dhe, për më tepër, dokumentet të mos kenë vetëm pjesën analitike, po flas për atë çka prezantoi sekretarja e Përgjithshme e Kuvendit, por të ketë edhe atë që ne mendojmë është e vlefshme, mendimin ekspertëve ose konkludimin rreth mendimit të këtyre ekspertëve. Do të ishte gjë e dobishme për të gjithë. Nuk e kemi për të vendosur përballë përgjegjësisë pse nuk është bërë, por apo mund të jetë bërë dhe ne nuk e kemi në gjetur atë material që është paraqitur. Unë mendoj që për sa i kemi thirrur për t'i dëgjuar apo për të na

dëgjuar, do të ishte mirë edhe të reflektojmë rreth opinionit të tyre. Unë kam qenë në Durrës, në një nga takimet e zhvilluara dhe mendoj se ka pasur mendime të vlefshme nga një pjesë e diskutantëve që do të desha të ishin të pasqyruara, sepse jo të gjithë anëtarët e komisionit të posaçëm apo të nivelit të lartë të ekspertëve, kanë qenë prezent për të dhënë gjykimin e tyre rreth këtyre çështjeve, si nga materiali që është paraqitur nga ekspertët. Nëse nuk është kështu, domethënë nëse e kam gabim, tërhiqem, por po ju them në materialin që është përcjellë sot, nuk pasqyrohen, për shembull, po flas, në takimin e Durrësit u fol për këtë çështje, u ngritën këto sugjerime dhe arritëm në këtë konkludim. Apo jo? Këtë mendova unë që mund të ishte një gjë e mirë që vlen si për kolegët e krahut të majtë edhe për ne. Pra, them të mos krijojmë debate të paqena, thjesht, për t'u kapur me njëri – tjetrën. Ne duam kohën e mjaftueshme, argumentet e gjithsecilit, ekspertëve të nivelit të lartë, të sekretariatit teknik, po ashtu, edhe argumentet e atyre specialistëve, që janë shtuar për të qenë pjesë e debatit në tryezat e organizuara apo në takimet e tjera.

**Fatmir Xhafaj** – Po. Po ka 8 muaj që janë online. Po. E keni kërkuar ju? Po si e keni ju? E kishte për respekt. Zotit Strazimiri. Kërkoj fjalën.

Faleminderit, zoti Strazimiri për mirëkuptimin! Zoti Bylykbashi.

**Oerd Bylykbashi** - Unë shpreh besimin tim të thellë dhe e kam pasur gjithmonë, që praktika më e mirë që ka vendosur ky parlament në 15 vjetët e fundit ka qenë që çështje të këtij lloji, reforma të këtij lloji, jo çështje, të cilat qartazi shkojnë dhe presin në Kushtetutë, mund të sjellin ndryshime sistemike, për atë që si do të funksionojnë institucionet e Republikës së Shqipërisë në të ardhmen, bëhen me komision, jo thjesht, me paritet, por edhe me bashkëkryesim, sepse është një mënyrë emirë për të shtensionuar, megjithatë, unë besoj, që edhe në këtë format, kryetar, ju do të keni, domethënë, ju do të arrini që të menaxhoni në mënyrë të atillë, sikur të ishte ndonjë format nga më të mirët që ka pasur parlamenti shqiptar. Shpresojmë që ky komision të shkojë në atë drejtim. Tani kjo është një pikë për të shtensionuar debatet që bëjmë me njëri-tjetrin.

Së dyti, e ritheksoj nevojën që, ashtu siç e thanë të gjithë kolegët, që e bënë edhe kur ngritën pyetjet, transparenca e funksionimit të këtij komisioni dhe transparenca e funksionimit të këtij procesi, përfshirë punën që bëjnë grupet e ekspertëve, është themelore. Është themelore, sepse është vetëm ajo transparencë që do të na ndihmojë ne, për të qenë ne të vërtetë, për të qenë ajo që do të prodhojmë të gjithë bashkë me ekspertët, të vërtetë, sepse në fund fare duke vënë

gishtin mbi plagë ne do të arrijmë të gjejmë zgjidhjet që duhet për nesër. Sot e dimë, kjo është situata, madje mund të kemi probleme të tjera që nuk janë këtu.

Kështu që, ajo që kam thënë, çdo gjë e vyer, që kanë thënë ata dhjetëra e qindra ekspertë dhe profesionistë të fushës së drejtësisë apo që kanë interes, nuk mundet të mbetet jashtë. Nuk po e paragjykoj që ka mbetur jashtë. Le ta verifikojmë dhe të themi mungon edhe kjo, edhe kjo, ose kjo duhet thënë ndryshe. Kështu që, këtë pjesë, besoj, mund të kemi mundësinë që, po themi, t'i japim drejtimin e duhur. Unë gjykoj që rëndësia, e cila vesh këtë proces është historike. Kushtetutat nuk ndryshojnë kot, nëse do të ndryshohen, ndryshohen, sepse kemi nevojë të bëjmë ndryshime themelore, ndoshta edhe epokale. E për rrjedhojë ai që vishet me një tagër të tillë, në mos populli me referendum, vishen përfaqësuesit e tij, që janë deputetët. Vendimi i Kuvendit na ka veshur ne me këtë tagër. Për fat të mirë, pjesa dërmuese e anëtarësisë edhe e këtij komisioni ka një begrund të pastër teknik në fushën e drejtësisë. E për rrjedhojë, kush më shumë, e kush më pak, kanë nivele të krahasueshme ekspertize edhe me të gjithë botën e ekspertizës që është jashtë këtij komisioni, por nuk kemi privilegjin, por kemi përgjegjësinë që na vesh mandati ynë që të reflektojmë vullnetin dhe intersin publik në vendimmarrje, sepse jemi ne të legjitimuar me votë për të marrë vendime të këtilla, sepse neve do të përgjigjemi nesër, nëse vendimet që morëm janë gabim. E për rrjedhojë, një sintezë e mirë e punës së ekspertëve, me atë që duhet të marrim ne vendim, dhe vendimet tona të jenë të mirinformuara mbi çdo detaj të punës së ekspertëve, jo thjesht mbi kopertinën që mund të ketë logo të rëndësishme, por që kanë opinione dhe dokumente që qëndrojnë pas, apo edhe standarde, është kjo më e rëndësishme. Kështu që, sigurisht, duke kuptuar rëndësinë e jashtëzakonshme të ekspertizës, unë kam qenë vetë në pozita të tilla dikur, besoj se, në fund fare, pesha do të rëndojë nga sëpata, sepse vendimi i këtij parlamenti do ta ndajë të mirën nga e keqja për 20 vjetët që vijnë. Për rrjedhojë, le të mos e kthejmë këtë komision, e aq më pak, sigurisht, opozitën jo e jo, por edhe këtë komision nuk mund ta kthejmë në një vulosës të thjeshtë të çdo gjëje, që do të vijë në këtë komision. Këtu do të bëhet një debat i mirinformuar me një dozë të lartë edhe për profesionalizmin. Këtë, për fat, ne e kemi, shumë prej nesh e kanë, shumë e kanë nga formimi i tyre, shumë e kanë nga eksperiencia e gjatë e tyre, kështu që vendimet që ne do të marrim, duke marrë të mirëqenë, po themi, duke e vlerësuar maksimalisht edhe ekspertizën vendase, por edhe atë, jashtëzakonisht të mirë, ndërkombëtare, produkti këtu të jetë i gjithëpranuar për 10-vjeçarët që do të vijnë, në mënyrë që të mos themi që analiza tha këtë dhe na tregoi që ka një sëmundje të caktuar, por është ndarë më



përpara, një-dy vjet më përpara, se do t'i japim patjetër kimioterapinë sistemit të drejtësisë dhe do ta vrasim.

Duhet që strategjia, plani i veprimit dhe draftet që do të vijojnë, të jenë në përputhje pikë për pikë me atë që është konstatimi i problemeve që ne kemi. Mos të themi që këtu duhet, kemi frymë, siç e tha kolegu Halimi, kemi nevojë të forcojmë një nga organet e sistemit të drejtësisë, një nga organizmat e sistemit dhe në strategji dhe në plan-veprimi është ta heqim këtë. Kjo nuk ka sens. Nëse kemi të tilla me shumicë, do të thotë që ka një problem të madh, të paktën, mos themi me keqbesim, por, të paktën, të bërë në papërputhshmëri midis dy dokumenteve.

E për rrjedhojë, për ta mbyllur, ajo që është shumë e rëndësishme këtu, është koha, është koha për të bërë një reformë kaq themelore dhe çdo afat kohorë i ngushtë e bën këtë reformë themelore ambicioze të paarrtshme ose patjetër ne do të bëjmë gabim. Me të drejtë apo pa të drejtë, në të shkuarën, i kemi akuzuar apo kritikuar reforma të caktuara, sikur dhe janë bërë brenda 24 orësh, brenda natës e të tjera, edhe kur kjo nuk ka qenë e vërtetë, por në vetvete kjo mbetet në themel një kohë e shkurtër dhe, ashtu siç e shoh unë te ky plan-veprimi, do të ndryshojë e gjithë bota brenda një tremujori, e bën këtë reformë në, mos të pamundur, e bën të dëshmueshme në disa pika.

E për rrjedhojë t'i japim kohë vetes, t'i japim informacion vetes, që ai vendim që ne do të marrim, të jetë jo vetëm i mirë, por i bërë në hapat e duhur gjatë këtij procesi.

Faleminderit!

**Fatmir Xhafaj** – Po, zoti Strazimiri.

**Gent Stazimiri** – Faleminderit, zori kryetar!

Unë do të doja të vazhdoja mendimin aty ku e la zoti Majko, i cili sinqerisht tha që këtu nuk ka asnjë interes politik. Është e vërtetë që këtu nuk do të duhej të kishte asnjë interes politik ose duhet që produkti të ishte teknikisht, sa më larg interesave të politikës.

Fakti është se të gjithë ne që jemi në këtë tryezë jemi njerëz politik. Me gjithë dëshirën e mirë që secili prej nesh mund të ketë, që teknikisht të dalë një gjë jashtë interesave politike, vetë fakti që jemi të grupuar në dy grupime të ndryshme, diametralisht të kundërta politike, ne e shohim të grithë procesin nga koordinata të ndryshme. Nuk është i njëjti profil që shohim.

Në mënyrë që rezultati të dalë politikisht i balancuar, që asnjëra palë të mos bëjë tinzarin dhe të ketë përfitime politike, e vetmja mënyrë që unë njoh dhe prandaj ne jemi këtu, është që të dyja palët bashkë të vendosin, duke ruajtur sigurisht këndvështrimin sipas koordinatave politike

që kanë. Kjo është detyra jonë, të arrijmë në një produkt, që të jetë i balancuar dhe i baraslarguar nga interesat politike.

Ky është edhe hapi i parë në metodologji, detyra e parë që dokumenti të cilin ne sot kemi është gjithëpërfshirja, është gjëja më e rëndësishme që duhet të ketë. Me gjithë respektin për ekspertët, me gjithë respektin për asistencën e huaj, me gjithë respektin për dokumentin dhe volumin punës që është bërë në këta 8 muaj, gjithëpërfshirja është pjesa e parë, hapi i parë që ne nuk kemi përmbushur dot. Është një dokument i mbikëqyrur vetëm nga pozita dhe jo nga opozita. Me gjithë respektin dhe besimin që kam për zotin Majko, nuk besoj se e ka pasur të mundshme ta ketë të balancuar opinionin mbi të. Ajo që po kërkojmë sot prova që duhet të japim sot, është të përmbushim deficencën që është krijuar këta 8 muaj, për arsye të tjera, politike sigurisht. Kemi një deficencë në gjithëpërfshirje. Opozita nuk ka qenë përfshirë, e cila ka sjellë gjithashtu një deficencë në transparencë. Atë që po kërkojnë kolegët sot është: e para e punës, të fitojmë kohën e humbur dhe t'i japim elementet që ndoshta i mungojnë materialit për shkak të mospërmbushjes së gjithëpërfshirjes dhe, sigurisht, po kërkojnë transparencë, të marrim sa më shumë nga mendimet që janë dhënë si janë dhënë tek janë dhënë ku janë dhënë sigurisht, që mund të ketë gjëra me vlerë, sigurisht, që pjesa më madhe e tyre nuk kam asnjë arsye të dyshoj se janë përfshirë në dokument, por mund të ketë të tjera që mund të jenë po ashtu të vlefshme nga këndvështrimi ynë, të cilat duhet të përfshihen. Kështu që, nga kjo pikëpamje, vendimi që marrim sot është të plotësojmë vakuumin që ky proces deri sot, këto 8 muaj, e ka, është një ves që e ka. Nuk ka qenë proces gjithëpërfshirës, ky është hapi i parë që hedhim për gjithëpërfshirje dhe sigurisht, është dëshmia e parë që duhet t'i japim opinionit publik dhe kujtdo tjetër, që do të jetë një proces transparent.

Janë dy kërkesa minimale, janë dy kërkesa kryesore të metodologjisë që vetë raporti dhe dokumentet që ne kemi përpara, sot i kërkojnë. Nuk besoj se ka arsye të vazhdojmë të humbasim kohën me këtë punë por të gjemë mënyrën se si të rregullojmë gjithëpërfshirjen dhe transparencën, dy pikat më deficente që procesi ka deri tani.

Ju faleminderit!

**Fatmir Xhafaj** – Po, zonja Hysi.

**Vasilika Hysi** - Faleminderit, zoti kryetar!

Para së gjithash, do të doja të falënderoja ekspertët vendas dhe të huaj, si edhe sekretariatit teknik për procesin transparent, gjithëpërfshirës, konsultimin publik sipas standardeve ndërkombëtare që kanë ndërmarrë në analizën e sistemit të drejtësisë në Shqipëri.

Në fakt, dëgjova kolegët e opozitës që përdorën shprehjet jo sëpata, nuk mora vesh se kë do të quajnë bisht apo deficiencë në transparencë. Në ka një proces që ka një gjithëpërfshirje dhe transparencë, është pikërisht analiza e sistemit të drejtësisë në Shqipëri. Nuk besoj se është faji ynë që ju, për 8 muaj, që nga dita kur Kuvendi i Shqipërisë ka marrë vendimin, në 27 nëntor të vitit 2014, nuk iu bashkëngjitet këtij komisioni, apo që nuk keni gjetur kohën për të lexuar të gjitha procesverbalet, apo për të marrë pjesë në tryeza. Zoti Mediu tha pak më parë që mori pjesë në një tryezë në Durrës, ashtu si mora pjesë edhe unë dhe kolegët e tjerë, por unë do të doja t'ju sillja në vëmendjen tuaj që grupet parlamentare kanë marrë ftesa rregullisht nga sekretariati teknik për të ndjekur të gjitha tryezat, debatet dhe diskutimet, por pa dyshim pa të drejtë që ne të ndërhyjmë, pasi ne përfaqësojmë politikën këtu.

Nga ana tjetër, zoti Halimi tha që ekspertët duhet të sjellin në këtë proces tri-katër variantet e tyre dhe jemi ne, politikanët, që duhet të vendosim. Më lejoni, t'ju them diçka, nëse ka pasur sëpatë që e ka sakatuar drejtësinë, ka qenë sëpata e politikës. Është hera e parë që reforma në drejtësi bëhet nga ekspertë jashtë politikës dhe këta që janë ulur këtu, nuk janë njerëz të politikës, siç tha zoti Starzimiri. Ne, në pjesën e parë të tavolinës, po, por pjesa në vazhdim nuk janë pjesë e politikës. Ata janë ekspertë të pavarur, që i kanë sjellë institucionet, që nga Presidenti i Republikës, nga Gjykata e Lartë Gjykata Kushtetuese, universitete e të tjera. Ndoshta, ju, kolegë nuk keni pasur kohë të lexoni analizën e sistemit të drejtësisë dhe sot kërkoni kohë, por kjo analizë u prezantua pak kohë më parë, në qershor të vitit 2015, ju ka ardhur në email dhe keni pasur, po të kishit dëshirën, gjithë kohën e mundësinë për ta analizuar. Kjo analizë është një radiografi, një skanim total i të gjitha aspekteve të sistemit të drejtësisë. Nëse ju do të merrnit kohë një muaj, dy muaj, nuk keni çfarë t'i shtoni më tepër kësaj analize, sepse...

**Fatmir Xhafaj** – Zoti Mediu, ju lutem, kur folët ju nuk ndërhyri njeri.

Fatmir Mediu ndërhyr pa mikrofon.

**Vasilika Hysi** – Keni gjetë gjithë kohës që thoni ka shumë keqkuptime, në fakt ju ndoqa me vëmendje të gjithë ju që folët. Keqkuptimet ju i krijoni vetë. kur ne themi diçka, por unë jam nga ato që

**Fatmir Xhafaj** – Mos bëni replika me kolegët, ju lutem, jepni opinionin tuaj.

**Vasilika Hysi** – Unë jam nga ata që e kam lexuar analizën.

Prandaj them që është analizë shumë e detajuar dhe është bërë nga ekspertët më të mirë. Nëse ju doni kohë, urdhëroni, planin e veprimit e kemi, do të jemi ne në parlament, në këtë komision, që do të diskutojmë të gjitha nismat ligjore që do të vijnë nga ata që do t'i hartojnë dhe, si çdo proces tjetër që do të jetë përsëri gjithëpërfshirës, transparent, aktiv që do jetë, ne do të kemi mundësinë të rregullojmë të gjitha projektligjet që do të vijnë. Por unë mendoj që aleati më i mirë i yni që është publiku që kërkon reformën në drejtësi të bëhet sa më shpejt që të jetë mundur. Ne nuk mund të humbasim më kohë, sepse ju erdhët me 8 muaj vonesë.

E fundit, në këtë tryezë ne flasim sot si njerëz të politikës, por do të doja, zoti kryetar, që pjesën e ekspertëve të nivelit të lartë të mos e përzienim te pjesa e politikës, sepse atyre është t'u themi: "Një mijë herë faleminderit", si ekspertëve të vendit dhe atyre të huaj, edhe të gjithë atyre që sot nuk janë të pranishëm këtu për të gjithë punën dhe kontributin që ata kanë dhënë.

Të falënderojmë edhe të gjithë ata mbështetës që janë pas kësaj tavoline, që kanë punuar me përkushtim natë e ditë për të mbështetur grupin e ekspertëve të lartë dhe që kanë sjellë këtë analizë dhe këto dokumente.

Unë nuk kam më se çfarë të shtoj, por do të falënderoj shumë edhe Albanën për raportin e detajuar të të gjithë ecurisë së këtij procesi edhe ekspertët e nivelit lartë vendas dhe të huaj.

**Fatmir Xhafaj** – Po, zoti Manja.

**Ulsi Manja** – Faleminderit, zoti kryetar!

Për ta sjellë në normalitet vazhdimin e diskutimit në këtë tryezë, unë, sinqerisht, nëse kjo reformë do të përmbillet me sukses, kam dëshirë të jem pjesë e historisë, pse jo gjithsecili prej nesh, deputetë, ekspertë, të gjithë ata që po kontribuojnë në këtë reformë, nëse shqiptarëve në fund do t'u japim një reformë thelbësore, të shumëkërkuar në 25 vjet prej tyre, pse jo, kam dëshirë, fati me ka takuar, të jem pjesë e këtij komisioni, të jem pjesë e këtij parlamenti dhe kam dëshirë që të jem pjesë e historisë.

Por nëse ky parlament, nëse ky komision i posaçëm dhe shumë i nderuar dhe këta ekspertë shumë profesionistë nuk do ta realizojmë misionin që na ka ngarkuar Kuvendi, e për rrjedhojë sovrani, unë do të desha të largohem një orë e më parë nga kjo histori turpi, sepse vërtet thirrja e miqve ndërkombëtarë për reformën në drejtësi është kusht për integrimin, por thirrja e brendshme e shqiptarëve, e popullit shqiptar në 25 vjet që kërkojnë drejtësi dhe reformë

në drejtësi, për të heq nga shpina peshën e rëndë të padrejtësisë, është ajo për të cilën ne sot jemi këtu.

Që në momentet në kohën, kur Kuvendi mori vendimin për ngritjen e këtij komisioni të posaçëm për reformën në drejtësi, është deklaruar se çelësi i suksesit të këtij komisioni do të jetë një reformë e baraslarguar shumicë dhe opozitë nga grupi i ekspertëve të nivelit të lartë. Ky çelës i suksesi i ngrit në nivelin e një kushti politik. Pra, thelbi i këtij komisioni është që: kjo reformë do të jetë një reformë e ekspertëve më të mirë vendës dhe ndërkombëtarë dhe, ndërkaq, ne si përfaqësues të shumicës dhe opozitës do ta mbajmë këtë komision larg debatit politik. Pra, debati teknik, akademik dhe intelektual do të zhvillohet nga ky panel ekspertësh shumë të nderuar, ndërkohë që ne sigurisht, duke pasur rol aktiv në këtë komision, sepse secili prej nesh duhet të jetë koshient dhe i qartë për atë që do të votojë, do të mbajmë tryezën e debatit politik për shtyllat kryesore të asaj reforme që ne duam të bëjmë.

Unë nuk e di, dhe sinjerisht jurist jam në profesion dhe kam një përvojë relativisht modeste në sistemin e drejtësisë penale, por në vendimin e Kuvendit shoh që janë përfshirë institucione shumë prestigjioze që sot menaxhojnë sistemin e drejtësisë në Shqipëri: Gjykata e Lartë, Këshilli i Lartë i Drejtësisë, Prokuroria e Përgjithshme, Dhoma Kombëtare e Avokatisë, Shkolla e Magjistraturës, rrjeti i universiteteve publike dhe jopublike të drejtësisë në Shqipëri, Ministria e Drejtësisë, Ministria e Arsimit e kështu me radhë, po ashtu, edhe institucione shumë të respektuara që asistojnë prej vitesh sistemin e drejtësisë në Shqipëri, si misioni EURALIUS, OPDAT, OSBE, USAID, SOROS dhe Komisioni i Venecias.

Në këtë kuptim, dua të them që puna e bërë deri në këtë moment që flasim sigurisht meriton respekt, inkurajim nga ana e këtij komisioni dhe unë e shoh edhe gatishmërinë e kolegëve të opozitës në këtë drejtim, sepse, në fund të fundit, ajo për të cilën jemi bashkuar është nevoja e reformës në drejtësi, por në ato pak diskutime që arrita të kap këtu nga kolegët e opozitës, të krijohet ideja sikur ky grup ekspertësh ka mbaruar draftimin e ligjeve dhe e ka çuar komplet kuadrin ligjor të atyre ndryshimeve, që duhet të bëhen në kuadër të kësaj reforme, dhe ne sot na ka ikur ose po na ikën koha për të diskutuar thelbin e reformës në drejtësi.

Jo, unë personalisht i kam lexuar dokumentet që sot kemi përpara. Shoh thjesht dhe vetëm një analizë dhe skanim të gjendjes së sistemit të drejtësisë në Shqipëri në këta njëzet e pesë vjet. Jemi pikërisht në fazën ku ne duhet t'i japim një shtysë të re punës, një inkurajim tjetër këtij paneli ekspertësh për të ecur përpara, sepse, në fund të fundit, vërtet reformat e thella dhe

thelbësore nuk bëhen me ngutje, por, në zgripin ku ka vajtur sistemi i drejtësisë në Shqipëri, unë bashkohem me mendimin e kolegut tim shumë të nderuar, zoti Majko, që, në fund të fundit, nëse paneli i ekspertëve, ndoshta të gjithë ata që janë përfshirë në këtë reformë shumë të rëndësishme, shprehin gatishmërinë për të punuar pa ndërprerje, ne jemi në dispozicion, sepse, në fund të fundit, drejtësia është në zgrip dhe jam i bindur që sot, nuk e di nëse është *live* ose jo ky transmetim, që ka tri ditë qëkur është njoftuar mbledhja e këtij Komisioni të Posaçëm të Reformës në Drejtësi, të gjithë shqiptarët janë sy e veshë te ky komision, sepse ata që janë përplasur në dyert e gjykatave dhe të kësaj drejtësie që kemi ne, nuk e durojnë dot më vazhdimin e kësaj situatë në sistemin e drejtësisë.

Duke u kërkuar mirëkuptimin kolegëve të opozitës në këtë komision, që, për nga *background*-i dhe formimi, shumica dërrmuese jemi juristë, kërkoj të bashkohemi tek ajo që reforma në drejtësi duhet çuar përpara me çdo kusht.

Më mirë të ecim, ndoshta nuk do të arrijmë të bëjmë gjithçka në perfeksion, por që duhet të ndërhyhet, duhet të ndërhyhet dhe më mirë sesa një reformë e këtij grupi ekspertësh ne nuk mund ta bëjmë.

Sigurisht, duhet të jemi aktivë. Absolutisht, unë vetë kam ndjekur diskutimet teknike në Grupin e Ekspertëve të Nivelit të Lartë për sistemin e drejtësisë penale kur kam pasur kohë. Jam deficient se nuk kam arritur t'i ndjek të gjitha tryezat që janë bërë, por, nëse ka vullnet, ne mund ta shpejtojmë këtë reformë dhe ta çojmë përpara, pse jo, sipas këtij plani veprimi ta mbyllim brenda afateve që ka përcaktuar Kuvendi.

Faleminderit!

**Fatmir Xhafaj** – Faleminderit!

Po, zoti Ristani.

**Arben Ristani** – Dua të them vetëm një fjalë, sepse realisht dua që të jemi racionalë dhe vërtet të mbarojmë punë shpejt pa i tjerë gjërat gjatë.

Dua të sqaroj vetëm këtë gjë. Unë jam shumë dakord me dëshirën e gjithsecilit për të qenë pjesë e historisë, për të qenë pjesë e suksesit dhe, për të qenë vërtet, na duhet të jemi racionalë, konkretë dhe të bëjmë një punë produktive.

Unë shoh që parimet bazë ku është bazuar raporti, midis të tjerave, janë gjithëpërfshirja dhe transparenca.

Dakord, janë konsultuar sipas raportit 1400 vetë që janë gjyqtarë, prokurorë, noterë, avokatë dhe unë kam shumë respekt për këtë klasë, së cilës edhe i përkas. Jam shumë i bindur që mendimet e tyre kanë qenë shumë racionale dhe shumë të vyera. A ka mundësi t'i shohim, t'i kemi nëse është bërë një përmbledhje mbi këto mendime? Cilat janë më pikantet? Cilat janë më racionalet? Cilat u janë dukur ekspertëve më të mirat për t'i përmbledhur dhe për t'i bërë pjesë të kësaj strategjie? Unë dua t'i di. Kam nevojë që këtë punë që këta kanë bërë dhe mbi të cilën tek e fundit unë do të jap votën time, të di ç'mendime kanë dhënë. A i keni përmbledhur këto mendime? A i keni renditur, klasifikuar?

**Arben Ristani** – A ka ngelur ndonjë gjë pa u bërë pjesë?

Kaq është dhe besoj se këtë desha të thosha.

**Fatmir Xhafaj** – Faleminderit!

**Arben Ristani** – Besoj se në këtë formë do të më jepni edhe mua mundësinë të jem pjesë e suksesit dhe e historisë.

**Fatmir Xhafaj** – Faleminderit, zoti Ristani!

Po, zoti Halimi, një propozim procedural.

**Eduard Halimi** – Dua të bëj një propozim procedural edhe për të çtensionuar situatën, edhe për të mos krijuar ndonjë keqkuptim të panevojshëm.

Plani i veprimit, zoti kryetar, është ai që keni paraqitur ju dhe sot kemi katër dokumente. Plani i veprimit bën fjalë për nga shtatori e tutje, apo jo? Kam parë aty plan veprimi për gushtin.

Tani, duke lënë mënjanë edhe cinizmin, edhe të gjitha të kolegëve, nuk na ndihmojnë, se nuk është se zgjidhim gjë me të, as me batuta, as me kolegët, ne të opozitës do të punojmë gjatë muajit gusht. Nuk erdhëm ato tetë muaj, ndaj do të punojmë gjatë muajit gusht.

Dokumentet që kërkojnë kolegët, kërkojmë që t'i marrim dhe t'i shohim. *Online* do t'i punojmë. Kudo që të jemi, t'i marrim dhe t'i shohim mendimet e tyre.

Propozimi procedural për vijimin e mbledhjes është ky: ne mund dhe do të duhet të vazhdojmë sigurisht diskutimin e të katër dokumenteve, pra të raportit, të analizës, të strategjisë dhe të planit të veprimit, por propozimi është që miratimi i tyre të bëhet javën e parë të shtatorit. Pse, po themi? Sepse për pjesën e analizës ne kemi nevojë që t'i marrim gjatë këtyre javëve, e thashë, deputetët do të ikin me pushime, ne do t'i marrim, do t'i punojmë, do t'i analizojmë dhe do të japim opinionin tonë për ta miratuar javën e parë të shtatorit, pra mbledhjen e parë që do të kemi, sipas Rregullores dhe Kushtetutës.

*(Ndërhyrje pa mikrofon.)*

Dakord, kur të jetë.

Për pjesët e strategjisë, të cilat, për hir të së vërtetës, duhet të jenë bashkë, ndoshta edhe ndonjë opinion i ekspertëve ndërkombëtarë mund ta marrim pastaj, por këto të dyja që duhet të jenë bashkë po themi, unë gjykoj që duhet të miratohen bashkë, por të paktën pas një diskutimi të vetëm publik. Them të paktën. Minimumi që duhet të bëjmë për transparencën është që strategjinë duhet ta diskutojmë të paktën me një tryezë publike, kur ta çmoni ju.

Nuk e di, në datën 1 shtator, më 30 gusht, nuk e di, në datën 2. Pra, të jetë një ditë para mbledhjes që do të bëjmë ne dhe, pasi të marrim edhe mendimin e konsultimit publik, të nesërmen ulemi dhe miratojmë të katër dokumentet. Ky është propozimi që unë bëj, propozim i cili ka të bëjë me gjithëpërfshirjen për sa u përket pjesës së strategjisë dhe zgjidhjeve, mendimin e atyre që kanë qenë gjithëpërfshirës po them që ta marrim ne, siç thonë zoti Ristani dhe zoti Mediu, t'i marrim dhe javën e parë t'i miratojmë. Pra, nuk ndërpresim këtu askënd.

*(Ndërhyrje pa mikrofon.)*

**Fatmir Xhafaj** – Ky është propozimi procedural më i gjatë që është bërë ndonjëherë.

*(Ilaritet në sallë.)*

**Eduard Halimi** – Zgjatemi ne, mos u mërzi ti. Çfarë ke?

Edhe të duruar duhet të jemi pak tani.

**Fatmir Xhafaj** – Të duruar për gjëra...

**Eduard Halimi** – Gjërat e mëdha bëhen edhe me qetësi, edhe me durim. Të mos e humbasim durimin, se...

**Fatmir Xhafaj** – Edhe me dashuri.

*(Diskutime në sallë.)*

Po pra. Në rregull.

Besoj që kur të vijë radha të diskutojmë analizën dhe strategjinë, do ta diskutojmë edhe këtë çështje dhe do të shprehemi. Ne jemi ende te raporti.

*(Ndërhyrje pa mikrofon.)*

Dakord, por ne po diskutojmë një herë raportin.

Ka ndonjë gjë tjetër për raportin?

Nuk besoj se ekspertët kanë ndonjë gjë për të shtuar.

*(Ndërhyrje pa mikrofon.)*



Në rregull.

*(Ndërhyrje pa mikrofon.)*

Faleminderit për korrigjimin gjuhësor! Ishte edhe ky një kontribut i tryezës.

Unë dua të them një gjë të rëndësishme: që kjo reformë është historike nuk e përcakton kjo tavolinë. Që kjo është një reformë historike, e kanë përcaktuar qytetarët shqiptarë. Nëse ka një gjë, për të cilën ata janë njëzëri, pavarësisht se cilës forcë politike i përkasin në këtë vend, është nevoja që ata kanë për ta reformuar sistemin e drejtësisë.

Që kjo është një reformë historike dhe një nevojë historike për ta bërë, e kanë përcaktuar edhe partnerët tanë, e ka përcaktuar domosdoshmëria që vendi të jetë pjesë e strukturave, e organizatave, e bashkësisë ndërkombëtare përmes një procesi integrues që ka kusht thelbësor reformën në drejtësi dhe ndryshimet thelbësore në sistemin e drejtësisë. Kjo është artikuluar qartazi nga përfaqësuesit diplomatikë të tyre në Shqipëri, por padyshim edhe drejtpërsëdrejti nga zyrtarët më të lartë europianë të Brukselit dhe të Uashingtonit, por padyshim që kjo është një reformë historike, sepse, përtej paragjytimeve, përtej gjykimeve ose përtej qasjeve të ndryshme që mund të kemi, është një gjë e artikuluar edhe nga ne, nga politika dhe, si e tillë, ky është një tren, një lokomotivë që është nisur për të shkuar në destinacion. Padyshim është mirë që ky tren të mos ketë pengesa ose të ketë sa më pak pengesa. Ky tren nuk e ka filluar sot rrugëtimin e tij, ka tetë muaj që rrugëton dhe askush nuk mund ta kthejë mbrapsht, nuk mund ta pretendojë dhe nuk duhet ta mendojë që do të kthehet mbrapsht.

Janë tetë muaj punë intensive dhe është rasti që ne t'i themi një "faleminderit!" të madh ekspertëve që kanë punuar këta tetë muaj, sepse është momenti për të kuptuar që bota në këtë vend nuk rrotullohet rreth politikës. Politika ka përgjegjësinë ta udhëheqë procesin, ta drejtojë procesin, por roli i ekspertizës në këtë proces është thelbësor dhe do të mbetet thelbësor.

Ata meritojnë përgëzimet më të mira për punën që kanë bërë gjatë këtyre tetë muajve dhe unë besoj se, me këtë angazhim, me këtë përkushtim, me këtë përgjegjshmëri profesionale, ata do të na japin deri në fund të këtij procesi produktet e kërkuara aq cilësore dhe në përputhje me standardet ndërkombëtare.

Që ky është një proces gjithëpërfshirës dhe transparent, nuk besoj se do të kishte vend për shumë komente sot. Pse është ky një proces gjithëpërfshirës? Sepse në këtë proces, gjatë këtyre tetë muajve, janë përfshirë të gjitha institucionet e sistemit të drejtësisë, aktorët dhe faktorët kryesorë që punojnë në këtë sistem, drejtpërsëdrejti dhe në mbështetje të këtij sistemi.

Janë përfshirë të gjithë çfarë janë: gjyqtarë, prokurorë, avokatë, noterë në mundësinë për t'u shprehur për produktin e këtij procesi dhe për të qenë pjesë e këtij procesi.

Askujt që ka një mundësi apo që ka një interes nuk i është penguar mundësia për të qenë pjesë e këtij procesi, për t'u njohur me produktet e këtij procesi dhe kjo është absolutisht gjithëpërfshirja më e madhe që mund të kishte një proces.

U përmendën këtu 1400 adresa. Po, po, 1400 adresa. Janë aty. Të gjitha këtyre adresave, ky dokument për të cilin flasim ne sot, analiza ka së paku dy muaj që u ka shkuar. Në të janë gjyqtarë, prokurorë, avokatë, noterë, pedagogë të së drejtës të të gjitha universiteteve shtetërore dhe publike në këtë vend, të shoqërisë civile dhe të gjithë këta kanë pasur mundësinë që të kenë në *inbox*-in e tyre, në *email*-in e tyre këtë dokument.

*(Ndërhyrje pa mikrofon.)*

Për më tepër, është ndërtuar një portal aktiv, i cili, gjithashtu, ka pjesë të këtij dokumenti dhe ka realizuar një transparencë maksimale të procesit.

Kësisoj, çdo përpjekje për ta errësuar sadopak, për t'i vënë njolla këtij procesi, mendoj se nuk është pozitive, nuk është e shëndetshme. Ky është një proces tejet profesional, sepse ekspertët të cilët janë angazhuar në këtë proces, janë ndër profesionistët më të mirë në vend, profesionistë shumë të mirë të misionëve të asistencës ndërkombëtare dhe është kryer i tëri me bashkëpjesëmarrjen, monitorimin, asistencën e ekspertëve ndërkombëtarë.

Nga ana tjetër, procesi ka qenë tërësisht i hapur për ekspertizën e grupeve të interesit dhe të gjitha institucioneve kryesore të sistemit të drejtësisë, gjë që të gjitha këto e bëjnë këtë një proces tërësisht gjithëpërfshirës, tërësisht transparent dhe tërësisht profesional dhe në përputhje me standardet ndërkombëtare të fushës.

Shtrohet çështja: a janë përfshirë mendimet, komentet? Ekspertët kanë sjellë disa dokumente në të cilat është tërhequr dhe janë marrë në konsideratë të gjitha këto opinione, vlerësime; ato që kanë ardhur, ato që janë thënë. Askujt nuk mund t'i imponohet të shprehet për produktin. Mjaft që ka mundësinë për t'u shprehur për produktin.

Kolegët po thonë: “Duam të njihemi edhe ne me to”. Patjetër, të njihen, sepse do të kemi kohë që mbi atë bazë ata të gjykojnë të gjitha amendamentet që do të shqyrtojnë, që do të përgatisë grupi i ekspertëve gjatë muajve në vijim.

Dikush tha këtu se “Në katër muaj do të bëhet çudia”. Edhe po të bëhet, nuk është ndonjë gjë e madhe dhe mirë është të bëhet, por, mos harroni, e kam për ata që e kanë kuptuar vendimin

e Kuvendit, ne kaq e kemi mandatin dhe deri këtu e shkruajmë ne. Nëse Kuvendi do të na e shtyjë mandatin dhe do të kemi të nevojshme, pastaj ne do të themi: “Nuk e realizuam deri këtu, por kemi më shumë kohë”. Padyshim, unë besoj, sepse është vullneti ynë këtu që do t’i transmetohet Kuvendit, Kuvendi do ta shtyjë edhe afatin e këtij... Por ne nuk mund të shprehemi përtej mandatit që ne kemi dhe plani i veprimit nuk është gjë tjetër veçse reflektim i objektivave dhe masave që ka përcaktuar strategjia, por gjithsesi unë besoj që si herë e parë që jemi të gjithë bashkë nuk ishte keq që diskutuam.

Është herë e parë që bëmë një diskutim kaq të...

**Arben Ristani** – Kur mund t’i kemi këto?

**Fatmir Xhafaj** – Ngadalë, se këtu jeni. Që nesër mund t’i merrni, t’i studioni dhe ndoshta nga data 10 gusht të parashikojmë një mbledhje që të keni mundësi që të reflektoni.

*(Deputeti Ristani ndërhyr pa mikrofon.)*

Ju lutem!

**Arben Ristani** – Kur mund t’i kemi këto dokumente?

**Fatmir Xhafaj** – Në ditët në vijim do t’jua bëjmë gati dhe do t’jua japim.

*(Deputeti Ristani ndërhyr pa mikrofon.)*

Tani, unë nuk po them nesër, pasnesër, tre ditë. Do të shikojmë siç janë procesverbalet.

*(Deputeti Ristani ndërhyr pa mikrofon.)*

E mbyllim?

**Arben Ristani** – Mezi po presim të jemi pjesë e historisë.

**Fatmir Xhafaj** – E di.

E mbyllim këtu këtë. Vazhdojmë me pikat e tjera.

Vazhdojmë me analizën. Ka pyetje?

Po, zoti Halimi.

**Eduard Halimi** – Bëra një propozim procedural.

**Fatmir Xhafaj** – Po pra, do ta shqyrtojmë tani te këto dy pikat që do të vijnë.

**Eduard Halimi** – Bëra një propozim procedural, i cili ka të bëjë me shtyrjen e vendimmarrjes lidhur me këto dokumente pasi të merret mendimi i grupeve të interesit, pasi procesi të bëhet gjithëpërfshirës, pra të ketë një tryezë publike për të dyja dokumentet bashkë, analizën dhe strategjinë bashkë, dhe t’i jepet kohë opozitës, meqenëse dokumentin strategjik e ka marrë vetëm para pesë ditësh dhe nuk e ka askush tjetër, të japë opinionin e vet.

Tani, meqenëse unë e bëra këtë propozim procedural dhe meqenëse në vendimin e Kuvendit “Për krijimin e Komisionit të Posaçëm” përcaktohet se për çështje të cilat kanë të bëjnë me gjithëpërfshirjen, transparencën, me procesin e konsultimit dhe me marrjen e mendimit të Komisionit të Venecias në fund, votat janë të barabarta dhe përjashtimisht vota e kryetarit është kundër, unë do të doja dhe e kam pyetje për ekspertët, nëse për zotin Deville të misionit EURALIUS dhe zotin Smibert

**Fatmir Xhafaj** – E kërkuat fjalën për procedurë.

**Eduard Halimi** – Ta mbaroj.

*(Kryetari i komisionit flet pa mikrofon.)*

E kam këtë kërkesë procedurale dhe pyetja ime është: a gjejnë ekspertët ndërkombëtarë se këto faza duhet t’i miratojmë sot, apo ata kanë nevojë që të dëgjojnë edhe grupet e interesit? Se ata e kanë përgatitur strategjinë thatë ju, apo ata kanë nevojë që të dëgjojnë edhe grupet e interesit në një tryezë publike, të dëgjojnë edhe propozimet e opozitës para se ta miratojnë? Këtë e kam pyetje për ta, apo ata e quajnë të mjaftueshëm dhe i mjafton treni juaj që ka filluar të ecë dhe nuk do të ndalet? Këtë po them dhe ky është propozimi procedural. Para se të shprehet komisioni, kërkojmë mendimin e tyre.

Ekspertët e quajnë të mbyllur këtë kapitull, apo duhet ta lënë të hapur dhe të marrin mendimin edhe të opozitës, edhe opsionet e opozitës për zgjidhjet në strategji, edhe mendimet e grupeve të interesit për strategjinë? Se nuk e ka parë askush. Ja ku janë mediat...

**Fatmir Xhafaj** – Dakord.

Zoti Majko, një pro, një kundër, apo të dyja pro?

**Eduard Halimi** – Kam bërë pyetje për ekspertët.

**Fatmir Xhafaj** – Të lutem!

Ke bërë pyetje, t’i japim zgjidhje kërkesës procedurale, pastaj ekspertët.

**Pandeli Majko** – E kam për procedurë edhe unë.

Mendoj se dokumentet të votohen, të ketë mirëkuptimin...

**Fatmir Xhafaj** – Më falni, ju lutem?

**Pandeli Majko** – Dokumentet të hidhen në votim, por të konsiderohen, ashtu siç e thashë edhe kur fola për herë të parë. Janë dokumente të hapura.

Gjatë periudhës së gushtit, opozita të shikojë të gjitha procesverbalet ku do të koleksionojë mendimet dhe opinionet e ekspertizës që i konsideron të vlefshme. Pastaj, mbi

bazën e tyre, kur të jetë gati, le të na thotë në gusht ose kur të fillojë sesioni që ne të mblidhemi dhe të bëhemi pjesë e një diskutimi të përbashkët në vazhdim.

**Eduard Halimi** – Të bëj një sqarim, se që të votojnë kolegët, duhet të jemi të qartë. Po themi që të votojmë, dhe do të votojmë për këtë, duhet të jemi të qartë: nuk mund të ketë votim për diçka që është lënë e hapur. Nuk mund të ketë miratim për diçka që lihet e hapur...

**Fatmir Xhafaj** – E qartë.

**Eduard Halimi** – ...se nuk ka asnjë vlerë. Prandaj po them, ajo që miratohet është: komisioni merr vendim për një dokument që miratohet, dhe unë po them se i kam drejtuar para...

**Fatmir Xhafaj** – Mirë.

**Eduard Halimi** – Se e kemi diskutuar këtë dhe kemi rënë dakord që, para se ne të marrim vendim, meqenëse ekspertët janë ato që prevalojnë dhe jo ne politikanët, marrim mendimin e tyre, si e çmojnë ata procesin, si është më i mirë procesi, ta miratojmë tani dhe t'u themi pastaj grupeve të interesit: “ne e miratuam, por ju po deshët na jepni mendim”, apo t'u themi atyre se “ne do t’ju presim juve, jepni mendimin tuaj dhe pastaj do të marrim vendim?”

**Fatmir Xhafaj** – Në rregull.

**Eduard Halimi** – Është çështje standardesh.

**Fatmir Xhafaj** – Në rregull.

Faleminderit!

Meqenëse jemi te çështja e standardeve, ky është një diskutim që ne të dy e kemi bërë përpara se të vinim këtu, për ta bërë edhe më transparent. Atëherë, meqenëse shpresova që do të ishim mirëkuptuar, por meqenëse ju...

*(Ndërhyrje pa mikrofon.)*

Dakord.

Është e vështirë të bëhesh *deal* nganjëherë për disa gjëra, edhe kur del nga një bashkëbisedim që unë mendova se e mbyllëm. Megjithatë...

*(Ndërhyrje pa mikrofon.)*

Dakord.

Atëherë, ne kemi ardhur këtu sot për ta votuar dokumentin e analizës, sepse është një dokument i cili ka përmbyllur plotësisht procesin e konsultimit.

Në gjykimin...

*(Ndërhyrje pa mikrofon.)*

Ju lutem!

Në gjykimin tonë dhe të asaj çfarë ka sjellë grupi i ekspertëve dhe, në dijeninë time si kryetar, çfarë më është përcjellë prej tyre dhe ata këtë dokument e kanë bërë publik si një dokument final më 8 qershor në një tryezë ku keni qenë të ftuar edhe ju, për sa u përket dy dokumenteve të tjera, ne do t'i votojmë sot në parim për ta lënë të hapur që edhe opozita, edhe kush tjetër që dëshiron të shprehë komente dhe sugjerime rreth këtyre dokumenteve të mund ta bëjë.

Që të jem i sinqertë, unë prisja që opozita, e cila ka një vit që thotë: “Kam një strategji gati”, ta sillte sot këtu, ta bënte pjesë të këtij dokumenti dhe të mos kërkonte 18 ditë kur ka një vit që thotë se “Ne e kemi një strategji”.

Për hir të së vërtetës, për të qenë shumë më korrektë, unë kam lexuar të gjitha deklaratimet publike të kryetarit të Partisë Demokratike lidhur me reformën në drejtësi dhe konstatoj, aq sa ato kanë shprehur, janë të gjitha të përfshira në këtë strategji. Nëse ka edhe diçka shtesë veç atyre që ka thënë dhe që ka deklaruar edhe në tryezën e datës 31 tetor kryetari i Partisë Demokratike dhe ju vetë, ne jemi të hapur për ta lënë të hapur diskutimin e strategjisë.

Por, ka edhe një arsye tjetër, ka edhe disa hapa që duhen respektuar. Ambasadorja e Bashkimit Europian në Tiranë, në një takim ku ne kemi qenë të gjithë prezentë, i ka kërkuar këtij komisioni që këto dokumente t'i miratojë para fundit të verës. Ka qenë një kërkesë e ambasadores së Bashkimit Europian drejtuar këtij komisioni. Unë besoj se kur ajo e ka formuluar këtë kërkesë ka pasur arsye bindëse për ta bërë një gjë të tillë dhe kjo lidhet edhe me nevojën që kemi ne për të dhënë një sinjal pozitiv, qoftë edhe në parim të vullnetit të shprehur në parim në kuadër të hapave të mëtejshme të vlerësimit që do të bëjë Brukseli lidhur me procesin integruar të vendit.

Duke qenë të bindur se në 8 muaj ky është një proces tërësisht gjithëpërfshirës, transparent, që ka marrë kohën e nevojshme dhe është produkt i ekspertëve të nivelit të lartë dhe i asistencës më të mirë ndërkombëtare në Shqipëri, ne do të votojmë analizën, dhe ky është qëndrimi ynë meqenëse kemi kërkesë procedurale, të cilën e shprehu edhe zoti Majko, do të votojmë në parim strategjinë dhe planin e veprimit duke lënë të hapur që gjatë gushtit të rimblidhemi për të shqyrtuar të gjitha propozimet që mund të vijnë për këto dy dokumente.

Po, urdhëroni!

**Eduard Halimi** –E para, ne nuk arritëm ndonjë *deal* bashkë, sepse ju kërkoja që ju të mos i miratonit sot këto dokumente për arsyet që parashtrova edhe këtu. Ju thatë që “unë jam i vendosur dhe do ta bëj këtë se s’bën”, dhe me këto dy qëndrime u fute në këtë sallë. Të thashë se do ta diskutojmë këtu. Kjo ishte dakordësia.

E dyta, për hir të së vërtetës, edhe unë, por edhe qytetarët shqiptarë, prisnim që strategjinë e reformës në drejtësi, ju që keni 2 vjet që keni ardhur në qeveri, duhet ta kishit menduar që në programin e “Rilindjes” dhe në programin qeveritar. E keni marrë ju pushtetin dhe duhet ta kishit përgatitur ju këtë. Por ju nuk kishit këtë hall! Halli juaj nuk ishte të bënit reformën në drejtësi para një viti, halli juaj vjet ishte të kapnit Këshillin e Lartë të Drejtësisë, halli juaj vjet ishte të kapnit Gjykatën e Lartë, halli juaj ishte, jo kjo, por halli juaj është të fusni sa më shumë nga jashtë sistemit gjyqësor. Ky është dhe këtë parashikon edhe strategjia, prandaj nuk përputhen me njëra-tjetrën këto.

Sa për çështjen e miratimit të këtyre dokumenteve, unë do të kërkoja mendimin e ekspertëve, sepse edhe ekspertëve, por edhe ambasadorëve ua kemi thënë edhe në takimet që kemi qenë bashkë. Ju thoni që keni mbyllur fazat, por ju nuk e keni dorëzuar dokumentin strategjik edhe sot e kësaj dite para medias. Është standardi minimal i transparencës, dhe ky është standard minimal. Poshtë këtij standardi ne nuk mund të ecim. Me standardin tuaj që thua: “unë e miratoj sot në parim, më pas hajdeni po deshët ju më jepni mendime, sepse e lë të hapur”, nuk është standard që i shërben konsensusit, nuk është standard që i shërben një procesi transparent dhe gjithëpërfshirës, nuk është një standard që besoj unë, e pranojnë edhe ekspertët dhe prandaj e dua mendimin e tyre para se të shprehemi, por është një standard që është vrastar për konsensusin. Me këtë mënyrë që ju konfrontoheni, duke thënë: “unë i kam hipur trenit, po deshët hajdeni sepse unë iki vetëm”, nuk është standard. Është standardi i arrogancës dhe është që nuk i shërben konsensusit.

**Fatmir Xhafaj** – Dakord.

**Eduard Halimi** – Sepse unë po ju them që këto dokumente nuk kanë asnjë vlerë për t’u miratuar në parim në rast se ne nuk i diskutojmë me njerëzit, në rast se ne nuk marrim opsionet e tyre, në rast se ne nuk japim opsionet e tyre, sepse nuk ka asnjë vlerë.

**Fatmir Xhafaj** – Dakord.

**Eduard Halimi** – Dhe kjo nuk e pengon asnjë minutë të vetme procesin e ecurisë së reformës.

(Diskutime pa mikrofon).

Ndaj, meqenëse në marrëveshjen e arritur ndërmjet partnerëve ndërkombëtarë u theksua që supervota e superkryetarit do të kondicionojë me mendimin e ekspertëve gjithmonë dhe pa prekur standardin e transparencës, dhe ky ishte kushti për të cilën është artikuluar dhe është vendimi i parlamentit këtu që mund ta shikojnë mediat, kërkoj mendimin e ekspertëve lidhur me këtë proces para se ta jepni. Pra, që të mos e bënit me arrogancë. Në qoftë se ekspertët thonë: “nuk ka problem, le të vazhdojnë”, ne do të mbajmë qëndrimin tonë.

**Fatmir Xhafaj** – Dakord. Faleminderit!

Zoti Deville, meqenëse u kërkua që ju të jepnit një koment. Të them të drejtën nuk kisha shumë dëshirë të përfshiheshit, por me detyrim përcaktimi jeni përfshirë në këtë proces.

**Rainer Deville** – Zonja dhe zotërinj, përshëndetje!

Ju falënderoj shumë që na keni ftuar sot këtu dhe në veçanti dua të theksoj kënaqësinë e veçantë që kemi ne si ekspertë ndërkombëtarë për mikpritjen e shqiptarëve dhe për përfshirjen që na keni bërë në këtë proces të rëndësishëm!

Veçanërisht dua të falënderoj edhe kolegët e mi shqiptarë, të cilët kanë marrë pjesë në mënyrë shumë aktive në këtë dokument shumë të rëndësishëm analizues dhe strategjik!

Pyetjes suaj, nëse mund të votoni sot për sa i takon dokumentit strategjik, në fakt, është e vërtetë që ky dokument strategjik nuk i është nënshtruar një procesi konsultimi publik, siç e përmendët, sepse ai vetëm tashmë është përgatitur.

Nga ana tjetër, gjatë diskutimeve të hapura publike që ne kemi bërë për sa i takon analizës, ne kemi marrë *feedback* dhe kemi marrë reagimet e tyre jo vetëm thjesht sa i takon analizës dhe problematikave që kanë ekzistuar, por ne kemi diskutuar dhe kemi marrë *feedback*-un e tyre edhe për sa i takon zgjidhjeve dhe masave konkrete që duhet të merren. Pra, e kemi ezauruar pak a shumë këtë pjesë.

Nga ana tjetër, për të gjitha çështjet që unë dëgjova nga opozita, që u ngritën për sa i takon gjendjes aktuale, statukuos aktuale të sistemit të drejtësisë në Shqipëri, ka një konsensus të gjerë nga të gjitha palët, si nga opozita, si nga opinionin publik, si nga aktorët e përfshirë në sistem për situatën shumë të keqe që është aktuale në gjendjen e sistemit, e cila i takon reformës kushtetuese, çështjeve të gjyqësorit, efikasitetit të gjyqësorit, çështjeve të financimit, pra të gjitha këto janë të pranuar dhe ka një konsensus të gjerë për të gjitha këto çështje.



Zoti Halimi e përmendi shumë drejtë, në strategji ne nuk kemi paraqitur një alternativë, apo një zgjidhje të vetme, por kemi paraqitur alternativa dhe opsione të ndryshme të zgjedhjeve. Unë propozoj që ju sot t'i votoni këto dokumente. Në fazën kur do të vijmë te hartimi dhe draftimi konkret i dispozitave, atëherë do të jetë momenti që ne duhet të përcaktojmë zgjidhjen konkrete, alternativën e vetme që do të jetë zgjidhja konkrete dhe ky proces i hartimit të legjislacionit sigurisht që do të kërkojë patjetër konsultime. Për këtë unë ju ftoj që të gjithë të merrni pjesë, sepse ky është edhe procesi më i vështirë i kësaj gjëje. Sot duhet të votoni!

**Fatmir Xhafaj** – Faleminderit, zoti Deville!

Besoj se për të gjithë, edhe për ata që janë aty, zoti Rainer Deville është shefi i misionit të EURALIUS dhe bashkëkryetar i disa prej grupeve të punës këtu. Zoti Jon Smibert është këshilltar ligjor i OPDAT-it pranë Ambasadës së Shteteve të Bashkuara të Amerikës dhe, gjithashtu, është bashkëkryetar në disa nga grupet kryesore të punës, pra në grupin e ekspertëve.

Zoti Smibert, keni kërkuar fjalën? Po, urdhëroni!

**Jon Smibert** – Po ashtu si zoti Deville, do të doja të theksoja se ka qenë një kënaqësi e vërtetë që kam punuar së bashku me kolegët e mi. Gjithashtu, dua të vlerësoj punën e madhe që është bërë nga sekretariati, njëkohësisht nga mbështetja dhe nga puna që është bërë nga parlamenti. Dua të them që kjo ka qenë një punë e madhe ku është treguar shumë dedikim dhe shumë impenjim nga ekspertët e përfshirë në këtë reformë.

E di që një nga rolet e ekspertëve ndërkombëtarë nuk ka qenë vetëm dhënia e ekspertizës së tyre, dhënia e udhëzimeve, apo njëkohësisht aksesit për ekspertë të tjerë ndërkombëtarë, por njëkohësisht ishte edhe roli i mundësimit të transparencës së këtij procesi. Që në fillim ne ishim shumë të kënaqur me faktin që ky ka qenë një proces jopolitik. Ekspertët janë emëruar si përfaqësues të institucioneve dhe ata e kanë dhënë ekspertizën e tyre si të tillë. Procesit analitik ka qenë një proces i përshtatshëm në mënyrë që të identifikoheshin problemet që kishin të bënin me shtatë shtyllat në të cilat është bazuar kjo analizë. Ky është hapi i parë dhe në shumicën e vendeve në të cilat ne kemi shërbyer ky ka qenë hapi i parë për të ndërmarrë në vijim hapa të tjerë më të mëdha.

Hapi i dytë i zgjedhjes së strategjisë ishte rezultat jo vetëm i dokumentit analizues, por njëkohësisht edhe punës të bërë nga të gjithë kryetarët e komisioneve dhe bashkëkryetarët, të cilët ishin bazuar edhe nga opinionet e marra gjatë tryezave të rrumbullakëta, ku shpeshherë opinionet edhe janë ndryshuar në bazë të opinionëve, të cilat u morën gjatë këtyre tryezave. Ka

qenë një proces dinamik, i cili ka kaluar nga procesi i analizës në procesin e daljes të një strategjie për këtë analizë, e cila do të adresonte problemet që janë shfaqur. Mendojmë se një proces i tillë do të konsiderohej në shumë nga vendet, nga të cilat ne vijmë, si një proces transparent, i hapur, një proces i cili i nënshtrohet një procesi intelektual dhe i shërben tryezës. Ndoshta nuk është identik me proceset, të cilat zhvillohen në vendet respektive nga ne vijmë, por, në fund të fundit, ne nuk jemi vende identike. Vazhdoj në vijim të opinionit të dhënë nga kolegu im, që është një proces, i cili është shumë i rëndësishëm, që i paraprin një procesi shumë të rëndësishëm, siç është procesi i draftimit të ligjeve respektive për të adresuar këtë çështje.

Ju kërkuat opinionin tonë nëse ky dokument duhet votuar ose jo sot, gjithsesi ky mbetet një mendim juaji. Unë, gjithashtu, edhe kolegu im mbetemi besimplotë që ky është një proces i cili ka vlera për t'u votuar.

Faleminderit!

**Fatmir Xhafaj** – Faleminderit!

Zoti Halimi, urdhëroni!

**Eduard Halimi**– Lidhur edhe me shpjegimin që u dha nga ekspertët, kërkesa që unë bëra është një kërkesë paraprake. Sigurisht që ndoshta nuk do të ketë nevojë për ta botuar tani kërkesën paraprake, vazhdojmë me trajtimin, vazhdojmë me diskutimin dhe më pas kur të votojmë do të përcaktojmë edhe qëndrimin tonë.

**Fatmir Xhafaj** – Faleminderit!

Besoj se u mirëkuptuam që do të vazhdojmë procesin dhe besoj se do të kemi një qëndrim edhe në vlerësim të debatit që bëmë midis nesh, edhe në vlerësim të përgjigjeve që dhanë dy bashkëkryetarët dhe njëkohësisht përfaqësuesit e dy agjencive të rëndësishme mbi bazën e kërkesës që bëri zoti Halimi për të pasur edhe komentimin e tyre.

Mund të vazhdojmë me pikat e tjera. Nuk kemi rënë dakord me zotin Halimi, që do t'i bëjmë bashkërisht, pra edhe analizën, edhe strategjinë, edhe planin e veprimit, meqenëse ato janë dokumente në unitet, janë vazhdim i njëra-tjetrës, vazhdim logjik edhe nga pikëpamja formale, kështu që mund t'i përmbledhim bashkërisht.

Kush ka pyetje? Do t'ju lutesha për mirëkuptimin tuaj, që para se të fillojmë me pyetjet dua të bëj një sqarim. Siç e thashë edhe në fillim, këtu janë thirrur bashkëkryetarët e shtatë grupeve të punës, sipas organizimit që ka vetë grupi i ekspertëve të nivelit të lartë në përputhje me shtatë shtyllat kryesore të reformës dhe unë dëshiroj t'i bëj me dije: për grupin e parë që i përgjigjet

grupit të parë të reformës, që ka të bëjë me ndryshimet kushtetuese dhe reformën në Gjykatën Kushtetuese, janë bashkëkryetarët, zoti Deville dhe zoti Sadushi. Zoti Deville është shefi i misionit të EURALIUS dhe profesor Sadushi është drejtor i Shkollës së Magjistraturës.

Për shtyllën e dytë të reformës, që është grupi i dytë i punës, ai që lidhet me gjyqësorin, bashkëdrejtues janë: zonja Agnes Bernhart, gjyqtare austriake dhe zëvendësshefja e misionit dhe zoti Gent Ibrahim, të cilët, për fat të keq, nuk gjenden sot këtu, sepse nuk janë në Shqipëri, por besoj se kolegët e tyre ventualisht mund t'i japin përgjigjet për pyetjet e mundshme, edhe për shkak se shpeshherë ekspertët janë në grupe të ndryshme, plus që produkti është produkt i të gjithë ekspertëve në finale, është miratuar nga të gjithë ata në një tavolinë të përbashkët.

Shtylla e tretë, që i përgjigjet grupi i Drejtësisë Penale, përfaqësohet këtu nga dy bashkëkryetarët, John Smibert, që është këshilltar ligjor i OPDAT-it, siç e prezantova, dhe profesori Artan Hoxha, profesor i njohur i të drejtës në fushën penale, gjithashtu, ish-anëtar i Gjykatës së Lartë.

I ardhur nga universiteti dhe i dominuar, gjithashtu, nga Ministria e Arsimit nga radhët e ekspertëve të grupit të reformës për arsimin e lartë, shtylla e katërt që i përket grupit për edukimit ligjor dhe arsimin juridik, përfaqësohet nga dy bashkëkryetarët, zoti Arthur Graham, përfaqësues i prezencës së OSBE-së dhe profesoreshë Aurela Anastasi, gjithashtu, e njohur për ju.

Shtylla e katërt, që i përket edhe grupit të profesioneve të lira dhe shërbimeve ligjore, përfaqësohet nga dy bashkëkryetarët, zoti Richard Regner dhe profesor Maks Haxhia.

Shtylla e gjashtë është ajo që lidhet me bashkëfinancimin, që bashkëkryetarë janë zonja Bernhard dhe zoti Panda. Dua të them se zonja Bernhard nuk është, kështu që është vetëm zoti Panda.

Shtylla e shtatë, e fundit, por jo për nga rëndësia, përkundrazi, është ajo që lidhet me masat antikorrupsion dhe bashkëkryetarë të këtij grupi punë janë zotërinjtë e nderuar, zoti Deville dhe zoti Smibert. Të dy zotërinjtë janë të pranishëm dhe na kanë respektuar sot këtu. Zoti Smibert dhe zoti Deville janë drejtuesit e punës për masat antikorrupsion. Pothuajse të gjithë bashkëkryetarët këtu janë përfaqësuesit e grupit të ekspertëve të nivelit të lartë dhe grupeve përkatëse, të cilët eventualisht mund t'i përgjigjen pyetjeve lidhur me këto dokumente të rëndësishme, të cilat ata i kanë sjellë para komisionit të posaçëm parlamentar për gjykim dhe shqyrtim.

Fillojmë me pyetjet, pas këtij prezantimi të nevojshëm në vlerësimin tim. Zoti Halimi, ju lutem!

**Eduard Halimi** – Unë do të bëj disa pyetje dhe po i bëj të gjitha bashkë, në mënyrë që edhe ekspertët, sipas përkatësisë së tyre të përgjigjen sipas grupeve të punës. Duke i marrë të dy dokumentet bashkë, pyetja e parë, analiza përfshin një periudhë 16-vjeçare, kështu thuhet, pra nga data e miratimit të Kushtetutës. Në këtë analizë unë nuk gjej të evidentuar, dhe dua të di pse nuk është e evidentuar periudha nga viti 1999 deri në vitin 2005 në sistemin e drejtësisë, ku në krye të Gjykatës së Lartë u vendos ish-ministri i Drejtësisë, ku anëtarë të gjykatës së Lartë u vendosën deputetë të Partisë që ishte në pushtet, ku në krye të Gjykatës Kushtetuese u vendos paraardhësi i kryetarit të Komisionit të Ligjeve, sekretar politik i partisë së maxhorancës, pra në këtë pjesë, kemi Abdiun, në qoftë se do ta dish, dhe në këtë skaner të sistemit kjo periudhë nuk përmendet. Dhe unë dua të di pse nuk përmendet dhe cila është zgjidhja që ne i japim, që në këtë sistem të mos kthehemi më? Pra, në analizë dhe në strategji. Ku është në strategji? Me çfarë mekanizmi do të ndalojmë, do t'i vëmë fre, që në sistemin e drejtësisë të mos vazhdojmë më me kapje politike, siç ka ndodhur atëherë dhe siç ka ndodhur edhe vitin e kaluar.

Pyetja e dytë: nga progresraportet e Bashkimit European të përmendura në pjesën e analizës përshëndetet ngushtimi i hapësirave për ata që shkojnë në Gjykatën e Lartë nga jashtë sistemit. Pra, Bashkimi European, ashtu si thuhet në të vërtetë në analizë, kërkon që në Gjykatën e Lartë të shkojnë njerëz nga brenda sistemit dhe jo nga jashtë sistemit. Ndërkohë që zgjidhja që jepet në strategji mua më duket e kundërt. 70% e referencës për reformën në Gjykatën e Lartë janë përpjekjet sesi duhet të fusim nga jashtë sistemit gjyqtarë në Gjykatën e Lartë. Kjo zgjidhje që jepni ju, e forcon Gjykatën e Lartë? Pra, në qoftë se ne i marrim nga jashtë sistemit anëtarët e Gjykatës së Lartë, por i emëron maxhoranca, kjo e forcon Gjykatën e Lartë? E forcon pavarësinë? E forcon kjo luftën ndaj korrupsionit, apo e kundërta? Cili model është marrë në këtë pikë, që gjyqtarët e Gjykatës së Lartë t'i marrim nga jashtë sistemit?

Pyetja e tretë: Në pjesën e analizës theksohet se konferenca gjyqësore është një instrument dhe një mekanizëm për të rritur pavarësinë e sistemit të drejtësisë. E thënë kjo nga disa progresraporte dhe me insistimin e BE-së në vite, është miratuar edhe ligji për Konferencën Gjyqësore para 3 vjetësh dhe këto thuhet në analizë, por zgjidhja që jepet në strategji është shkrirja e Konferencës Gjyqësore.

Unë nuk e kam të qartë, shkrirja e Konferencës Gjyqësore e forcon pavarësinë e sistemit gjyqësor, apo e dobëson atë?

Pyetja e katërt: Ulja e raportit ndërmjet anëtarëve të Këshillit të Lartë të Drejtësisë që vijnë nga gjyqësori dhe e atyre që vijnë nga jashtë gjyqësorit, pra të emëruar nga maxhoranca (se kush tjetër do t'i emërojë ata, se nga Hëna s'do vijnë ata që t'i emërojnë), pra, ulja e kësaj balance që është në Këshillin e Lartë të Drejtësisë, e forcon Këshillin e Lartë të Drejtësisë apo e dobëson atë? E forcon pavarësinë e gjyqësorit apo e dobëson atë dhe shkon drejt kapjes?

5. Në 12 vjet BE-ja dhe GREKO kanë parashikuar si masë antikorrupsion shkrirjen e dy inspektorateve, pra të Ministrisë së Drejtësisë dhe të Këshillit të Lartë të Drejtësisë dhe në pjesën e analizës citohet Komisioni i Venecias që thotë se inspektorati duhet të jetë pranë Këshillit të Lartë të Drejtësisë. Por kur shkojmë të strategjia, të mënyra për ta zgjidhur problemin, nuk flitet për shkrirjen e Inspektoratit të Ministrisë së Drejtësisë, por flitet për një inspektorat, i cili do ta fshijë edhe inspektoratin e Këshillit të Lartë të Drejtësisë, por do të jetë i emëruar jo nga gjyqësori, jo nga Këshilli i Lartë i Drejtësisë. Tani, heqja e mundësisë së Këshillit të Lartë të Drejtësisë për të inspektuar gjyqtarët, siç sugjerohet në strategji, e forcon pavarësinë e sistemit, e forcon luftën ndaj korrupsionit apo forcon kapjen politike?

6. BE-ja thotë se duhet t'ia mbyllin derën të gjithë atyre personave që duan të bëhen gjyqtarë nga jashtë Shkollës së Magjistraturës. Zero. Ka progres-raporte pa fund për këtë çështje. Pra, të gjithë ata që duan të bëhen gjyqtarë duhet të kalojnë nga Shkolla e Magjistraturës, e cila është një histori suksesi për hir të së vërtetës dhe këtë e evidentoni ju në analizë, por kur vini te strategjia, masa që ju propozoni është që gjyqtarë mund t'i bëjmë edhe ata që vijnë nga jashtë sistemit, por me kusht që gjatë kohës që janë në punë, ata të ndjekin Shkollën e Magjistraturës, pra të bëjnë këtë shkollë, shkollë nate, me sistemin e korrespondencës. Kjo masë që propozoni ju në strategji, e forcon pavarësinë e sistemit, sepse Shkolla e Magjistraturës për këtë u bë, që ata që bëheshin gjyqtarë të mos kishin pjesë me aktorët politikë, pra e forcon apo e dobëson? Luftohet korrupsioni në sistemin e drejtësisë duke sjellë gjyqtarë nga jashtë sistemit, pra jashtë shkollës, duke i importuar apo jemi në krahun e kundërt?

7. BE-ja në të gjitha progres-raportet dhe në raportet që ata kanë dhënë ka sugjeruar si masë antikorrupsion heqjen e të drejtës ekskluzive të ministrit për procedimet disiplinore. Pra ta kenë sa më shumë një instrument për ta kontrolluar, një rekomandim që vjen edhe nga Komisioni i

Venecias. Kur vijmë te strategjia ne nuk e gjejmë të shkruar në asnjë vend pikërisht heqjen e së drejtës së ministrit dhe kujt do t'ia çojmë. Nuk jepet asnjë zgjidhje se kujt do t'ia japim ne këtë.

8. Pyetja e fundit ka të bëjë me disa gjetje dhe propozime, të cilat janë tërësisht të pakuptueshme dhe unë dua të sqarohem.

Flitet në analizë si problem zgjedhja e Presidentit. Pyetja ime është se çfarë roli dhe pozicioni ka në reformën në drejtësi një çështje tërësisht politike mes palëve siç është zgjedhja e Presidentit?

Në draftin, planin e veprimit, flitet për shkarkime dhe ndërprerje mandatesh. Dua të jem i qartë në zgjidhjet dhe në proceset që ju rekomandoni për zgjidhjen e problemit të forcimit të institucioneve dhe luftës ndaj korrupsionit në sistemin e drejtësisë.

Faleminderit!

**Fatmir Xhafaj** – Faleminderit, zoti Halimi!

A ka pyetje të tjera? Unë do t'ju sugjeroja, në qoftë se edhe kolegët janë dakord, të gjitha pyetjet që kemi t'i bëjmë të gjitha. Nëse ata mund të duan kohë që t'i ndajnë se kush do të përgjigjet, t'u lëmë 2 minuta kohë. Pra, t'i mbledhim të gjitha pyetjet.

Urdhëroni, zoti Ristani!

**Arben Ristani** – Po shoh te strategjia që ka konstatuar se degë të tëra të së drejtës shqiptare e kanë burimin në modele të ndryshme ligjore dhe strategjia merr përsipër që ta rregullojë këtë kakofoni të burimeve të së drejtës, kakofoni të modeleve nga ku janë bazuar degë të tëra të së drejtës. Gjithashtu, strategjia merr përsipër që të rregullojë probleme të tilla si institute të tëra ligjore, të cilat kanë përplasje me njëri-tjetrin dhe trajtohen ndryshe në ligje të ndryshme.

Duke qenë se më tutje pastaj, plani i veprimit merret konkretisht me rregullime dhe ndryshime ligjore që kanë të bëjnë praktikisht me ligje organike, p.sh. me ligjin organik të Prokurorisë, të Gjykatës së Lartë, të Gjykatës Kushtetuese, ligjin “Për Presidentin”, këto janë ligje organike që nuk kanë të bëjnë me degët e së drejtës dhe unë nuk arrij ta kuptoj nëse do të synojmë të rregullojmë degët e së drejtës sepse janë marrë nga modele të ndryshme, se sistemet tona ligjore janë të gjitha të paharmonizuara. Apo do të merremi thjesht me ligjet organike?

Me përjashtim të ligjeve organike kemi ndryshim te ligji “Për referendumet” (do të bëhet një ligj i ri për referendumet), pastaj pjesa tjetër janë në përgjithësi ligje organike. Atëherë, ç'kuptim ka që në strategji ju synoni të harmonizoni degët e së drejtës, të unifikoni burimet... Cilat degë të

së drejtës do të modifikoni, do të unifikoni? Cilat institute të së drejtës kanë përplasje dhe ju do t'i rregulloni, do t'i modifikoni, do t'i harmonizoni?

Unë nuk shoh te plani i veprimit harmonizim të degëve të së drejtës, përplasje të instituteve, rregullime që ju do të bëni. Unë shoh rregullime apo ndryshime, apo ligje të reja që kanë të bëjnë vetëm më ligjet organike të këtyre institucioneve, Gjykatës së Lartë, Gjykatës Kushtetuese, vendosjes territoriale të gjykatave etj., etj.

**Fatmir Xhafaj** – Faleminderit, zoti Ristani!

Urdhëroni, zoti Bylykbashi.

**Oerd Bylykbashi** – Në strategjinë e prezantuar para nesh një nga elementet që konstatohet te pjesa për sistemin e drejtësisë sipas Kushtetutës dhe Gjykatës Kushtetuese, që në fillim bëhet një konstatim. Mbasi konstatohet se sa herë është ndërhyrë në Kushtetutë, pra kemi vitin 1998, 2007 dhe 2008, ka qenë në bindjen time që ndërhyrja e vitit 2007 është nga ndërhyrjet më të kota dhe ta pavlefshme dhe gjithashtu shumë të debatueshme. Por ajo e vitit 2008 vetë votimi me një konsensus të jashtëzakonshëm të parlamentit shqiptar, përkundër asaj që thuhet dhe shpresoj që mos ua kanë thënë edhe juve ekspertë të nderuar ndërkombëtarë, që nuk është miratuar brenda natës, por është dashur shumë kohë.

Duke qenë se ndërhyrja e vitit 2008 ka qenë me qëllim shmangien e krizave të rëndësishme kushtetuese dhe qeverisëse, të cilat kërcënonin vazhdimisht procesin zgjedhor, pra moszgjidhja e Presidentit çonte në kriza zgjedhore, nevoja për të zgjedhur Presidentin me shumicë të cilësuar çonte në presione mbi procesin zgjedhor dhe e shkatërronte procesin, çonte në nevojë për të kapur Presidentin me shumicë të cilësuar nëpërmjet zgjedhjeve, pastaj për të dominuar gjyqësorin, të gjitha këto u zgjidhën. Por duke pasur parasysh edhe faktin që Kushtetuta e vitit 1998, e paamenduar, Presidenti në fund zgjidhej me shumicë absolute, pra jo me shumicë të cilësuar, pyetje ime është shumë e thjeshtë: Ku është konstatuar që këto kanë pasur ndikime negative? Cilat janë provat që ka pasur ndikime negative mbi sistemin e drejtësisë në ndryshimin e vitit 2008?

2. Pyetja e dytë ka lidhje me një aspekt tjetër të rishikimit që propozohet. Propozohet ndryshimi i ligjit “Për referendumet”. Është e vërtetë që Kushtetuta përmend një ligj “Për referendumet”, por në Shqipëri ligj për referendumet nuk ka. Është Kodi Zgjedhor, i cili sigurisht ka nevojë të amendohet, sigurisht që amendohet nëpërmjet një procedure super garantiste, jo siç e ka ky komision, pra me paritet, me bashkëkryesim, me elementin e konsensusit brenda dhe

duke qenë se një ligj i tillë nuk ekziston, problemet ia dimë kornizës ekzistuese: Si ka ardhur ky konkluzion?

3. E fundit që kisha unë është procedurale. Këtu flitet për nevojën e efikasitetit dhe vendimmarrjeve të Gjykatës Kushtetuese dhe besoj se keni qenë mjaftueshëm gjatë këtu në këtë vend për të konstatuar një debat të madh publik më shumë se njëvjeçar, që vendimet e Gjykatës Kushtetuese duhet të jenë të zbatueshme, nuk duhet të bllokohen dhe kjo ka çuar madje në një rezolutë të Parlamentit Shqiptar të facilituar nga Parlamenti European, që një nga pikat është të zbatohen vendimet e Gjykatës Kushtetuese në mënyrë sistematike dhe efektive.

Dhe për këtë Parlamenti i Shqipërisë ka marrë një vendim shumë të rëndësishëm, ka ngritur një komision, ia ka dhënë atij komisioni këtë detyrë. Si e shihni nevojën e harmonizimit të punës në mënyrë që të mos ketë kolezion, as kompetenca komisionesh, as gjëra të tjera, sepse janë dy vendime të Parlamentit, nuk bëjnë dallim, as mos të kemi kolezion pastaj në zgjidhjet që do të propozohen?

Faleminderit!

**Fatmir Xhafaj** - Faleminderit!

A ka pyetje të tjera?

*(Pas një pushimi të shkurtë.)*

**Fatmir Xhafaj** – Fillojmë me përgjigjet e pyetjeve.

Urdhëroni, zonja Anastasi!

**Aurela Anastasi** – Faleminderit, zoti kryetar!

Unë dëshiroj të përgjigjem për pyetjen e parë drejtuar nga zoti Halimi, të cilin e falënderoj për këtë pyetje.

Dua të theksoj se analiza që ne kemi zhvilluar në këtë material, në këtë dokument, nuk ka pasur për qëllim një studim kronologjik historik dhe nga pikëpamja evolutive. Analiza është përqendruar në çështje dhe problemet e hasura ndër vite. Kështu që në këtë kuadër ne nuk mund të pasqyrojmë të gjitha problematikat dhe të gjithë historikun e zhvillimit në lidhje me çështjen.

Unë mendoj që baza nga e cila ne jemi nisur ka qenë Kushtetuta, ligji, Vendimet e Gjykatës Kushtetutës fillimisht na kanë ndihmuar të eidentojmë një sërë problemesh, të cilat kanë sjellë vonesa, moseficiencë në funksionimin e organeve kushtetuese të drejtësisë e të tjera dhe këto problematika janë konsekuative, janë pasoja konsekuative, janë pasoja që vijnë ndër vite. Për më tepër referenca jonë në dokumentin analitik 16-vjeçar ka të bëjë me faktin e moshës së



Kushtetutës dhe e hyrjes në fuqi të Kushtetutës aktuale të Republikës së Shqipërisë, kështu që unë mendoj se kjo nuk mund të merret si një detyrim për të bërë një analizë kronologjike nga pikëpamja historike dhe evolutive në 16 vjet hap pas hapi. Nuk mund ta bëjmë një gjë të tillë.

Gjithashtu, problemet që ngriti këtu zoti Halimi, unë mendoj se gjejnë përgjigje sepse në fund të fundit janë të gjitha probleme që kanë të bëjnë me ndërhyrjet dhe presionet politike në çështjet e emërimit dhe në çështje të tjera të sistemit të drejtësisë dhe ato kanë dalë falë problematikave që ne kemi trajtuar.

Kaq kisha për pyetjen e parë.

**Fatmir Xhafaj** - Faleminderit!

Ju lutem, zoti Deville! (*Flet në anglisht.*)

**Rainer Deville** - Në radhë të parë dua të bëj një kompliment për pyetjet që janë bërë. Këto janë pikërisht ato pyetje, të cilat ne i kemi diskutuar në grupet e punës.

Sa i takon pyetjes së parë, faktit që propozohet të ketë gjyqtarë që vijnë nga jashtë sistemit, ky në fakt kufizohet vetëm për Gjykatën e Lartë, jo për gjykatat e tjera.

Kur flasim për anëtarësimin në BE dhe çështje të së Drejtës së BE-së, të ligjit evropian, kemi shumë fusha specifike dhe jo shumë të zhvilluara në Shqipëri, si pronësia intelektuale, e drejta tatimore e BE-së, për të cilat ne kemi menduar dhe kemi vlerësuar se nuk kanë një ekspertizë të mjaftueshme dhe as të zhvilluar në Shqipëri, dhe kjo ishte edhe arsyeja që ne kemi menduar që të përfshijmë nga jashtë sistemit, për këtë arsye.

Dua t'ju përgëzoj, sepse është një koment shumë i mirë. Në fakt unë e kuptoj shumë mirë shqetësimin tuaj, që të hapim mundësinë për të marrë nga jashtë sistemit; mund të ngrejë shqetësime sa i takon kualifikimit të kandidatëve apo personave të cilët do të merren nga jashtë sistemit dhe do të vendosen brenda sistemit të drejtësisë. Nga ana tjetër, ky shqetësim është një shqetësim që duhet të kihet parasysh në momentin e hartimit të dispozitës, gjuhës së dispozitës, vendimmarrjes që ju do të keni si politikanë e si ekspertë, se sa larg dhe sa shumë do ta hapni këtë derë, do ta lini këtë mundësi, në mënyrë që të vendoset balanca e dëshiruar, duke pasur parasysh nevojën që përmenda.

**Sokol Sadushi** – Faleminderit, zoti kryetar!

Unë do t'i përgjigjem pyetjes që bëri zoti Halimi, lidhur me Konferencën Gjyqësore Kombëtare. Paraprakisht, dua të bëj një saktësim, që në analizën që ne kemi parashtruar në faqen 33 të materialit, nuk është konkluduar, që duhet të forcohet Konferenca Gjyqësore Kombëtare.

Përkundrazi, është konkluduar se – po citoj: “Konferenca Gjyqësore Kombëtare është një institucion i parashikuar nga Kushtetuta dhe ka një funksion të rëndësishëm. Mungon një rregullim i mirëfilltë, kushtetues i saj, për sa u përket statusit, kompetencave e organizimit”.

Ky ka qenë konkluzion i gjetjeve. Pikërisht nga këto gjetje, si rrjedhojë edhe e konsultave publike, si rezultat edhe i konsultave midis grupit, është arritur gradualisht të vihet në një opinion që lidhet me misionin që ka Konferenca Gjyqësore Kombëtare.

Ajo që ka konkluduar grupi është i lidhur pikërisht me një pjesë të gjetjeve, por edhe me një pjesë të konsultave publike, që Konferenca Gjyqësore Kombëtare nuk ka arritur ta përmbushë atë funksion, për të zgjedhur në Këshillin e Lartë të Drejtësisë – e cila është e vetmja kompetencë që ajo ka – gjyqtarë me integritet të lartë profesional, që arrijnë të realizojnë vendimmarrjen e tyre larg ndikimit politik apo interesave të grupit.

Mbi këtë gjykim të komisionit, ne kemi shkuar gradualisht në një ide që lidhet me atë që është parashikuar edhe në planin e veprimit e në strategjinë, që mund të shkohet drejt një suprimimi të këtij institucioni, për shkak të mosfunksionimit dhe moseficiencës së kësaj konference.

Natyrisht, mundësia se si do të paraqitet në të ardhmen zgjedhja e anëtarëve të Këshillit të Lartë të Drejtësisë, është çështje që pastaj mbetet për ta zgjidhur me përgjegjësinë respektive të trupës së gjyqësorit që lidhet me Gjykatën e Shkallës së Parë, me Gjykatën e Apelit apo me Gjykatën e Lartë.

Faleminderit!

**Fatmir Xhafaj** – Po. Faleminderit!

Vazhdojmë me pyetjet e tjera.

Po, zoti Hoxha.

**Artan Hoxha** – Lidhur po me pyetjen e tretë, për të sqaruar, ne kemi bërë një tentativë dikur, kur kemi futur Konferencën Gjyqësore, e cila në fakt vjen nga një model anglosakson dhe nuk është model kontinental. Ne kemi pasur një dualizëm dhe vazhdojmë ta kemi, midis organizimit dhe funksionimit gjyqësor tonit sipas modelit evropian, por duke futur edhe një element të modelit anglo-sakson amerikan, kur në këto vende, vetorganizimi i gjyqësorit bëhet nga vetë gjyqësori, nëpërmjet Konferencës Gjyqësore; nuk ka Këshill të Lartë Drejtësie, nuk ka Inspektorate, nuk ka rregullime që kanë modelet evropiane.

Në këto vite ne pamë se nuk funksionoi ky dualizëm, me gjithë dëshirën e mirë që kemi pasur – unë kam qenë pjesë edhe në atë kohë – me gjithë dëshirën e mirë që të fusim një element vetorganizimi nga pushteti gjyqësor në vetvete, por ne në fund të ditës i përkasim një familjeje europiane, dhe meqenëse ne vetorganizojmë gjyqësorin, administrimin e saj nëpërmjet Këshillit të Lartë të Drejtësisë, atëherë Konferenca Gjyqësore e ka humbur qëllimin dhe funksionin e vet. I vetmi funksion që kanë është zgjedhja e anëtarëve të KLD-së. Në gjithë këto vite, ne kemi parë se Konferenca Gjyqësore nuk e ka gjetur dot pozicionin, o me rregullim ligjor, o me rregullim të brendshëm. Ka implikuar edhe një vendim të Gjykatës Kushtetuese, dhe përfundimi, sipas mendimit tonë, është se vetëm me kaq funksion, Konferenca nuk do të ishte e nevojshme t'u shtohet institucioneve kushtetuese që ka Shqipëria për organizimin e gjykatave në Shqipëri.

Faleminderit!

**Fatmir Xhafaj** – Po, zoti Rainer.

**Rainer Deville** – Këshilli i Lartë i Drejtësisë ka një histori shumë më të madhe se ajo që prezantoi paraqitja juaj, po për ta filluar me çështjet e këtij institucioni, në radhë të parë. Presidenti i Republikës dhe ministri i Drejtësisë nuk duhet të jenë më pjesë e këtij institucioni. Ndërkohë, thënë kjo, në duhet të mendojmë për një përbërje të re të Këshillit të Lartë të Drejtësisë. Sigurisht, shumica e anëtarëve të Këshillit të Lartë të Drejtësisë duhet të jenë gjyqtarë, por nga ana tjetër duhet të diversifikohet përbërja e tij, që të përfshihen edhe njerëz të jashtëm, nga jashtë sistemit, të cilët ta kontrollojnë Këshillin e Lartë të Drejtësisë, të shmangin korporatizmin, atë që quhet korporatizëm, dhe të sjellin ide të freskëta e të reja brenda këtij institucioni.

Pra, një propozim konkret mund të ishte që të ketë gjashtë anëtarë të KLD-së, që janë gjyqtarë, dhe pesë të tjerë nga jashtë sistemit, që do të thoshte 11 anëtarë në total, por gjithsesi mund të jenë edhe pesëmbëdhjetë, edhe shtatëmbëdhjetë. Pra, kjo është faza e tretë, në të cilën duhet të përcaktohet ky aspekt.

Pra, kjo është pasqyra e përgjithshme e saj; këto janë në vija të përgjithshme. Sigurisht që masat që duhet të zbatohen duhet të përfshihen në legjisllacionin përkatës. Është shumë e rëndësishme që, pasi të përcaktohet përbërja e Këshillit të Lartë të Drejtësisë, të përcaktohet që këta anëtarë do t'i nënshtrohen përgjegjshmërisë disiplinore. Sepse ka pasur shumë ankesa sa i takon përgjegjshmërisë disiplinore, në rastin e shkeljes së ligjit nga ana e anëtarëve të Këshillit të

Lartë të Drejtësisë. Të gjitha këto duhet të pasqyrohen e të detajohen në ligj. Pra, është shumë më e gjerë panorama dhe problematika, sa i takon Këshillit të Lartë të Drejtësisë.

**Fatmir Xhafaj** – Zoti Smibert.

**Jon Smibert** – Ju faleminderit për mundësinë që po më ofroni, që të adresoj një mori pyetjesh që u shtruan sot!

Pyetjet që do të adresoj, që do të përgjigjem, janë numri pesë dhe numri shtatë, të drejtuara nga zoti Halimi, për arsye se ka lidhje midis tyre.

Pyetja numër pesë adresonte rolin e inspektorëve, ndërkohë që pyetja numër shtatë fliste për rolin e ministrit të Drejtësisë në inicimin e një inspektimi dhe disiplinimit të gjyqtarëve. Kjo është një pyetje e cila, me sa kuptoj, kishte të bënte me gjyqtarët, por është një pyetje e cila po ashtu shtron po ashtu edhe disiplinimin në prokurori.

Në shqyrtimin e këtyre çështjeve, ne sollëm jo vetëm ekspertizën tonë, por EURALIUS solli posaçërisht një eksperte, e cila merrej me çështjet e disiplinimit. Konkluzioni që arritëm është se inspektorët këtu nuk janë e njëjta gjë sikurse janë në vendet e tjera të Europës.

Pritshmëria ka qenë se në vendet e tjera ekspertët janë personalitete me shumë eksperiencë, të cilët kanë barrën dhe kanë mundësinë të identifikojnë shkelje apo probleme të kryera nga kolegët e tyre. Po ashtu, vumë re se ndarja e përgjegjësive midis Ministrisë së Drejtësisë, midis Këshillit të Lartë të Drejtësisë apo Këshillit të Prokurorisë, çonte pastaj në mungesën, pra në pamundësinë për të adresuar përgjegjshmërinë në raste të tilla. Në versionin anglisht është në faqen numër pesëmbëdhjetë; nuk e di në ç'faqe është në versionin shqip, por, me sa më thonë është në faqen pesëmbëdhjetë edhe në versionin shqip.

Për të gjithë ata që kanë dokumentin përpara, sapo citova se çfarë parashikohet në këtë pikë, e cila është ngritja e një inspektorati të pavarur, i cili ka për detyrë dhe përgjegjësi të hetojë shkeljet disiplinore të gjyqtarëve, dhe të kryejë inspektime në lidhje me shërbime, të cilat ofrohen nga gjykatat tona. Varet edhe nga modeli. Në vende të caktuara mund të jetë një inspektorat i pavarur, i cili rregullohet me Kushtetutë, në disa të tjera rregullohet me ligj. Në vende, si për shembull Kosova e në vende të caktuara, mund të jetë edhe një inspektorat i cili përfshin si gjyqësorin, ashtu edhe prokurorinë. Pra, është një mekanizëm, i cili promovon përgjegjshmërinë e njëkohësisht disiplinimin dhe përgjegjshmërinë.

Ju faleminderit!

**Fatmir Xhafaj** – Ju faleminderit, zoti Smibert!

Pyetjeve të tjera?

**Rainer Deville** – Do të flas për pyetjen lidhur me shkollën e natës për gjyqtarët, në Shkollën e Magjistraturës, që u përmend. Kam përshtypjen se ndjekja e shkollës së magjistraturës së gjyqtarëve gjatë periudhës që ata janë në detyrë, është marrë nga pjesa që mbulon masa disiplinore, dhe është një propozim që, në momentin që nga procedimi disiplinor është konstatuar se ka një mungesë kompetence nga një gjyqtar i caktuar, të mos merren masa ekstreme, si shkarkimi i gjyqtarit, po për të mbrojtur gjyqtarin e për t'i dhënë atij më shumë garanci e stabilitet, t'i jepet mundësia të ndjekë disa kurse të specializuara – kjo është për t'u vendosur – në Shkollën e Magjistraturës. Të jetë ndoshta një vit, këto janë detaje që duhet të përcaktohen, por nuk ka qenë ideja jonë që të vazhdohet Shkolla e Magjistraturës natën nga ana e gjyqtarëve.

Ndërsa, sa i takon gjeneratës së re të gjyqtarëve e të prokurorëve, parimi që mbështesim, është që ata të gjithë duhet të shkojnë e të ndjekin Shkollën e Magjistraturës.

**Fatmir Xhafaj** – Pyetjeve të tjera? Kam përshtypjen se janë disa pyetje që lidhen me çështjen e zgjedhjes së Presidentit e lidhjen e tij me reformën në drejtësi, dhe efektet që ka pasur në vitin 2008 në sistemin e drejtësisë.

**Eduard Halimi** – Për pyetjen e fundit.

**Fatmir Xhafaj** – Po.

**Eduard Halimi** – Nuk e kisha te procesi disiplinor. E kam te pika e katërt: “Edukimi ligjor dhe arsimit juridik”, ku flitet për vendosje proporcionale, për pranimin jashtë konkursit të Shkollës së Magjistraturës, në përputhje me nevojat që dikton sistemi. Pra, në qoftë se na duhen gjyqtarë – se do t'i heqin ca – dhe ne nuk kemi kohë t'i mbushim nga Shkolla e Magjistraturës, t'i marrim nga Shkolla e Magjistraturës, sugjerimi vjen që t'i marrim nga jashtë shkollës, por këta të vazhdojnë shkollën. Për këtë e kisha, jo për masën disiplinore. Për masën disiplinore, dakord jam. Për masën disiplinore, kush ka probleme me korrupsionin, me paaftësinë, të shkojë në shpinë e vet.

**Fatmir Xhafaj** – Po. Vazhdojmë ndërkohë me dy pyetjet që lidhen me Presidentin.

**Sokol Sadushi** – Lidhur me pyetjen e zotit Halimi: a ndikon apo jo, formula e zgjedhjes së Presidentit në sistemin e drejtësisë – nëse e perifrzoja saktë, por pak a shumë ideja kjo është – sigurisht që konkluzioni ynë nuk ka qenë se ndikon në mënyrë të drejtpërdrejtë. Ajo që është përcaktuar si një gjetje, që është shumë e rëndësishme, është se Kushtetuta e vitit 1998, kur është

formatuar, është formatuar me një President me kompetenca shumë të forta. Për rrjedhojë, këto kompetenca të forta janë pa diskutim edhe në sistemin e drejtësisë. Duke mos përjashtuar edhe pozicionin e fortë që ka Presidenti i Republikës me institucionet e tjera kushtetuese. Duke ardhur në vijimësi, te konkluzioni i grupit, pas ndryshimeve të vitit 2008, ka bërë të konkludojë që, për shkak të ndryshimit të formulës, sigurisht që është krijuar një problematikë që lidhet me një mbështetje jo të gjerë politike, por edhe me një mungesë besimi të pakicës parlamentare, për shkak të formulës.

Nga kjo pikëpamje, konkluzioni ynë ka qenë që, do të kemi President të fortë apo do të ndryshojmë formulën e zgjedhjes. Faktikisht, nga të gjitha materialet dhe ajo që është përcaktuar edhe në strategji, objektivi ynë është ruajtja e ekuilibrave që rrjedhin nga roli i Presidentit në sistemin e drejtësisë, që do të thotë një ridimensionim i këtij pozicioni, qoftë në aspektin e kompetencave, por pse jo edhe në drejtim të formulës së zgjedhjeve. Kështu që, janë lënë të hapura si mundësi që, mënyra e zgjedhjes ka një ndikim, por duhet parë e lidhur domosdoshmërisht edhe me kompetencat. Nuk mund të shikohet njëra e shkëputur nga tjetra. Duhet të shikohet pozicioni i Presidentit në raport me sistemin e drejtësisë, dhe natyrisht, mbi këtë bazë, nëse do të jetë një President i fortë, me kompetenca të forta, automatikisht të çon në ndryshim të formulës së zgjedhjes. Nëse do të jetë një president me kompetenca jo të forta, mund të mbetet formula aktuale. Pra, gjithmonë është parë si objektiv një ridimensionim i pozicionit të Presidentit të Republikës në raport me sistemin e drejtësisë.

**Fatmir Xhafaj** – Po. faleminderit!

Ka diçka zoti...

Do të përgjigjeni ju për këtë pyetje? Do të shtoni diçka? Mbaroni dhe ju, që pastaj zoti Bylykbashi të bëjë pyetje.

Po, bëni edhe ju komentin shtesë, që ta mbarojmë këtë çështjen që lidhet me Presidentin dhe kompetencat në sistem.

**Aurela Anastasi** – Unë doja të theksoja se analiza jonë është mbështetur në Kushtetutën aktuale. Në qoftë se bëjmë një vështrim historik të mënyrës se si u hartuan kompetencat e Presidentit të Republikës në Kushtetutën që kemi sot, e para karakteristikë që na vjen në mendje është fakti që Presidenti i Republikës është një organ i paanshëm, i cili nuk përfshihet në asnjërin prej pushteteve, por kjo nuk e ka penguar Kushtetutën t'i japë atij kompetenca shumë të rëndësishme në kuadrin e pushtetit gjyqësor. Gjithë dedikimi dhe atribuimi që iu bë Presidentit të

Republikës për të marrë këto kompetenca, lidhej me faktin e ai konsiderohej mbi palët, i garantuar edhe nga formula me të cilën zgjidhej, pasi kërkohej një konsensus i gjerë. Formula e zgjedhjes së Presidentit të Republikës është parë si një nga garancitë kryesore për të pasur një president të paanshëm, që do të luajë këtë rol të rëndësishëm në marrëdhëniet me organet e drejtësisë.

Formula e re nuk e ka këtë garanci, nuk e paraqet këtë garanci. Por ama, unë dua të theksoj faktin se, në qoftë se bëjmë një vështrim të krahasuar të modeleve të ndryshme, ka një diapazon të gjerë formula e zgjedhjes së Presidentit të Republikës e të lidhjeve që ai ka me pushtetet e tjera, në rastin tonë me pushtetin gjyqësor. Pra, vështrimi i krahasuar na lejon të lundrojmë në një diapazon të gjerë. Por, ne do ta ndjekim një logjikë. Logjika duhet të ecë edhe mbi bazën e interpretimit historik. Kjo do të thotë se një president, i cili zgjidhet me një shumicë absolute – sepse aty përfundojnë përgjithësisht zgjedhjet e Presidentit të Republikës, kur nuk janë të cilësuar – natyrisht që do të ketë kompetenca formale në lidhje me pushtetin gjyqësor, jo kompetenca thelbësore. Kjo është përvojë e vendeve më të zhvilluara demokratike, të cilët edhe e kanë konsoliduar tashmë sistemin, presidentin e kanë vënë në karrigen e vet dhe çdo institucion është në vendin e duhur.

Tendenca në vendet e tjera, të cilat kanë hyrë në rrugën e zhvillimit e të forcimit të demokracive, është ndryshe. Po shkohet drejt zgjedhjes nga populli. Këtu ka modele të ndryshme dhe diapazone të ndryshme, por zgjedhja nga populli, në logjikën formalo-juridike do të thotë që Presidenti i Republikës të ketë kompetenca thelbësore. Këto kompetenca thelbësore mund të lidhen edhe me sistemin e drejtësisë. Kështu, në këtë kuadër, mua më duket e arsyeshme që ne kemi pasur parasysh këto mundësi, këto alternativa.

Duhet të arrijmë në një konkluzion: nëse na duhet një president ndërhyrës, që ka kompetenca formale dhe formalo-thelbësore – sepse thjesht thelbësore nuk mund t'ia japim – në lidhje me organet e drejtësisë, atëherë formula e zgjedhjes me konsensus të gjerë, në pamundësi për t'u zgjedhur nga populli, do të ishte më e arsyeshmja.

Në qoftë se ne do të kemi një president të dobët, që do të ketë kompetenca formale, pak kompetenca, ashtu sikundër ka sot presidenti i Republikës Italiane, i Gjermanisë e të tjera, atëherë, natyrisht atij do t'i shkonte për shtat një formulë si kjo e jona sot në Kushtetutë, që në fund të fundit përfundon me zgjedhjen e tij nga njëra palë.

U zgjata një çikë. Faleminderit.

**Fatmir Xhafaj** – Jo, s’ka gjë, profesore!

Po, zoti Bylykbashi. Te kjo çështje që trajtuat ju dhe profesor Sadushi, do të bëj një ndërhyrje.

Po, ju lutem!

**Oerd Bylykbashi** – Presidenti i Republikës së Shqipërisë ka ato kompetenca që janë aty. Përgjithësisht, ekziston ky interpretim që ka kompetenca të forta. Unë kam parasysh presidentin italian, i cili ka...

I gjithë ky diskutim vjen nga fakti se është marrë një qëndrim specifik në dokument, ku thuhet pati ndikim negativ. Mund të themi ka ndikim dhe mund të ketë ndikim. Kaq është e mjaftueshme. Pastaj, po të heqim cilësorin, diskutimi bëhet më i thjeshtë, por le të themi dy gjëra që janë të rëndësishme. Unë e ilustruova pak më parë, të gjitha krizat, përfshirë edhe ato që mund të sjellin mbi sistemin e drejtësisë ajo që kishim në Kushtetutën e vitit 1998 në lidhje me Presidentin e Republikës, jo më kot pas një debati shtatë mujor, arritëm në këtë konkluzion. Le të themi një të vërtetë të madhe. Fillimisht, në rastin e Presidentit italian ka një kompetencë, e cila në procesin e sistemit të drejtësisë është më shumë sesa ka Presidenti shqiptar, jo vetëm jep faljen, por mund të ndryshojë edhe dënimin. Nuk dua të hyj në diskutimin se çfarë kompetencash duhet të ketë, sa, t’i japim apo t’i heqim, por duhet të jemi të kujdesshëm që duke vënë qoftë edhe gjysmë fjale, mund të ndryshojmë të gjithë dinamikën e funksionimit, jo vetëm të sistemit të drejtësisë, por edhe të të gjithë sistemit kushtetues.

Le të themi një gjë që është sot e kësaj dite, po të hapim tekstin e vjetër të Kushtetutës, do ta gjejmë aty. Presidenti i Republikës së Shqipërisë me Kushtetutën e vitit 1998 në fund zgjidhej me shumicë absolute. Në një përkeqësim dramatik të një dispozite të marrë, të huazuar nga Kushtetuta greke ne, e çuam në një situatë që Shqipëria mund të shkonte në kriza ciklike njëvjeçare dështimesh kushtetuese, parlamentare dhe për rrjedhojë në kolaps, përfshirë edhe sistemin e drejtësisë. Çfarë ka ndodhur me Greqinë? Dy herë rresht ka ndodhur që kanë hyrë në zgjedhje të parakohshme. Pra, unë besoj se duke shkuar përtej diskutimit, është më shumë kompetencë apo më pak, duhet që kur të miratojmë këto dokumente, terminologjia e përdorur aty të jetë e tillë që t’i japë mundësi diskutimit, jo për të çuar domosdoshmërisht në një objektiv të hershëm të atyre që nuk e patën dëshirën për atë që ndryshoi Kushtetuta në vitin 2008, por të çojmë te ajo që do të ishte një inxhinieri konstitucionale, ku jo vetëm një kolonë e sistemit qëndron, por të tria bashkë funksionojnë me njëra-tjetrën. Nuk ka shumë zgjedhje: ose



është konsensual, që nuk e kemi pasur kurrë dhe atë që kishim çonte në shumën zero, drejt presidentëve që ishin të paaftë politikisht të vepronin, kontrolloheshin, ose do të zgjidhet me shumicë absolute, siç e kemi sot, ose nga populli, që do të ishte njëloj, një president i zgjedhur me votë politike me kompetenca të shkruara në Kushtetutë. Le të jemi të kujdesshëm te kjo pjesë edhe në mënyrën sesi frazozjmë këto dokumente kaq të rëndësishme.

**Fatmir Xhafaj** - Faleminderit!

Vazhdojmë me përgjigjet e tjera. Kam përshtypjen se është zoti Hoxha lidhur me kakofoninë e sistemit të dispozitave, nevoja për t'i unifikuar e të tjera. Institute të ndryshme përplasnin kolezionin. Kam përshtypjen se u trajtuan, më duket. Kam mbajtur shënime të sakta.

**Artan Hoxha** - Mund të jetë një çështje terminologjie dhe e përdorur gabim. Unë nuk e di se ku e ka parë zoti Ristani, por duhet të jetë, sepse nuk e vë në dyshim. Unë kam disa reflektime të fundit, sepse nuk ka unifikim të degëve, por është në sensin që e drejta të jetë e unifikuar, pra modele të ndryshme, të cilat merren në mënyrën sesi janë dhe vendosen në një tërësi të saj pa u harmonizuar me pjesët e tjera të së drejtës. Është një nga ato gjëra që sot e ka sistemi ligjor shqiptar. Ndërhyrjet e shpejta, të pastuduara, marrja thjesht e modelit dhe jo përpunimi i tij në raport me nevojën dhe strukturën ligjore që ekziston, mendojmë se është një nga ato elemente që kanë sjellë në një situatë që ka qenë e vështirë të interpretohet, të aplikohet, ndërkohë që duke marrë dhe duke studiuar të gjithë sistemin në tërësinë e tij, siç merr përsipër të analizojë gjendjen dokumenti, atëherë gjetja e problematikave në tërësinë e tyre, jep mundësinë të harmonizohet ndërhyrja legjislative, në mënyrë të tillë që të evitohen kontradiktat dhe konfliktet edhe për shkak të modeleve të marra dhe të implementuara, pa iu referuar një situatë konkrete ligjore që do t'i shërbente realisht strukturës së ligjit në Shqipëri.

Në këtë pikëpamje, ndonjë term që mund të jetë përdorur gabim, është çështje teknike, por thelbi i gjësë është që harmonizimi i legjislacionit të jetë në mënyrë të tillë. Ne e kemi mundësinë sot, që kjo të mos ndikojë negativisht në zbatimin e tij.

**Fatmir Xhafaj** - Faleminderit!

Ka edhe pyetje që lidhen me çështjen e efikasitetit të vendimmarrjes së Gjykatës Kushtetuese dhe referendumin.

Po, zoti Sadushi

**Sokol Sadushi** - Lidhur me referendumin, një gjetje, e cila është e komisionit është që kjo Kushtetutë që kemi aktualisht nuk ka arritur të jetë tërësisht funksionale dhe për më tepër as e qëndrueshme për t'i rezistuar "supermaxhorancave" politike, po përdorim këtë term dhe për shkak të kësaj gjetjeje, mendja të shkon, dhe domosdoshmërisht do të shkojmë te çështja e referendumit, si nocion kushtetues, i cili ka lidhje edhe me ligjin "Për referendumin", por më tepër shihet në aspektin e rregullimit të dispozitave kushtetuese që kanë të bëjnë me mundësinë e rishikimit të Kushtetutës dhe me domosdoshmërinë për disa aspekte tepër thelbësore që ka Kushtetuta, të kalohet në referendum, gjë që aktualisht Kushtetuta e sotme nuk e jep. Nuk e jep si një domosdoshmëri kalimin në referendum kur preket Kushtetuta nga 140 deputetë menjëherë. Për këtë arsye del në plan të parë të shkohet në nenin përkatës të Kushtetutës, që ka të bëjë me rishikimin e saj. Ai nen të çon domosdoshmërisht te koncepti i referendumit.

Për sa i përket çështjes së ligjit, Aurela, mund të thotë diçka.

**Fatmir Xhafaj** - Po zonja profesoreshë, le të dëgjojmë komentin tuaj.

**Aurela Anastasi** – Faleminderit, zoti kryetar!

E vërteta është se problemi i referendumeve u çel si rezultat i diskutimeve që ne patëm në lidhje me zbatimin ose mirëzbatimin e institucioneve kushtetuese. Fillimisht ishte fjala për mundësinë e amendamenteve kushtetuese, me qëllim që të rregullohet më mirë çështja e referendumeve, aksesin në referendum, kontrollin kushtetues mbi referendumet i lidhur ky edhe me reformimin e ligjit organik "Për Gjykatën Kushtetuese".

Nga pikëpamja teknike, zoti Bylykbashi e shtron drejt, sepse ne kemi Kodin Zgjedhor, ku një nga pjesët e të cilit është pjesa e referendumeve. Deri tani Kodi Zgjedhor është ndryshuar disa herë, sa herë kemi pasur zgjedhje, por ligji "Për referendumet", ka mbetur i paprekur, pjesa e referendumeve ka mbetur e paprekur. Jemi dëshmitarë të një sërë iniciativash të shoqërisë civile, të cilat kanë tentuar të kryejnë referendume, të gjitha absolutisht të pa përfunduara dhe të mbetura në mes.

Ne mendojmë se në këtë kuadër mund të propozohet dhe është një ide jona të rishikohet edhe pjesa e referendumeve, me qëllim që të mund të krijojë akses më të mirë, të krijojë

mundësinë më të mirë për firmëtarët. Jemi në një fazë që nuk kemi dispozita as për të mbledhur firmat. Qytetarët hedhin firma dhe iniciatorët akuzohen shpesh se kanë falsifikuar këto firma. Të gjitha këto garantohen me ligj dhe jo duke besuar në njërin qytetar apo në tjetrin.

Për të mos u zgjatur, nga pikëpamja teknike formulimi ynë ka qenë i përgjithshëm te ligji “Për referendimet”, sepse është një ide të shikohet mundësia dhe nuk është aspak në kundërshtim me Kushtetutën, e cila në nenin 81, pika 2, germa “ç” parashikon ligjin “Për referendimet”, por kjo nuk do të thotë që ne të mos bëjmë edhe amendamente në pjesën “Për referendimet” në Kodin Zgjedhor. Është një çështje për t’u parë.

E falënderoj zotin Bylykbashi për pyetjen. Ai ka bërë edhe pyetje të tjera të rëndësishme.

Në lidhje me zbatimin e vendimeve të Gjykatës Kushtetuese, ligji organik “Për Gjykatën Kushtetuese”, paracakton Këshillin e Ministrave si organin kryesor përgjegjës që merret me zbatimin e vendimeve të Gjykatës Kushtetuese. Ne mendojmë se çështja e zbatimit të vendimeve të Gjykatës Kushtetuese ka çaluar dhe ka disa arsye, disa faktorë. Në këtë kuadër ne mendojmë se duhet të rishikohet i gjithë mekanizmi institucional për zbatimin e vendimeve të Gjykatës Kushtetuese, pasi nuk mund të jetë vetëm Këshilli i Ministrave organi kryesor.

Vlerësoj shumë komentin që bëri zoti Bylykbashi, i cili paraqiti hapat që ka bërë Kuvendi, ka ndryshuar Rregulloren, ka përcaktuar një komision që merret me këtë qëllim, por gjithmonë ka nevojë për përmirësime, për shembull në Rregulloren tuaj, kur e diskutojmë në auditorët e fakultetit shikojmë se ka vend për debat, për përmirësime, sepse e kemi parë edhe në doktrinën apo në analiza të ndryshme të bëra nga analistë, të cilët mendojnë se Kuvendi ishte ai që përzgjedh nëse ka nevojë ta zbatojë vendimin e Gjykatës Kushtetuese, të paktën siç del nga konteksti i dispozitës, i Rregullores së Kuvendit, apo nuk ka nevojë. Ka nevojë të shikohet çështja në tërësi nga pikëpamja e mekanizmave dhe mendojmë se Kuvendi do të jetë një organ kyç për zbatimin e vendimeve të Gjykatës Kushtetuese.

Faleminderit!

**Fatmir Xhafaj** - Faleminderit, profesororeshë!

Me sa shikoj, të gjitha pyetjet u ezauruan nga ato që janë bërë me përgjigje.

Zoti Strazimiri ka pyetje shtesë.

**Gent Strazimiri** – Faleminderit!

Unë nuk e kam në adresë të njërit prej ekspertëve në mënyrë specifike. Më shumë do të doja të kuptoja në lidhje me organizimin e Këshillit të Lartë të Drejtësisë. Tendenca e organizimit të Këshillit të Lartë të Drejtësisë është qëllimi, është për të ruajtur një qeverisje autonome, jashtë ndikimeve të politikës nga ana e gjyqësorit, të Magjistraturës, por ndërkohë ekziston sfida që të ketë një mekanizëm *check and balance* edhe në këtë drejtim për shkak të rrezikut të krijimit të kastave brenda gjyqësorit, të cilat do të jenë të interesuara dhe të lidhura fort për të ruajtur privilegjet e tyre për ta kthyer autonominë apo pavarësinë që duhet të kenë nga pushtetet e tjera në një mjet përfitimi.

Në njohurinë time, në praktikën kontinentale të organizimit të këtij organizimi vetëqeverisës të gjyqësorit janë tri modele të ndara: modeli italian me presidentin e Republikës në krye, modeli francez pa praninë e tij, por me një ndërhyrje direkte në Këshillin e Lartë të Drejtësisë dhe modeli gjerman që nuk e ka fare.

Do të doja të dija se cilit prej modeleve kontinentale po i shkoni nga pas në këtë riformulim apo riorganizim të Këshillit të Lartë të Drejtësisë dhe si sigurohet mekanizmi *check and balance* në strategjinë që ju keni ndërmend?

**Fatmir Xhafaj** - Nëse do të më lejoni si kolegë, desha t'ju bëja një gjë me dije: për këtë çështje ka dy rekomandime, njëri është i Brukselit i vitit 2013, para takimit të nivelit të lartë që përmendi zoti Halimi, ku thekson nevojën e rritjes së pjesës jashtë gjyqësorit në përbërje të Këshillit, duke ridimensionuar dhe duke riformatuar atë dhe kompetencat e tij. Ka edhe një rekomandim para 6-7 muajve, i cili është zyrtar, i sjellë qeverisë shqiptare nga Komisioni i Venecias dhe rekomandon po të njëjtën gjë, është në të njëjtën linjë. Mbetet që kur të diskutohen të jenë pjesë e dokumenteve.

*(Ndërhyrje pa mikrofon.)*

Thjesht e solla në vëmendje. Unë e kam lexuar vetë.

Po, ju lutem!

**Gent Strazimiri** - Zoti kryetar, e mirëkuptoj, prandaj doja të precizoja interesin tim për pyetjen. Të dyja momentet që ju përmendni janë momente deklarative.

**Fatmir Xhafaj** – Jo, kanë ardhur me shkrim. Është opinioni i Venecias.

**Gent Strazimiri** – Janë opinione deklarative. Synimi është të krijojnë këtë dhe atë nëpërmjet asaj mënyre. Interesi im është që i njëjti qëllim në praktikën kontinentale realizohet, të paktën me tre mekanizma të ndryshme në shtete shumë demokratike dhe me një gjyqësor të konsoliduar. Cilin prej modeleve mendoni se mund të ndiqni? Sigurisht në përmbushje të këtyre që thotë Brukseli dhe që sapo i citoi zoti Xhafaj?

**Fatmir Xhafaj** – Faleminderit, zoti Strazimiri!

Zoti Deville, ju lutem!

**Rainer Deville** – Faleminderit për pyetjen. Në fakt është pyetje shumë e thjeshtë. Përgjigjja për sa i takon modelit, është modeli shqiptar që bazohet në eksperiencat e mëparshme, në nevojat dhe në rekomandimet që vijnë nga aktorët ndërkombëtarë.

Qasja jonë është të mos marrim një model nga jashtë, por të shikojmë situatën aktuale në Shqipëri dhe modelin tonë ta përshtatim në funksion të përmirësimit dhe të problematikave që kemi për përmirësimin e situatës.

Keni shumë të drejtë kur përmendni mekanizmat *check and balance* të kontrollit, pavarësisht se është e nevojshme që gjyqësori të ketë pavarësi, vetërregullime, edhe kjo pavarësi duhet të kontrollohet. Këtu është problemi.

Një nga elementet e përmirësimit të *check and balance* brenda këtij institucioni është edhe propozimi që bëhet, pra gjysma e anëtarëve të jenë gjyqtarë dhe gjysma tjetër të vijnë nga jashtë sistemit, në mënyrë që anëtarët e tjerë jashtë sistemit të balancojnë në një farë mënyre gjyqtarët.

Një element tjetër i përmirësimit të *check and balance* është prezantimi dhe paraqitja e një sistemi të ri për përgjegjshmërinë, përgjegjësinë disiplinore të anëtarëve të Këshillit të Lartë të Drejtësisë, jo një kontroll që ka të bëjë me përmbajtjen e vendimeve, por që do të ketë të bëjë me aspekte të tjera, me rregullime dhe përgjegjësi të tjera që ata kanë, për sa u takon

sjelljeve korruptive apo shkeljeve të ndryshme disiplinore, në mënyrë që ata të mos bëjnë çfarë të duan duke përdorur si mburojë pavarësinë që u jepet në funksionin e tyre.

**Fatmir Xhafaj**- Faleminderit!

Ka pyetje të tjera?

Po, zoti Strazimiri ka pyetje në vazhdim.

**Gent Strazimiri** - Ju faleminderit për përgjigjen!

Në fakt, interesi im buronte nga një gjetje te dokumenti strategjik që lidhet saktësisht me modelin shqiptar, i cili për ta thënë me pak fjalë është një përzierje, huamarrje modelesh të ndryshme kontinentale, siç u tha këtu, edhe amerikane. Ka prevaluar në atë që ju e quani model shqiptar. Dokumenti strategjik thotë se është një përzierje elementesh të ndryshme, modelesh nga më të ndryshmet, në vlerësimin tim ka prevaluar modeli italian me asistencën shumë të vyer të Komisionit të Venecias. Kur thoni model shqiptar, për mua nuk është shumë rasigurante. Modeli shqiptar është një përzierje e elementëve të modeleve kontinentale dhe më gjerë. Kjo është arsyeja pse po përpiqemi ta harmonizojmë me diçka. Pyetja ime është, se me çfarë po përpiqemi ta harmonizojmë?

**Fatmir Xhafaj** – Faleminderit!

Ju lutem!

*(Ndërhyrje pa mikrofon.)*

**Fatmir Xhafaj** - Zoti Strazimiri, ju lutem, sepse nuk është debat midis jush dhe ekspertit.

Ju lutem, vazhdoni!

**Rainer Deville** - Së pari, Komisioni i Venecias nuk mbështet modele të caktuara, por merret me parimet. Nëse ju vendosni të hiqni fare Këshillin e Lartë të Drejtësisë, Komisioni i Venecias nuk është domosdoshmërisht kundër kësaj, përderisa ky model ekziston diku në një vend tjetër.

Dua të theksoj se janë parimet, të cilat duhet të respektohen dhe nuk ka një detyrim që Shqipëria të ketë një model të caktuar të një vendi të caktuar. Shqipëria nuk duhet të ketë modelin e Italisë, të Gjermanisë apo të një vendi tjetër, sepse Shqipëria nuk është identike me këto vende. Ajo që ne jemi përpjekur, të bëjmë është të përdorim bazën, atë çfarë ka ndërtuar Shqipëria deri tani në këto vite, sepse jo domosdoshmërisht gjithçka që është krijuar në sistem është e keqe, është negative. Mbi bazën e kësaj të përmirësohet sistemi, gjithmonë në bazën e sfidave dhe të problematikave që ke vendi.

**Fatmir Xhafaj** – Faleminderit!

Ka pyetje të tjera? Do ta mbyllim me pyetjet? Nuk ka pyetje.

Faleminderit!

Mund të vazhdojmë, nëse ka diskutime.

Po, zoti Halimi.

**Eduard Halimi** - Kjo ishte një seancë dëgjimore e vlefshme, besoj për ne si anëtarë të komisionit po e po, por edhe për publikun. Kjo ishte seanca e parë e Komisionit për Reformën në Drejtësi pas konsensusit të arritur me mbështetjen e partnerëve ndërkombëtarë, se mendimi dhe prania e opozitës, impakti i saj është i nevojshëm që reforma të jetë jetëgjatë, jo t'i shërbejë një mandati qeverisës, por të jetë jetëgjatë.

Kjo ishte seanca e parë ku ne u përballëm pas dakordësisë që ramë në prani të partnerëve ndërkombëtarë, dakordësi, e cila garantohej nga partnerët tanë se procesi do të ishte transparent, do të ishte gjithëpërfshirës dhe vendimet e komisionit do të merreshin me konsensus, që përjashtimisht konsensusi mund të shkelej, mund të mos arrihej, por jo për çështje që kishin të bënin me transparencën, gjithëpërfshirjen dhe me opinionin e Komisionit të Venecias. Për këto çështje konsensusi nuk duhej të prishej. Kjo ishte dakordësia me partnerët ndërkombëtarë, dakordësi, e cila na bëri që ne të vinim këtu. Bëmë shumë mirë.

Vijmë sot dhe sot doli e qartë në dritën e diellit se dokumenti strategjik dhe plani i veprimit nuk janë bërë publikë as edhe një minutë të vetme për publikun dhe qytetarët shqiptarë. Janë organizuar zero tryeza për t'u konsultuar mbi këtë draft. Opozita kërkoi të japë impakt në këtë

proces dhe për këtë kërkoi kohë në fillim të sesionit të ri parlamentar, pa i prishur punë fare askujt, pa ndërprerë asnjë proces dhe asnjë hap të vetëm. Plani i veprimit është aty dhe nuk ndërpret as edhe një plan të vetëm. Nuk pengon askënd. Kërkoi kohë të japë impakt. Vendosija e një standardi të tillë, si ky që u diskutua pak më parë, se ne e miratojmë këtu dhe pastaj, hajdeni ulemi të bëjmë tryeza, është precedenti më i keq që mund të vendosë komisioni. Modeli më i keq që mund të vendosë komisioni që procesi të jetë gjithëpërfshirës. Vendosija e një standardi të tillë, që ne e vëmë opozitën para fakti të kryer, në mbledhjen e parë i plasim në tavolinë dokumentet, po deshët i miratoni, po deshët mos i miratoni, se ne i kemi hipur trenit para 8 muajsh. Ju po deshët hipni, po deshët mos hipni! Apo e standardit tjetër, se ne e miratojmë dhe ju po deshët hajdeni jepni komente, që është standardi më i keq që mund të vendoset për vijimin e konsensusit. Ky standard është vrastar për konsensusin politik në mënyrë të padiskutueshme, për dakordësinë mes palëve në mënyrë të padiskutueshme. Kjo i shërben një rës palë politike për të vijuar e vetme, por nuk i shërben sistemit të drejtësisë. Ndaj edhe sugjerimi im shumë miqësor ishte gjatë gjithë kësaj dite që ne ta diskutonim. Isha dakord që në fillim dhe gjatë kësaj mbledhjeje që ju ta diskutoni, t'i bëni diskutime këtu, por jo ta miratoni, sepse vendimi i miratimit nga komisioni do të ishte një farsë mbrapa. Vendimi ynë që do ta miratonim dhe t'i thoshim ne miratuam, hajde tani të bëjmë konsulta me konferencën gjyqësore, hajde bëjmë konsulta tani me gjyqtarët, hajde bëjmë konsulta më mbrapa me të tjerët për këtë draft që miratuam dhe ju po deshët na shtoni një mendim, ky e bën vendimin e komisionit farsë.

Edhe për përmbajtjen ne bëmë pyetje sepse kishte një mungesë koherence ndërmjet asaj që ishin gjetjet që kishin të bënin me analizën dhe që ishte shqetësim më kryesor i opozitës, por nuk morëm përgjigje. Përgjigjja që marrim ne, se nuk kemi bërë një përshkrim kronologjik për historinë më të tmerrshme të kapjes së drejtësisë dhe korrupsionit në sistemin e drejtësisë, se ne nuk na shkoi mendja apo nuk donim, është tërësisht subjektive. Po ku ka korrupsion më të madh në drejtësi se kapja politike? Nuk e themi ne, e ka thënë greku. Absolutisht dhe është e para opozita e interesuar që sistemi i drejtësisë të mos jetë i korruptuar, të mos jetë i kapur po e po, por të mos jetë i korruptuar. Sepse viktima e parë e një sistemi gjyqësor, i një sistemi drejtësie të korruptuar dhe të kapur është opozita. I keni parë ju vendimet e fundit që kanë dalë dhe për sekretarin e Përgjithshëm, edhe për nënkryetarin e partisë, edhe për zotin Strazimiri, i keni parë vendimet që dalin? Ndaj është e interesuar opozita që t'i japë input, ndaj është e interesuar opozita që sistemi i drejtësisë të dalë nga statuskuoja, të mos jetë i kapur, të mos jetë i



korruptuar. Prandaj jemi këtu ne për të dhënë impakt të drejtpërdrejtë për reformën, sepse është e pamjaftueshme për mua.

Në këtë që duhet ta miratojmë sot, thuhet se strategjia për ta përmirësuar Gjykatën e Lartë është që t'i fusë anëtarët nga jashtë sistemit, domethënë t'i fusë nga maxhoranca. Tek ai modeli që thashë unë që rastësisht nuk e kishim parë më përpara. Tek ai modeli thashë. Është e pamjaftueshme përgjigjja, ju e dini. Se nuk jemi për këtë që ju e dini. Se ku jemi ne dhe ku është maxhoranca dihet. Është e pamjaftueshme për mua që të më thuhet, edhe për rastin e Inspektoratit të Këshillit të Lartë të Drejtësisë, vetëm që do të krijohet një institucion i pavarur, se e kam të pamundur që ta miratoj me këtë frazë. E kam të pamundur që të them se është i pavarur, se ne këtu e dimë shumë mirë se institucionet e pavarura këtu janë institucione që kapen. Institucionet e pavarura këtu prodhohen nga qeveria dhe i kemi ne rastet dhe më përpara këtu e një vit, se si i krijojmë ne institucionet e pavarura. i prodhojnë institucionet e pavarura me shumën e votave dhe shumën e votave e ka maxhoranca. Kjo është kultura politike që kemi ne. Dhe unë e kam të pamjaftueshme këtë, të më thuhet që do të shkrihet inspektorati dhe duke u shkruar inspektorati i KLD-së le të shkrihen, nuk e kam problem fare, të ikin të gjithë, por mekanizmi që më jepet më thuhet që do ta bëj të pavarur.

Por si do t'i emërojë? Nuk e ka. Për këtë unë e kam të pamjaftueshme për ta miratuar një gjë të tillë. E kam të pamundur që t'i jap votën për të miratuar një akt, sepse në qoftë se do ta bëja, të miratoja një strategji, e cila nuk ka impakte të drejtpërdrejta, nuk ka zgjidhje konkrete, por ka zgjidhje dyfishe dhe trefishe, kjo e bën të pamundur një vendim të komisionit për ta miratuar. Ndaj dhe do t'i kthehem menjëherë me shumë qetësi dhe me maturi propozimit të bërë më përpara. Të ndalet këtu puna e komisionit një punë vlefshme që na shërbeu. Dhe mua më shërbeu. Nuk po vazhdoj me përgjigjet e tjera. Dhe mua më shërbeu për t'u njohur. Të ndalemi këtu në këtë mbledhje të komisionit, t'i jepet kohë dhe mundësi opozitës që të marrë dhe të analizojë edhe impaktin e atyre 1400 avokatëve, juristëve, gjyqtarëve, prokurorëve, siç tha zoti Ristani, për ta marrë të analizuar. T'i jepet mundësi opozitës që të sjellë zgjidhjet konkrete në fillim të sesionit parlamentar, javën e parë të sesionit parlamentar, zgjidhjet konkretet si e sheh opozita në mënyrë që produkti që do të miratohet dhe nuk ka absolutisht asnjë nevojë që të miratohet gjysmë për gjysmë, por produkti që do të miratohet të jetë një produkt i përbashkët. Mund të mos biem dakord për ndonjë gjë, por ama të jetë i përbashkët. Vetëm vendosja e një standardi të tillë do t'i shërbejë konsensusit.

Në rast se ju do të vazhdoni me këtë mënyrë sjelljeje, me vendosjen e këtij standardi se ne veprojmë edhe pa u konsultuar me grupet e interesit, edhe pa marrë vendimin e Komisionit të Venecias, edhe pa marrë versionin edhe impaktin e opozitës, se kjo nuk na duhet, atëherë po ju them se ju jeni shkaktarët e vetëm të prishjes së konsensusit për një reformë kaq të rëndësishme për procesin dhe kjo është reformë jetike për procesin. Se kërkesat e opozitës në lidhje me këtë proces janë jetike, kanë të bëjnë me transparencën. Kanë të bëjnë me impaktin. Në qoftë se ju thoni se nuk na duhet impakti, se ne do të ikim, i kemi hipur trenit dhe do të largohemi, atëherë kjo do të sjellë në mënyrë të padiskutueshme edhe prishjen e konsensusit dhe shkaktar të vetëm të prishjes së konsensusit po ju them që jeni personalisht ju. Kjo është kërkesa e deputetëve të opozitës, të ndalohet puna e komisionit duke pritur impaktin e opozitës. Miratimi i një vendimi me arrogancë është vrastar për konsensusin.

**Fatmir Xhafaj** - Faleminderit!

Ka diskutime të tjera? A deshët ekspertë ndërkombëtarë. Tani rrini dhe diskutoni përgjigjet e tyre, i vini në diskutim. Deri dje keni thënë? Po pas teje? Të fshihen? Deshët ekspertë ndërkombëtarë, i keni, deshët Euralius, e kishit. Doni Venecian? E keni. Do ta merrni akoma.

Ka diskutime të tjera? Dakord.

Ju kërkoj ndjesë, por do t'ju ha pak minuta. Do të dëshiroja që të mos ndodhte kjo që ndodhi dhe jam shumë i shqetësuar dhe shumë i mërziur. Por besoj se është një gjykim emocional, jo racional në interes të procesit, në interes të rolit të palëve në proces dhe të vetë deputetëve, përfshirë dhe ata të opozitës. Në respekt të kësaj tryeze dhe në respekt dhe të publikut dëshiroj që të sqaroj dy-tre gjëra që janë të rëndësishme. E para, kjo nuk është një seancë dëgjimore, sikundër pretendoi zoti Halimi. Kjo është një mbledhje komisioni me rend dite për të cilin unë kam rënë dakord paraprakisht dhe kam marrë dhe pëlqimin e zotit Halimi. Pra, nuk është një seancë dëgjimore me grupin e ekspertëve vendas dhe ndërkombëtar të nivelit të lartë. Përkundrazi, është kërkuar që grupi i ekspertëve të jetë i pranishëm për t'i dhënë përgjigje pyetjeve me kërkesë të kolegëve të opozitës dhe ekspertët vendas, ndërkombëtarë, që janë në rolin e bashkëkryetarëve të grupeve janë këtu për këtë gjë dhe besoj se bën më së miri ashtu siç e vlerësoi dhe vetë zoti Halimi detyrën e tyre.

Së dyti, kjo nuk është seanca e parë e komisionit, është seanca e dytë e komisionit me opozitën. Dhe në mbledhjen e parë ne kemi miratuar disa gjëra të cilave sot iu kthye zoti Halimi dhe përsëri kërkohet një ndryshim teknik, gjë që është normale dhe unë e mirëkuptova, paçka se

nuk është në të njëjtën filozofi dhe në një qasje me procesin. Por për t'i dhënë hapësirë dhe akses maksimal opozitës e pranuar dhe kërkesën e tyre jo shumë të justifikuar për të pasur ekspertë të opozitës pranë grupeve të punës. Pra, që opozita të ndihet më mirë, që opozita të ndihet më e përfaqësuar, që opozita të kapë kohën e humbur, të ketë mundësi që të jetë akoma më konstruktive në proces, ne e pranuar dhe e lëshuam këtë gjë paçka se thashë kjo nuk është në qasjen dhe filozofinë e këtij procesi të konceptuar dhe të realizuar në këto 8 muaj. Zoti Halimi pretendon se janë organizuar zero tryeza. Kjo është një gjë absurde, sepse këtu ka të paktën 3 aktorë që nuk mund ta mohojnë këtë. Të parët janë mediat që nuk ka tryezë në Shqipëri të organizuar jo thjesht në Tiranë, por nga Saranda në Shkodër që media nuk ka qenë e pranishme.

Së dyti, janë partnerët ndërkombëtarë në të gjitha këto tryeza ku kanë marrë pjesë dhe kanë përshëndetur dhe kanë vlerësuar procesin ambasadorët e organizatave dhe vendeve të rëndësishme të akredituara në Shqipëri.

Së treti, janë pjesëmarrësit që kanë qenë në këto tryeza të cilët kanë qenë pjesëtarë që kanë ndjekur dhe janë shprehur mbi qëndrimet e tyre në këto tryeza. Pra, ta trajtosh çështjen në mënyrë kaq agresive dhe në një frymë kaq nihiliste, kjo është dhe fyese, por nuk e prisja. Kjo është një gjë me thënë të drejtën nuk më rri mirë dhe nuk i rri mirë dhe nevojës që kemi për të pasur një frymë tjetër në këtë proces. Natyrisht kur flasim për gjithpërfshirje, transparencë dhe Komision të Venecias, duhet të kemi të qartë se ne po diskutojmë disa dokumente që e kanë përmbushur këtë proces, këto standarde dhe po i hapim rrugën një faze tjetër ku do të kërkojnë këto standarde. Dhe këtu unë jam shumë dakord me opozitën. Pra, ne po përmbysim, po diskutojmë dhe po miratojmë disa dokumente të fazës së parë dhe të dytë të një pune rreth 8-mujore të cilat i kanë brenda këto standarde. Pra, gjithpërfshirjen, transparencën dhe profesionalizmin. Pa dyshim kërkesa që këto standarde t'i shohim të mishëruara edhe në fazën e tretë, që është amendimi i Kushtetutës dhe i ligjeve, është një kërkesë e drejtë dhe unë besoj se përvoja e deritanishme e konsoliduar garanton që dhe në fazën e tretë, ku do të jetë besoj shumë aktive opozita, do të jenë më së miri të garantuara këto procese.

Për sa i përket zgjidhjeve konkrete të opozitës, të jem i sinqertë, kjo është një gjë, e thashë pak, po e ripërsëris, pa kuptim. Opozita është shprehur në tryezën e 31 tetorit përmes kryetarit të Partisë Demokratike dhe përmes kolegëve tanë lidhur në një këndvështrim dhe me disa sugjerime, propozime të tyre për reformën në drejtësi. Dhe unë prisja që sot kolegët e opozitës të vinin me propozime konkrete, sidomos te strategjia për ta përmirësuar atë. Por të vish këtu, të

kesh kaq kohë, të kenë punuar 8 muaj, të jetë dhënë dokumenti në kohë, të pranosh që të hysh në një diskutim tjetër dhe pastaj të thuash se unë dua dhe ca muaj të tjera që të mendohem, kjo nuk më duket një qasje serioze.

Gjithsesi, pa u kushtëzuar dhe pa imponuar për të krijuar një vijë sjelljeje të gabuar dhe për të nesërmen dhe duke i qëndruar besnik filozofisë dhe qasjes së deritanishme, ne propozojmë që të kemi hapat e mëtejshme të ndërtuara në këtë mënyrë për të cilën kam diskutuar dhe me zotin Halimi dhe që i parashtruam dhe këtu.

Së pari, të miratojmë dokumentin Analiza e Sistemit në Drejtësi në Shqipëri sipas tekstit bashkëlidhur këtij vendimi për shkak sepse ne e konsiderojmë një proces të mbyllur nga të gjitha pikëpamjet analizën. Dhe ka qenë koha e mjaftueshme për të gjithë faktorët, aktorët dhe individët që kanë dashur të kontribuojnë për ta bërë këtë gjë. Kjo gjë është reflektuar në këtë dokument final që ke.

Së dyti, të miratojmë në parim strategjinë dhe planin e veprimit duke i konsideruar të hapur këto dy dokumente për një proces të mëtejshëm konsultimi dhe tërheqje mendimi nga grupi i ekspertëve të nivelit të lartë duke qenë se siç u tha me të drejtë këtu nuk ka qenë një dokument publik dhe t'i japim mundësinë të jetë një dokument publik jo vetëm në portal, jo vetëm në adresat e rrjetit të konsultimit prej 1400 profesionistësh që ne kemi, por cilido që dëshiron ta ketë, duke e bërë dhe pronë të medias nga ky moment për ta bërë publike, t'u japim mundësinë të gjithëve që të shprehen për ta pasuruar këtë dokument parimor. Dhe të jetë i hapur strategjia dhe plani i veprimit për konsultim dhe me tërheqje mendimi përfshirë këtu dhe amendamente të mundshme të opozitës që mund ta pasurojnë këtë dokument.

Dhe hapi tjetër është Venecia. Këtu do të ndalem pak, shkurt për të sqaruar dy gjëra. Kur bëhej debati që ky duhet të jetë një proces i certifikuar nga ndërkombëtarët, është theksuar prania e organizatave ndërkombëtare dhe strukturave që asistojnë dhe monitorojnë procesin e sistemit në drejtësi të tilla si EURALIUS-i, OPDAT-i, prezenca e OSBE-së, Këshilli i Europës etj. Dhe për këtë gjë Kuvendi nuk e la në vullnet të maxhorancës, por e bëri pjesë detyruese në vendimin e tij dhe e ka detyruar komisioni i posaçëm parlamentar ta kërkojë këtë prezencë dhe ne e kemi sot këtë prezencë në përbërje të grupit të ekspertëve të nivelit të lartë, përfshirë këtu dhe Komisionin e Venecias, i cili zyrtarisht është pjesë e grupit të ekspertëve të nivelit të lartë përmes dy personave të mandatuar nga Presidenti i Komisionit të Venecias.

Por përtej kësaj pranie të gjerë ndërkombëtare në proces ne jemi të hapur për të kërkuar opinion zyrtar të Komisionit të Venecias. Dhe me mbylljen e këtij procesi këto dokumente do t'i shkojnë për një opinion zyrtar Komisionit të Venecias, sidomos për sa i përket zgjidhjeve kushtetuese, por dhe çdo zgjidhje tjetër që do të kërkohet për t'u certifikuar si e tillë nga kolegët tanë të opozitës. Dhe kështu për t'i hapur rrugë fazës së tretë të këtij procesi një faze shumë të rëndësishme që është amendimi i Kushtetutës dhe draftimi i projektligjeve të përfshira si pjesë e këtij dokumenti të strategjisë. Dhe në këtë frymë, nëse nuk ka ndonjë kontestim tjetër, unë do t'ju kërkoj që të bëjmë dy votime. Votimi i parë është të miratojmë dokumentin final; "Analiza e sistemit të Drejtësisë në Shqipëri" sipas tekstit të bashkëlidhur të këtij vendimi.

Kush është dakord? Kundër? Nuk ka. Abstenime? Nuk ka.

Dhe së dyti, të marrim vendimin për të miratuar në parim dokumentin strategjia e reformës së sistemit të drejtësisë në Shqipëri dhe dokumentin Plani i Veprimit për Zhvillimin e Strategjisë" sipas tekstit bashkëlidhur të këtij vendimi.

Këto dy mbeten të hapura për komente dhe propozime për përmirësimin e tyre. Grupi i ekspertëve të nivelit të lartë me mbështetjen e sekretariatit teknik të vazhdojë procesin e konsultimit publik dhe të vlerësojë dhe reflektojë përfshirjen e çdo kontributi të pranueshëm në këtë dokument. Pra, me këto dy pika biem dakord? Po.

**Ulsi Manja** – Jam shumë dakord, zoti kryetar, por çdo reflektim i ekspertëve të opozitës dhe i kolegëve të opozitës gjatë kësaj periudhe që do të jetë e hapur për diskutim, paketa e strategjisë dhe plani i veprimit duhet të vijë domosdoshmërisht nëpërmjet grupit të ekspertëve të nivelit të lartë. Drejtpërdrejt nga ekspertët e opozitës dhe nga kolegët e opozitës cenon frymën e konsensusit.

Faleminderit!

**Fatmir Xhafaj** - E rëndësishme është që ky është një proces i hapur ku mund të vazhdojë të jetë dhe kontributi i opozitës dhe kryesorja kontributi i çdo profesionisti të fushës në këtë vend i cili dëshiron të kontribuojë pa paragjykitime dhe pa parakushte në këtë proces të rëndësishëm.

**Vasilika Hysi** – Zoti kryetar, unë e vlerësoj këtë proces konsultimi, por do të ishte e rekomandueshme që ne këtu në komision të përcaktojmë dhe afatin brenda të cilit do të pranoheshin të gjitha opinionet, sugjerimet dhe komentet.

**Fatmir Xhafaj** – E lamë të hapur. Që t'ju sqaroj, e para, ka tri arsye pse e bëjmë këtë gjë.

E para, respektojmë këtë punë 8-mujore që është bërë, është respekt për këtë çfarë është bërë, se e gjithë historia sot nuk fillon nga zero.

E dyta, që është e rëndësishme, i japim mundësi dhe akses cilitdo që dëshiron të kontribuojë për përmirësimin e tyre.

E treta, shprehim një vullnet politik edhe në kuadrin e procesit të integritetit për shkak sepse është e rëndësishme shprehja e këtij vullneti për fazat e mëtejshme të procesit, për vlerësimin e Shqipërisë lidhur me këtë pjesë, me këtë detyrim të saj ndaj proceseve integruese.

Dhe tjetra, që është shumë e rëndësishme, duke e miratuar në parim i kemi hapur rrugë fazës së tretë, për t'u përgatitur faza e tretë. Pra, bëjmë një lidhje midis fazës së dytë dhe fazës së tretë pa e mbyllur përfundimisht këto dy dokumente. Dhe në momentin që këto dy dokumente mbyllen këto pastaj konsiderohen dokumente finale dhe reflektohet, vazhdon normalisht i gjithë angazhimi i grupit të ekspertëve dhe i komisionit parlamentar kalon te faza e tretë amendimi kushtetues dhe projektligje.

Pra, janë këto 4 arsye të qenësishme mendoj unë që na detyrojnë të bëjmë një miratim në parim, ta lëmë procesin të hapur: i hapim rrugë fazës së tretë dhe hedhim bazat për të shkuar me një kërkesë për opinion në Komisionin e Venecias.

Biem dakord kështu?

Kush është pro? Kundër? Nuk ka. Abstenime? Nuk ka.

Miratohet.

Faleminderit dhe një herë të gjithëve!

Faleminderit, zonja dhe zotërinj të respektuar të grupit të ekspertëve të nivelit të lartë, për kohën, angazhimin që keni treguar gjatë këtyre 8 muajve, por dhe për prezencën dhe kontributet që dhatë me vlerësimet tuaja sot në këtë mbledhje të komisionit të posaçëm parlamentar. Shpresoj që të rishihemi përsëri në këtë proces në komisionin e posaçëm parlamentar.

Faleminderit, medias dhe të gjithë atyre që na ndoqën!

Një fundjavë të mbarë dhe pushime të mbara për ata që e kanë ndarë mendjen të bëjnë pushime në këtë verë të nxehtë.

Mirupafshim!

## **MBYLLET MBLEDHJA**